

# AKSESI NË DREJTËSI DHE GJYKIMI I DREJTË

---

Guidë monitorimi për shoqërinë civile

Maj 2023

Ky botim është bërë i mundur me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian.



Funded by  
the European Union

Ky botim është përgatitur në kuadër të projektit “Gjyqësori në fokus” i zbatuar nga një konsorcium prej tre partnerësh: Instituti për Studimet Publike dhe Ligjore (ISPL), Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë (OSFA) dhe Centre for Legal Empowerment (CLE), me mbështetjen e Bashkimit Evropian në kuadër të kornizës “Civil Society Facility and Media Programme 2021”.

Ky botim është bërë i mundur me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e këtij dokumenti është përgjegjësi e vetme e Institutit për Studimet Publike & Ligjore dhe në asnjë rrethanë nuk mund të konsiderohet se pasqyron pozicionin e Bashkimit Evropian.

©Të gjitha të drejtat e botimit i takojnë Institutit për Studimet Publike & Ligjore (ISPL)

ISBN: 9789928361394

## SHKURTIME

<b>GjK</b>	Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë
<b>GjL</b>	Gjykata e Lartë
<b>GjEDNj</b>	Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut
<b>KEDNj</b>	Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut
<b>DNjF</b>	Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas
<b>MD</b>	Ministria e Drejtësisë
<b>KL Gj</b>	Këshilli i Lartë Gjyqësor
<b>KLP</b>	Këshilli i Lartë i Prokurorisë
<b>ILD</b>	Inspektorati i Lartë i Drejtësisë
<b>ShM</b>	Shkolla e Magjistraturës
<b>K.Pr.C.</b>	Kodi i Procedurës Civile
<b>K.Pr.P.</b>	Kodi i Procedurës Penale
<b>OJF</b>	Organizata jofitimprurëse
<b>CEPEJ</b>	Council of Europe European Commission for the efficiency of justice
<b>UNROLI</b>	United Nations Rule of Law Indicators
<b>OECD</b>	Organisation for Economic Co-operation and Development
<b>WJP</b>	World Justice Project



## Pasqyra e lëndës

SHKURTIME.....	3
PËRMBLEDHJE .....	11
HYRJE.....	13

### Pjesa 1

#### AKSESI NË DREJTËSI CILËSORE, KOMUNIKIMI ME PËRDORUESIT E GJYKATAVE DHE PUBLIKUN

Faktori 1.1 - Gjykimi i drejtë.....	17
Standardet e performancës .....	18
Treguesit e realizimit.....	19
Metoda e matjes.....	19
Standardet e performancës .....	20
Treguesit e realizimit.....	20
Metoda e matjes.....	22
Faktori 1.1. iii. Barazia e armëve dhe kontradiktoriteti në procesin civil dhe administrativ .....	22
Standardet e performancës .....	22
Treguesit e realizimit.....	23
Metoda e matjes.....	24
Faktori 1.1. iv. Barazia e armëve dhe kontradiktoriteti në procesin penal.....	25
Standardet e performancës .....	25
Treguesit e realizimit.....	25
Metoda e matjes.....	26
Faktori 1.1. v. Arsytimi i vendimeve gjyqësore.....	27
Standardet e performancës .....	27
Treguesit e realizimit.....	27
Metoda e matjes.....	28
Faktori vi. Parimi i sigurisë juridike në procesin civil dhe administrativ .....	28
Standardet e performancës .....	28
Treguesit e realizimit.....	29
Metoda e matjes.....	30
Faktori 1.1. vii. Parimi i sigurisë juridike në procesin penal .....	30
Standardet e performancës .....	30
Treguesit të realizimit .....	30
Metoda e matjes.....	31

Faktori 1.1. viii. Parimi i disponibilitetit .....	31
Standardet e performancës .....	31
Treguesit e realizimit.....	32
Metoda e matjes.....	32
Faktori 1.1.ix. Parimi i mosrëndimit të pozitës së të pandehurit .....	33
Standardet e performancës .....	33
Treguesit e realizimit.....	33
Metoda e matjes.....	34
Faktori 1.1.x. Parimi i prezumimit të pafajësisë .....	34
Standardet e performancës .....	34
Treguesit e realizimit.....	34
Metoda e matjes .....	35
Faktori 1.1.xi. Parimet e mosdënimit pa ligj dhe ligjit penal favorizues i cili ka fuqi prapavepruese .....	35
Standardet e performancës .....	35
Treguesit e realizimit.....	36
Metoda e matjes.....	37
Faktori 1.2 - Gjykimi nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme .....	37
Standardet e performancës .....	37
Treguesit e realizimit.....	39
Metoda e matjes.....	41
Faktori 1.3 – Gjykimi nga një gjykatë e caktuar me ligj .....	41
Standardet e performancës .....	41
Treguesit e realizimit.....	42
Metoda e matjes.....	43
Faktori 1.4 – E drejta për të pasur një gjykim publik .....	43
Standardet e performancës .....	43
Treguesit e realizimit.....	43
Metoda e matjes.....	44
Faktori 1.5 Efektiviteti i të drejtës së ankimit .....	44
Standardet e performancës .....	44
Treguesit e realizimit.....	45
Metoda e matjes.....	47
Faktori 1.6 Masat preventive për mbrojtjen e palëve në proces .....	47
Standardet e performancës .....	47
Treguesit e realizimit.....	48
Metoda e matjes.....	48
Faktori 1.7 Komunikimi i gjykatave me publikun .....	49
Standardet e performancës .....	49
Treguesit e realizimit.....	49
Metoda e matjes.....	51

Faktori 1.8 Kufizimi i aksesit të publikut në të dhënat personale në vendimet gjyqësore .....	51
Standardet e performancës .....	51
Treguesit e realizimit.....	52
Metoda e matjes.....	52

## Pjesa 2

### AKSESI NË DREJTËSI NËPËRMJET NDIHMËS JURIDIKE

Faktori 2.1 Ndhimja juridike për t'u njohur me legjislacionin dhe për të zgjidhur problemet ligjore .....	53
Standardet e performancës .....	53
Treguesit e realizimit.....	54
Metoda e matjes.....	56
Faktori 2.2 Ndhimja juridike për të aksesuar gjykatën.....	56
Standardet e performancës .....	56
Treguesit e realizimit.....	58
Metodat e matjes .....	59
Faktori 2.3 Përjashtimi nga pagesa e tarifave dhe shpenzimeve gjyqësore .....	60
Standardet e performancës .....	60
Treguesit e realizimit.....	60
Metoda e matjes.....	61
Faktori 2.4 Efektiviteti i praktikave të punës së organeve përgjegjëse për funksionimin e skemës shtetërore të ndihmës juridike .....	62
Standardet e performancës .....	62
Treguesit e realizimit.....	62
Metoda e matjes.....	64

## Pjesa 3

### MONITORIMI I GJENDJES SË AKSESIT FIZIK NË GJYKATA

Faktori 3.1 Efektiviteti i hartës gjyqësore në kuadër të aksesit të qytetarëve në proceset gjyqësore dhe shërbimet administrative .....	65
Standardet e performancës .....	65
Treguesit e realizimit.....	66
Metoda e matjes.....	68
Faktori 3.2 Zbatimi i procedurave elektronike në gjykimin e mosmarrëveshjeve.....	68
Standardet e performancës .....	68
Treguesit e realizimit.....	70
Metoda e matjes .....	71
Faktori 3.3 Aksesit në gjykatë i personave me aftësi të kufizuara.....	71
Standardet e performancës .....	71
Treguesit e realizimit.....	72
Metoda e matjes.....	73

Faktori 3.4 Akuza private në procesin penal .....	74
Standardet e performancës .....	74
Treguesit e realizimit.....	74
Metoda e matjes.....	75
Faktori 3.5 Tarifat dhe shpenzimet gjyqësore.....	75
Standardet e performancës .....	75
Treguesit e realizimit.....	76
Metoda e matjes.....	77

#### Pjesa 4

##### MONITORIMI I GJYKIMIT BRENDA NJË AFATI TË ARSYESHËM

Faktori 4.1 Veprimtaria e gjykatave në respektimin e afateve të arsyeshme për zhvillimin e proceseve gjyqësore.....	78
Standardet e performancës .....	78
Treguesit e realizimit.....	80
Metoda e matjes.....	81
Faktori 4.2 Roli i gjykatave më të larta në mbikëqyrjen e garantimit e të drejtës për t'u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm.....	82
Standardet e performancës .....	82
Treguesit e realizimit.....	82
Metoda e matjes.....	83
Faktori 4.3 Efektiviteti i ekzekutimit të vendimeve gjyqësore.....	83
Standardet e performancës .....	83
Treguesit e realizimit.....	84
Metoda e matjes.....	85
Faktori 4.4 Efektiviteti i vendimeve të organeve të drejtësisë për garantimin e të drejtës për t'u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm.....	85
Standardet e performancës .....	85
Treguesit e realizimit.....	86
Metoda e matjes.....	87

#### Pjesa 5

##### MONITORIMI I CILËSISË SË GJYKIMEVE

Faktori 5.1 Kontrolli i vendimeve gjyqësore nga gjykatat më të larta .....	88
Standardet e performancës .....	88
Treguesit e realizimit.....	89
Metoda e matjes.....	90
Faktori 5.2 Roli i organeve të qeverisjes së sistemit të drejtësisë në monitorimin e cilësisë së vendimeve .....	90
Standardet e performancës .....	90
Treguesit e realizimit.....	91
Metoda e matjes.....	92



Faktori 5.3 Roli i Shkollës së Magjistraturës në përmirësimin e cilësisë së vendimeve gjyqësore .....	92
Standardet e performancës .....	92
Treguesit e realizimit.....	93
Metoda e matjes.....	94
Faktori 5.4 Zbatimi i mjeteve alternative për zgjidhjen jashtëgjyqësisht të mosmarrëveshjeve.....	94
Standardet e performancës .....	94
Treguesit e realizimit.....	95
Metoda e matjes.....	96
 BIBLIOGRAFIA .....	 97



## PËRMBLEDHJE

Aksesi në drejtësi dhe gjykimi i drejtë janë nga të drejtat më të rëndësishme të njeriut, origjinën e të cilave e gjejmë që në Magna Carta Libertatum (karta e Madhe e Lirive) e vitit 1215, ku neni 39 i saj parashikonte se *“Asnjë njeri i lirë nuk do të ndalohet ose burgoset, ose hiqet nga të drejtat ose zotërimet e tij, ose të nxirret jashtë ligjit ose të internohet, ose të privohet nga pozita e tij në ndonjë mënyrë tjetër, as nuk do të vijohet me forcë kundër tij, ose nuk do të dërgohen të tjerë për ta bërë këtë, përveçse nga gjykimi i ligjshëm i të barabartëve të tij ose nga ligji i vendit”*.<sup>1</sup> Që nga ajo kohë, në mënyrë graduale, aksesit në drejtësi dhe e drejta për një gjykim të drejtë janë bërë ndër të drejtat më të rëndësishme kushtetuese.

Aksesi në drejtësi, si koncept, përfshin të gjitha elementet e nevojshme për t’u mundësuar njerëzve të identifikojnë dhe të përmbushin nevojat e tyre të përditshme ligjore, të adresojnë problemet e tyre ligjore, të kërkojnë zgjidhje për ankesat e tyre dhe të kërkojnë që të drejtat e tyre të respektohen<sup>2</sup>.

Parimi i aksesit në drejtësi është i lidhur ngushtë me një parim tjetër garantues të drejtësisë dhe demokracisë në shoqëri, parimit të shtetit të së drejtës. Funkcionaliteti i shtetit të së drejtës kuptohet shprehimisht përmes zbatimit të drejtë të ligjeve në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve. Në kuadër të zhvillimit demokratik të shtetit të së drejtës, fokusi duhet të zhvendoset në disponueshmërinë e drejtësisë, qartësinë e procedurës, kostot e arsyeshme të procedurave dhe cilësinë e vendimeve<sup>3</sup>. Mungesa e aksesit në drejtësi pengon zhvillimin e shoqërisë dhe që individët të luftojnë varfërinë<sup>4</sup>.

Në vitin 2008, Komisioni i Kombeve të Bashkuara për Fuqizimin Ligjor të shtresave në nevojë vlerësoi se më shumë se gjysma e popullsisë së botës jeton jashtë mbrojtjes efektive të ligjit. Garantimi i aksesit në drejtësi lidhet drejtpërdrejt me Objektivin e Zhvillimit të Qëndrueshëm të Kombeve të Bashkuara (SDG) ku në indikatorin 16.3 vendoset theksi në promovimin e shtetit të së drejtës në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar dhe sigurimin në mënyrë të barabartë të aksesit në drejtësi për të gjithë<sup>5</sup>.

Garantimi i aksesit në drejtësi dhe i gjykimit të drejtë, parashikohet në disa dispozita të Kushtetutës së Shqipërisë, specifikisht në nenet 42 dhe 43 të Kushtetutës. Respektimi dhe garantimi i gjykimit të drejtë është një nga të drejtat themelore të parashikuara në KEDNJ.

1. <https://sourcebooks.fordham.edu/source/magnacarta.asp>

2. A2JBC Working Group, School of Criminology, University of the Fraser Valley, & International Centre for Criminal Law Reform and Criminal Justice Policy: Access to Justice Measurement Framework, faqe 1.

3. International Development Law Organization: Access to Justice: A Conceptual and Practical Analysis ëith Implications for Justice Reforms, faqe 4.

4. Julio C. Teehankee, Ph.D. De La Salle University – Manila: Access to Justice Indicators in the Asia-Pacific Region, faqe 1.

5. <https://www.un.org/en/development/desa/what-we-do/rule-of-law.html>

GjEDNj, si një nga gjykatat “gardiane” që gjykon respektimin e të drejtave të njeriut nga shtetet anëtare, ka elaboruar ndër vite kufijtë dhe çfarë do të përfshijë e drejta për t’iu drejtuar gjykatës dhe e drejta për të pasur një gjykim të drejtë.

Në këtë guidë do të pasqyrohet jurisprudenca gjyqësore kombëtare dhe ndërkombëtare që ka jetëzuar konceptin e aksesit në drejtësi dhe zhvillimit të një gjykimi të drejtë, si një element thelbësor për respektimin dhe rivendosjen në vend të të drejtave të shkelura. Në këtë mënyrë, do të analizohen disa nga komponentët më të rëndësishëm që lidhen me aksesin në drejtësi dhe procesin e rregullt ligjor, konkretisht: gjykimi i drejtë, gjykimi nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, gjykimi nga një gjykatë e caktuar me ligj, gjykimi brenda një afati të arsyeshëm, aksesin në gjykatë të personave me aftësi të kufizuara, aksesin në drejtësi nëpërmjet ndihmës juridike, mjetet alternative për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, etj.

Faktorët e mësipërm janë pasqyruar sipas parashikimeve në legjislacionin vendës dhe të KEDNj dhe janë analizuar bazuar në jurisprudencën e GjK-së, GjL-së dhe GjEDNj-së. Për përcaktimin e treguesve të realizimit janë mbajtur në konsideratë kriteret e Council of Europe European Commission for the efficiency of justice (CEPEJ), United Nations Rule of Law Indicators (UNROLI), Organisation for Economic Co-operation and Development (OECD), World Justice Project (WJP), Global Integrity, The Justice Index. Treguesit e realizimit janë shfaqur në përqindje, konstatim PO/JO dhe shifra absolute, në varësi të tipit të indikatorit. Mënyrat e matjes përmbajnë paraqitjen e kërkesave për informacion, analizën e të dhënave zyrtare, zhvillimin e sondazheve, etj.

Kjo Guidë është hartuar në kuadër të projektit “Judiciary under spotlight” i zbatuar nga konsorciumi prej tre partnerësh, Instituti për Studimet Publike dhe Ligjore (ISPL), Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë (OSFA) dhe Centre for Legal Empowerment (CLE) me mbështetjen e Bashkimit Evropian në kuadër të kornizës “Civil Society Facility and Media Programme 2021” nën IPA III/2022/441-466. Projekti synon të fuqizojë shoqërinë civile të Shqipërisë dhe aktorët e tjerë për të zhvilluar monitorimin dhe vlerësimin e gjyqësorit dhe ushtrimit të veprimtarisë së tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.

## HYRJE

Aksesi në drejtësi dhe gjykimi i drejtë janë parashikuar në Kushtetutë si instrumente thelbësore për sa i përket respektimit dhe garantimit të të drejtave të tjera. Paketa e lirive dhe të drejtave është e shoqëruar përherë me mbartjen e rrezikut të cenimit të tyre dhe, nga ana tjetër, me ofrimin dhe garantimin e mjeteve ligjore me qëllim rivendosjen në vend të këtyre të drejtave, nëse ato cenohen. Nëse një shtet nuk do të kishte ofruar dhe garantuar aksesin në drejtësi dhe rregullat e gjykimit të drejtë, atëherë gëzimi i lirive dhe i të drejtave do të rrezikonte të ishte jo efektiv.

Kjo Guidë është hartuar në kuadër të projektit “Judiciary under spotlight” i zbatuar nga konsorciumi prej tre partnerësh, Instituti për Studimet Publike dhe Ligjore (ISPL), Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë (OSFA) dhe Centre for Legal Empowerment (CLE) me mbështetjen e Bashkimit Evropian në kuadër të kornizës “Civil Society Facility and Media Programme 2021” nën IPA III/2022/441-466.

Kjo Guidë ka për qëllim që të përcjellë tek organizatat e shoqërisë civile të angazhuara në fushat e sistemit të drejtësisë dhe ndihmës juridike, studentëve të drejtësisë dhe gazetarëve, informacion për monitorimin e respektimit të parashikimeve ligjore të aksesit në drejtësi dhe gjykimit të drejtë, duke analizuar standardet e performancës të parashikuara në ligj dhe duke pasqyruar treguesit e realizimit dhe mënyrat e matjes së tyre. Synimi përfundimtar i zbatimit të Guidës është aftësimi i aktorëve të shoqërisë civile të ndërmarrin nisma në kuadër të llogaridhënies efektive, rritjes së përgjegjshmërisë nga ana e institucioneve të drejtësisë dhe përmirësimit të legjislacionit nëpërmjet:

- Zhvillimit të një kornize të përgjithshme matjeje për të monitoruar përvojën e qytetarëve në plotësimin e nevojave të tyre të përditshme ligjore dhe në aksesin në sistemin e drejtësisë.
- Ofritit për organizatat e shoqërisë civile të angazhuara në fushat e sistemit të drejtësisë dhe ndihmës juridike, studentëve të drejtësisë dhe gazetarëve të një kornize të përbashkët referimi, në mënyrë që të nxiten, përmirësohen dhe harmonizohen nismat e tyre për të monitoruar aksesin në drejtësi të qytetarëve.

Guida organizohet në 5 pjesë. Në pjesën e parë trajtohet aksesin në drejtësi cilësore, komunikimi me përdoruesit e gjykatave dhe publikun, duke u fokusuar te gjykimi i drejtë (*e drejta e mbrojtjes, barazia e armëve dhe kontradiktoriteti, arsytimi i vendimeve gjyqësore, siguria juridike, disponibiliteti, parimi i mosrëndimit të pozitës së të pandehurit, parimi i prezumimit të pafajësisë, mosdënimit pa ligj*); gjykimi nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, gjykimi nga një gjykatë e caktuar me ligj, e drejta për të pasur një gjykimi publik, e drejta e ankimit,

masat preventive për mbrojtjen e palëve në proces dhe komunikimi i gjykatave me palët dhe publikun.

Në pjesën e dytë trajtohet aksesit në drejtësi nëpërmjet ndihmës juridike parësore, dytësore dhe përjashtimit nga tarifrat dhe shpenzimet gjyqësore dhe roli i organeve publike në garantimin e kësaj të drejte.

Në pjesën e tretë trajtohet monitorimi i aksesit fizik në gjykata, duke analizuar efektivitetin e hartës gjyqësore në kuadër të aksesit të qytetarëve në proceset gjyqësore dhe shërbimet administrative, zbatimin e procedurave elektronike në gjykimin e mosmarrëveshjeve, sigurimin e aksesit në gjykatë për personat me aftësi të kufizuara dhe tarifrat dhe shpenzimet gjyqësore.

Në pjesën e katërt trajtohet monitorimi i gjykimit brenda një afati të arsyeshëm, duke analizuar veprimtarinë e gjykatave në respektimin e afateve të arsyeshme për zhvillimin e proceseve gjyqësore, rolin e gjykatave më të larta në mbikëqyrjen e garantimit të së drejtës për t'u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm, efektivitetin e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore dhe efektivitetin e vendimeve të organeve të drejtësisë për garantimin e kësaj të drejte.

Në pjesën e pestë trajtohet monitorimi i cilësisë së vendimeve gjyqësore, duke u fokusuar te kontrolli i vendimeve gjyqësore nga gjykatat më të larta, roli i organeve të qeverisjes së sistemit të drejtësisë në monitorimin e cilësisë së vendimeve, roli i ShM-së në përmirësimin e cilësisë së vendimeve gjyqësore dhe zbatimimi i mjeteve alternative për zgjidhjen jashtëgjyqësisht të mosmarrëveshjeve.

Në secilën nga pjesët është mbajtur në konsideratë që faktorët e zhvilluar së bashku me standardet e performancës, treguesit e realizimit dhe metodat e matjes, të pasqyrohen me një terminologji të thjeshtë, me qëllim që lexuesit të jenë në gjendje t'i kuptojnë, të kenë mundësi të zhvillojnë përfundimet e tyre dhe që t'i zbatojnë në veprimtarinë e tyre të përditshme.

## **STANDARDET NDËRKOMBËTARE**

Standardet ndërkombëtare dhe treguesit për cilësinë e aksesit në drejtësi dhe gjykimin të drejtë, janë analizuar duke marrë parasysh ekspertizën e organizatave evropiane dhe ndërkombëtare CEPEJ, UNROLI, OECD, WJP, Global Integrity, The Justice Index. Gjithashtu, Standardet e performancës për secilin nga faktorët janë analizuar bazuar në jurisprudencën e GjEDNj-së.

## **KUADRI LIGJOR DHE STRATEGJIK NË FUQI NË R.Sh**

- Kushtetuta
- Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut
- Kodi i Procedurës Civile, i ndryshuar
- Kodi i Procedurës Penale, i ndryshuar
- Ligji nr. 49/2012 "*Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative*", i ndryshuar

- Ligj nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”
- Ligj nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”
- Ligj nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”
- Ligj nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”
- Ligj nr.10 385, datë 24.2.2011 “Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve”, i ndryshuar.
- Ligji nr.9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.
- Udhëzimi i Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale nr. 15 datë 23.12.2011, “Për përpunimin dhe publikimin e të dhënave personale në sistemin gjyqësor”.
- Vendim i KLGj-së nr. 590, datë 26.11.2020 për **miratimin e** “Planit Strategjik të Komunikimit për Sistemin Gjyqësor”.
- Direktiva 2012/29/EU datë 25 tetor 2012 e Bashkimit Evropian.





## Pjesa 1

# AKSESI NË DREJTËSI CILËSORE, KOMUNIKIMI ME PËRDORUESIT E GJYKATAVE DHE PUBLIKUN

### Faktori 1.1 - Gjykimi i drejtë

Në nenin 42, pika 2 të Kushtetutës, parashikohet që: *“Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe interesave të tij kushtetuese dhe ligjore, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj”*. Në një shoqëri demokratike, e drejta për administrim të mirë të drejtësisë zë vend të rëndësishëm dhe administrimi i mirë i drejtësisë fillon me garancinë që një individ të ketë akses në gjykatë, për t’i siguruar atij të gjitha standardet dhe garancitë procedurale për shqyrtimin e çështjes nga një gjykatë e pavarur, e paanshme dhe e krijuar me ligj. Aksesit në gjykatë duhet të jetë substantiv dhe jo thjesht formal<sup>6</sup>. E drejta për t’iu drejtuar gjykatës nuk ka karakter absolut. Ajo mund të ketë kufizime, por ato nuk duhet të kufizojnë hapësirën e aksesit për individin në një mënyrë të tillë sa e drejta të preket në thelbin e saj<sup>7</sup>. Në radhë të parë, neni 42/2 i Kushtetutës e përcakton si një të drejtë themelore të qytetarëve që për mbrojtje të të drejtave, lirive e interesave të tyre ligjore e kushtetuese, t’i drejtohen gjykatës. Në kuadër të zhvillimit të një procesi të rregullt ligjor, është e nevojshme që drejtësia jo vetëm duhet të bëhet, por ajo gjithashtu duhet të shikohet që bëhet. Me qëllim informimin e publikut, për palët të cilat nuk janë pjesëmarrëse në një proces, administrata gjyqësore duhet të marrë masa të caktuara për mbajtjen dhe publikimin e të dhënave gjyqësore.

Gjykimi i drejtë është një pjesë e të drejtës për një proces të rregullt ligjor të parashikuar në nenin 42 të Kushtetutës dhe të materializuar në dispozitat e K.Pr.C., ligjin nr. 49/2012 dhe K.Pr.Penale. Gjykimi i drejtë ndër të tjera përfshin të drejtën e palëve për t’u mbrojtur, barazinë e armëve dhe kontradiktoritetin, arsyetimin e vendimeve gjyqësore, parimin e sigurisë juridike, parimin e disponibilitetit, parimin e mosrëndimit të pozitës së të pandehurit, parimin e prezumimit të pafajësisë, parimin e mosdënimit pa ligj dhe parimin e ligjit penal favorizues i cili ka fuqi prapavepruese.

6. Vendim nr. 14/2009 i GJK; Vendim nr. 42/2011 i GJK-së.

7. Vendim Le Compte, Van Leuven dhe De Meyere, datë 23/06/1981, GjEDNj; Sporong dhe Lönnroth, datë 23/09/1982, GjEDNj.

## **Faktori 1.1. i. E drejta e mbrojtjes në procesin civil dhe administrativ**

### ***Standardet e performancës***

Parimi i procesit të rregullt gjyqësor ka si element të vetin edhe të drejtën e secilës palë për të qenë e pranishme në seancë gjyqësore. Jurisprudenca kushtetuese dhe praktika e GjEDNj-së kanë përcaktuar standarde edhe për pjesëmarrjen në gjykim me qëllim që t'i krijohen mundësitë secilës palë për të mbrojtur efektivisht të drejtën që pretendohet si e shkelur. Pjesëmarrja e palëve në gjykim, dëgjimi i pretendimeve të tyre për provat e interpretimin e ligjit në çështjen konkrete, garantohet nga neni 42 i Kushtetutës e neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, sepse kjo pjesëmarrje shërben për të mbrojtur në substancë të drejtat e secilës palë. Krijimi i kushteve për të bërë një mbrojtje efektive është jo vetëm në interes të palëve, por edhe në interes të drejtësisë<sup>8</sup>.

E drejta e shtetasve për t'u mbrojtur përbën thelbin e konceptit që jurisprudenca kushtetuese ka krijuar për procesin e rregullt ligjor. E drejta për të qenë i pranishëm në gjykim është një pjesë përbërëse e të drejtës për t'u mbrojtur. Kjo e drejtë i ngarkon autoritetet me detyrat që të njoftojnë palët dhe mbrojtësit e tyre, në kohë të mjaftueshme, për datën dhe vendin e mbajtjes së procedurave gjyqësore, për të kërkuar praninë e tyre dhe për të mos i përjashtuar padrejtësisht nga gjykimi. Kjo është një praktikë tashmë e njohur dhe e konsoliduar e GjK-së dhe e GjEDNj-së, sipas të cilës do të ishte pa vlerë përshkrimi në detaje i garancive procedurale të palëve në proces, në rast se atyre nuk do t'u sigurohej ajo që në fakt bën të mundur respektimin e këtyre të drejtave dhe që është pjesëmarrja në gjykim.<sup>9</sup>

Palë në një proces civil janë subjektet e mosmarrëveshjes gjyqësore kundrejt të cilave gjykata e cila gjykon mosmarrëveshjen duhet të shprehet me vendim. Palë në proces janë ndërgjyqësit e procesit.

Paditësi është pala ndërgjyqëse e cila ka legjitimitet aktiv atëherë kur ai ka një interes të ligjshëm për të ngritur padinë, që synon angazhimin e gjykatës për të mbrojtur dhe vënë në vend të drejtat dhe interesat e ligjshme të shkelura<sup>10</sup>. Paditësi është pala që vë në lëvizje gjykatën për fillimin e një procesi gjyqësor. Ai është i lirë që në çdo kohë të tërheqë padinë, por gjithnjë përpara shuarjes së saj për efekt gjykimi ose në bazë të ligjit<sup>11</sup>. Paditësi është subjekti që paraqet kërkimin e objektit të padisë, të cilin e shqyrton gjykata e cila në përfundim të gjykimit e shpall atë të bazuar ose jo.

Ndërsa i padituri është pala me legjitimitet pasiv, që fiton cilësinë e palës ndërgjyqëse, në bazë të një akti të tjetërkujt dhe kundrejt tij ngrihet e drejtohet kërkitimi i padisë. Ai paraqet prapësimet mbi themelin dhe bazueshmërinë në ligj të këtij kërkitimi. Pala me legjitimitet pasiv mund të kthehet në palë me legjitimitet aktiv, duke përdorur ato mjete mbrojtëse që ligji i ka njohur palës së paditur (si kundërpadia etj), në mënyrë që ajo të arrijë të realizojë mbrojtjen e të drejtave të saj<sup>12</sup>.

8. Vendim nr. 8/2006 i GjK-së; Vendim nr. 34/2007 i GjK-së.

9. Vendim nr. 109/2002 i GjK-së; Vendim nr.11/2005 i GjK-së; Vendim nr. 27/2009 i GjK-së.

10. Vendim nr. 190/2010 i GjL-së.

11. Neni 2 K.Pr.C.

12. Vendim nr. 168/2010 i GjL-së.

Gjyqtari, kur konstaton se bashkëndërgjyqësia e detyrueshme në anën e të paditurve është e paplotë, i lë palës paditëse një afat deri në 20 ditë që ta rregullojë atë. Në rast se paditësi nuk vepron brenda afatit të mësipërm, gjykata vendos pushimin e gjykimit<sup>13</sup>.

Ligjvënësi e ka përcaktuar mosformimin e drejtë të ndërgjyqësisë si shkelje të rëndë procedurale e cila në rast se konstatohet nga Gjykata e Apelit<sup>14</sup> dhe GjL<sup>15</sup> përbën shkak për dërgimin e çështjes për rigjykim. Situata më e përsëritur e cenimit të së drejtës së mbrojtjes, është rasti kur me zgjidhjen e një çështjeje preken edhe të drejtat dhe interesat e një subjekti pa u thirrur në cilësinë e palës të paditur, duke i mohuar në këtë mënyrë të drejtën e mbrojtjes.

<b><i>Treguesit e realizimit</i></b>	<b><i>Po/Jo</i></b>
A është përcaktuar saktë subjekti të cilit i janë shkelur të drejtat dhe interesat e ligjshme dhe legjitimohet të kërkojë rivendosjen e tyre?	
A është përcaktuar saktë subjekti kundrejt të cilit drejtohet kërkimi i padisë?	
Në rast se nuk është përcaktuar në mënyrë të rregullt ndërgjyqësia, a ka marrë masa gjykata për orientimin e palëve për rregullimin e saj?	
Në rast se nuk është formuar drejt ndërgjyqësia, a është rrëzuar padia nga gjykata e shkallës së parë?	
Në rast se gjykata e shkallës së parë ka vendosur për pranimin e padisë dhe ndërgjyqësia nuk ka qenë e rregullt, a është prishur vendimi i gjykatës nga gjykatat më të larta?	

### ***Metoda e matjes***

- Analiza e vendimeve të gjykatave më të larta për vendimet e gjykatave më të ulëta për rastet kur është konstatuar shkelja e të drejtës së mbrojtjes.
- Analiza e jurisprudencës të GjK-së për vendimet e paraqitura bazuar në nenin 131/f të Kushtetutës, në kuadër të respektimit të të drejtës së mbrojtjes.
- Analiza e jurisprudencës të GjEDNj-së, për vendimet kundër Shqipërisë për respektimin e nenit 6 të KEDNj-së, në kuadër të të drejtës së mbrojtjes.
- Analiza e raporteve vjetore të gjykatave.
- Analiza e statistikave vjetore për veprimtarinë e GjK-së.

13. Neni 161 paragrafi i dytë i K.Pr.C.

14. Neni 467/d i K.Pr.C.

15. Neni 472/2 i K.Pr.C.

## Faktori 1.1. ii. E drejta e mbrojtjes në procesin penal

### *Standardet e performancës*

Marrja e provave në mënyrë të ligjshme përbën një aspekt të rëndësishëm të respektimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe nga neni 6 i KEDNj-së. Në këtë drejtim, detyra e Gjykatës është të vlerësojë nëse procesi si i tërë, duke përfshirë edhe mënyrën e marrjes së provave, ka qenë i drejtë<sup>16</sup>. Parimi bazë kushtetues që lidh provat me procesin e rregullt është i sanksionuar në nenin 32/2 të Kushtetutës, sipas të cilit askush nuk mund të deklarohet fajtor mbi bazën e të dhënave të mbledhura në mënyrë të paligjshme. Ky parim i rëndësishëm trajtohet edhe nga jurisprudenca e GjEDNj-së, në drejtim të respektimit të së drejtës për t'u mbrojtur. Nëse procesi ka qenë i rregullt, duhet kontrolluar nëse e drejta e mbrojtjes është respektuar dhe duhet verifikuar në veçanti nëse kërkuesit i është dhënë mundësia për të vënë në dyshim autenticitetin e provave dhe kundërshtuar përdorimin e tyre<sup>17</sup>.

Në bazë të KEDNj-së, gjykata e ka për detyrë të vlerësojë në tërësi, nëse ishte e drejtë procedura lidhur me mënyrën se si u siguruan provat. Mënyra e marrjes së provave ka rëndësi thelbësore për zhvillimin e drejtë të procesit penal. Sigurimi i paligjshëm i provës dhe pranimi i saj nga trupi gjykues nuk mund të mos nënkuptojë që procesi ishte i parregullt. Asnjë gjykatë nuk ka mundësi që, pa dëmtuar dhënien e “përmasës së duhur të drejtësisë”, të mbështetet në prova që janë marrë jo vetëm me metoda të pandershme, por, mbi të gjitha, që janë edhe të kundërligjshme<sup>18</sup>.

<i>Treguesit e realizimit</i>	<i>Po/Jo</i>
A është njoftuar i pandehuri ose personi nën hetim në një kohë sa më të shkurtër, në gjuhën që kupton, për veprën penale për të cilën hetohet, si edhe për shkaqet e akuzave?	
A është respektuar e drejta e të pandehurit ose e personit nën hetim të heshtë, të paraqesë lirisht mbrojtjen e tij, si dhe të mos u përgjigjet pyetjeve të caktuara?	
A është respektuar e drejta e të pandehurit ose e personit nën hetim të mbrohet vetë ose me ndihmën e një mbrojtësi të zgjedhur prej tij;	
A janë dhënë deklaratimet e nënshkruara nën efektin e kërcënimeve apo torturës?	
A është pyetur i akuzuari me cilësinë e të pandehurit?	

16. Vendim nr. 23/2009 i GjK-së; Vendim nr. 19/2008 i GjK-së; Vendim nr. 7/2005 i GjK-së; Vendim nr. 95/2001 i GjK-së.

17. Vendim Bykov kundër Rusisë, datë 10/03/2009, GjEDNj-së.

18. Vendim Vindishi kundër Austrisë, datë 27/09/1990 GjEDNj; Vendim Schenk kundër Zvicrës, datë 12/07/1988 GjEDNj.

A janë dhënë deklarimet në prani të mbrojtësit dhe janë nënshkruar rregullisht procesvebalet?	
A ka qenë gjykata në kushtet për të vendosur që të lexohen aktet e marra gjatë hetimeve paraprahe, sepse për shkak të rrethanave të paparashikuara ato nuk mund të përsëriteshin më?	
A është respektuar fakti që nuk janë të detyruar të dëshmojnë gjinia ose krushqia e afërt e të pandehurit, bashkëshorti për faktet e mësuara nga i pandehuri gjatë jetës bashkëshortore, bashkëshorti i ndarë nga i pandehuri për faktet e mësuara nga i pandehuri gjatë jetës bashkëshortore, ai që edhe pse nuk është bashkëshort i të pandehurit, bashkëjeton ose ka bashkëjetuar me të dhe ai që është i lidhur me të pandehurin me marrëdhënie birësimi?	
A është respektuar e drejta e të pandehurit ose e personit nën hetim të ketë një mbrojtës të siguar nga shteti, nëse mbrojtja është e detyrueshme ose nuk ka mundësi financiare për të pasur një mbrojtës, sipas parashikimeve të K.Pr.P. dhe legjislacionit në fuqi për ndihmë juridike?	
A është respektuar e drejta e të pandehurit ose e personit nën hetim të takohet privatisht dhe të komunikojë me mbrojtësin që e përfaqëson?	
A është respektuar e drejta e të pandehurit ose e personit nën hetim të këtë kohë të mjaftueshme dhe lehtësi për të përgatitur mbrojtjen?	
A është respektuar e drejta e të pandehurit ose e personit nën hetim të njihet me materialet e çështjes?	
A është respektuar e drejta e të pandehurit ose e personit nën hetim të paraqesë prova që i shërbejnë mbrojtjes së tij?	
A është respektuar e drejta e të arrestuarit ose të ndaluarit të takojë vetëm për vetëm mbrojtësin e tij përpara marrjes në pyetje për herë të parë?	
A është respektuar e drejta e të arrestuarit ose e të ndaluarit të njihet me aktet, provat e nevojshme dhe arsyet e arrestimit ose ndalimit të tij?	
A është respektuar e drejta e të arrestuarit ose e të ndaluarit të kërkojë që një anëtar i familjes ose një person tjetër i afërt të njoftohet menjëherë për arrestimin e tij?	
Në rast se i arrestuari ose i ndaluari është shtetas i huaj, a është respektuar e drejta e tij të kërkojë të njoftohet përfaqësia konsullore ose diplomatike e vendit të tij?	
Në rast se i arrestuari ose i ndaluari është person pa shtetësi apo refugjat, a është respektuar e drejta e tij të kërkojë të njoftohet përfaqësia konsullore ose diplomatike e vendit të tij?	

A është respektuar e drejta e të arrestuarit ose të ndaluarit të marrë menjëherë përkujdesjen e nevojshme mjekësore?	
A e ka njoftuar organi procedues të pandehurin, të arrestuarin ose të ndaluarin për të drejtat e tij duke i dhënë, kundrejt nënshkrimit, letrën e të drejtave në formë të shkruar?	

### **Metoda e matjes**

- Analiza e vendimeve të gjykatave më të larta për vendimet e gjykata më të ulëta për rastet kur është konstatuar shkelja e të drejtës së mbrojtjes.
- Analiza e jurisprudencës të GjK-së për vendimet e ankimeve të paraqitura bazuar në nenin 131/f të Kushtetutës, në kuadër të respektimit të të drejtës së mbrojtjes.
- Analiza e jurisprudencës të GjEDNj-së, për vendimet kundër Shqipërisë për respektimin e nenit 6 të KEDNj-së, në kuadër të të drejtës së mbrojtjes.
- Analiza e raporteve vjetore të gjykatave.
- Analiza e statistikave vjetore për veprimtarinë e GjK-së.

### **Faktori 1.1. iii. Barazia e armëve dhe kontradiktoriteti në procesin civil dhe administrativ**

#### **Standardet e performancës**

Parimi i barazisë së armëve nënkupton se çdokush që është palë në proces duhet të ketë mundësi të barabarta që të paraqesë çështjen e tij dhe se asnjë palë nuk duhet të gëzojë avantazh të konsiderueshëm ndaj palës tjetër, por duhet të përcaktohet një ekuilibër i drejtë mes palëve. E drejta për të marrë pjesë në gjykim nuk duhet konsideruar si një e drejtë formale, ku palëve t’u garantohet thjesht prania fizike gjatë procesit civil, por, përkundrazi, duhet që legjislacioni procedural në radhë të parë, dhe më pas gjyqtari gjatë gjykimit, t’u japin mundësi të barabarta palëve, për të paraqitur argumente dhe prova në mbrojtje të interesave të tyre. Nëse nuk do të ekzistonte barazia e armëve në gjykimin civil, atëherë argumentet e njëjës palë do të prevalonin mbi argumentet e palës së cenuar dhe, për rrjedhojë, e drejta për të marrë pjesë në gjykim do të zhvishej nga funksioni i saj kushtetues, për të garantuar një proces të rregullt ligjor. Bazuar në këto parime, gjykatës i dalin një sërë detyrash, mes të cilave rëndësi të veçantë merr krijimi i mundësive të barabarta për pjesëmarrjen e palëve apo përfaqësuesve të tyre në proces, si dhe mundësia e deklarimit të tyre për faktet, provat dhe vlerësimet ligjore që janë të lidhura ngushtë me çështjen që shqyrtohet në gjykatë<sup>19</sup>. Në këtë mënyrë, zbatimi i parimit të kontradiktoritetit duke dëgjuar më përpara të dyja palët në mosmarrëveshje, është një mënyrë logjike dhe etike, i cili i lejon gjyqtarit të vendosë për të

19. Vendim nr. 19/2003 i GjK-së ; Vendim nr. 23/2007 i GjK-së ; Vendim nr. 34/2011 i GjK-së; Vendim nr. 18/2013 i GjK-së; Vendim nr. 51/2013 i GjK-së ; Vendim Dehaes dhe Giples kundër Belgjikës, datë 04/02/1997, GjEDNj-së; Vendim Dombo Behere kundër Holandës, datë 27/10/1993, GjEDNj-së; Vendim Stratis Andreadhis kundër Greqisë datë 09/12/1994, GjEDNj; Vendim Ruiz-Mateos, kundër Spanjës datë 23/06/1993, GjEDNj.

“vërtetën” nëpërmjet bashkëpunimit me palët<sup>20</sup>.

Jurisprudenca e GjEDNj-së, e ka ngritur parimin e kontradiktoritetit në nivelin e KEDNj-së, duke e konsideruar si një element të domosdoshëm të një gjykimi të drejtë<sup>21</sup>.

Me qëllim që të garantohet pjesëmarrja e rregullt e palëve në proces, thirrja në gjykatë bëhet nëpërmjet njoftimit të letërthirrjes, e cila duhet të përmbajë gjykatën që e ka nxjerrë, emrin, mbiemrin e personit të thirrur, kohën e vendin e seancës gjyqësore, mosmarrëveshjen për të cilën thirret, kohën e njoftimit të aktit, si dhe pasojat ligjore në rast se personi i thirrur nuk paraqitet në gjykatë. Rregullat për njoftimin e palëve në gjykatë parashikohen në nenet 129 - 144/a të K.Pr.C.

Gjykata, pasi deklarohet çelja e seancës gjyqësore, verifikon paraqitjen e palëve dhe heton shkaqet kur njëra ose të dyja ato nuk janë paraqitur në seancë. Në rast se mosparaqitja ka ndodhur për shkak sëmundjeje ose për ndonjë shkak tjetër të ligjshëm, gjykata e shtyn gjykimin për një ditë tjetër. Gjykata verifikon legjitimitimin e personave ose të përfaqësuesve të tyre të paraqitur si palë dhe kur është rasti i fton ata të plotësojnë aktet dhe dokumentet që rezultojnë me të meta, duke përfshirë këtu edhe aktet lidhur me përfaqësimin, gjetjen e personit dhe kur e sheh të nevojshme, u cakton palëve një afat.

Parimi i kontradiktoritetit është ndër parimet më të rëndësishme që duhet të karakterizojnë procesin gjyqësor në kuptim edhe të neneve 18, 19 dhe 20 të K.Pr.C, lidhet me të drejtën e palëve ndërgjyqëse për t’u dëgjuar, për t’i bërë të njohur provat/pretendimet njëra-tjetrës në kohën e duhur mjetet dhe faktet mbi të cilat ato mbështesin të gjitha pretendimet e tyre, provat e grumbulluara, referencën e saktë ligjore, me qëllim realizimin sa më të drejtë të parimit të mbrojtjes së interesave të tyre në gjykim<sup>22</sup>. Parimi i barazisë së armëve nuk u imponon gjykatave të juridiksionit të zakonshëm që këto të pranojnë të gjitha argumentet dhe provat që paraqet një palë në proces. Kur kryen detyrën e saj të vlerësimit të lirë të provave, gjykata mund të bindet mbi bazën e disa provave, duke përjashtuar një ose disa prova të tjera, që ajo i konsideron të parëndësishme për çështjen<sup>23</sup>.

<b><i>Treguesit e realizimit</i></b>	<b><i>Po/Jo</i></b>
A është realizuar njoftimi i palëve në përpunje me procedurën e parashikuar në ligj për datën dhe orarin e seancës gjyqësore?	
A janë njoftuar rregullisht palët ose përfaqësuesit e tyre nga sekretari ose punonjësi i gjykatës për të zënë vendet e caktuara në sallë/zyrë përpara se të fillojë seanca gjyqësore?	
A është verifikuar nga gjykata paraqitja e palëve në seancë?	

20. Nicola Picardi, Manuale del processo civile, , seconda edizione, Giuffrè Editore, faqe 3.

21. Vendim Vermeulen kundër Belgjikës; datë 20/02/1996, GjEDNj; Vendim Nideröst-Huber kundër Zvicrës datë 18/02/1997, GjEDNj.

22. Vendim nr.69/2000 i GjK-së.

23. Vendim nr.19/2005 i GjK-së; Vendim nr.5/2003 i GjK; Vendim nr.33/2003 i GjK-së; Vendim nr.16/2006 i GjK-së; Vendim nr.13/2008 i GjK-së; Vendim nr.28/2009 i GjK-së; Vendim nr.30/2009 i GjK-së; Vendim nr 38/2010 i GjK-së.

Në rast se ndonjë nga palët nuk është paraqitur, a është verifikuar nga gjykata nëse ka pasur shkaqe të ligjshme që justifikojnë mosparaqitjen e saj?	
Në rast se pala/palët janë përfaqësuar nga përfaqësues, a është verifikuar nga gjykata nëse janë pajisur me akt përfaqësimi në përputhje me ligjin dhe për tagrat e përfaqësimit?	
A iu ka dhënë mundësi gjykata palëve të mbrohen nëpërmjet përfaqësuesve të parashikuar në ligj?	
Në rast se paditësi nuk është paraqitur ne seancë pa ndonjë shkak të ligjshëm, a ka vendosur gjykata pushimin e gjykimit?	
A e ka ftuar gjykata secilën nga palët të paraqesë faktet dhe provat mbi të cilat mbështesin pretendimet e tyre?	
A iu është dhënë palëve i njëjti akses në dokumentet gjyqësore?	
A iu ka dhënë gjykata palëve kohën e nevojshme për të përgatitur mbrojtjen (paraqitjen e pretendimeve dhe provave)?	
A iu ka dhënë gjykata palëve kohën e nevojshme dhe të barabartë në dispozicion për të parashtruar pretendimet e tyre?	
A u trajtuan palët në mënyrë të barabartë nga trupi gjykues?	
A e ka mbështetur gjykata vendimin vetëm mbi pretendimet, faktet dhe provat që janë paraqitur gjatë procesit gjyqësor?	
A e ka mbështetur gjykata vendimin në përfundimet e aktit të ekspertimit?	
Në rast se gjykata nuk e ka mbështetur vendimin në përfundimet e aktit të ekspertimit, a është arsyetuar me hollësi ky mendim në vendimin përfundimtar ose në një vendim të dhënë gjatë gjykimit?	

### **Metoda e matjes**

- Analiza e vendimeve të gjykatave më të larta për vendimet e gjykatave më të ulëta për rastet kur është konstatuar shkelja e barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit.
- Analiza e jurisprudencës të GjK-së për vendimet e ankimeve të paraqituara bazuar në nenin 131/f të Kushtetutës, në kuadër të respektimit të të drejtës së mbrojtjes.
- Analiza e jurisprudencës të GjEDNj-së, për vendimet kundër Shqipërisë për respektimin e nenit 6 të KEDNj-së, në kuadër të të drejtës së mbrojtjes.
- Analiza e raporteve vjetore të gjykatave.
- Analiza e statistikave vjetore për veprimtarinë e GjK-së.



## Faktori 1.1. iv. Barazia e armëve dhe kontradiktoriteti në procesin penal

### *Standardet e performancës*

Për vetë natyrën e tyre, barazia e armëve dhe e shanseve dhe, për rrjedhojë, vetë parimi i kontradiktoritetit, luajnë rol tepër të rëndësishëm sidomos në procesin penal, sepse në këtë rast, përballë personit të akuzuar për kryerjen e një vepre penale, normalisht është vetë shteti. Pikërisht për këtë arsye, shteti duhet të ndër marrë të gjitha masat ligjore për t'i siguruar atij ose përfaqësuesit të tij pjesëmarrjen në proces dhe përmes saj edhe mundësinë e njohjes dhe deklarimit për të gjitha faktet, provat dhe vlerësimet ligjore që i referohen akuzës së bërë. Garantimi i pjesëmarrjes së të akuzuarit ose mbrojtësit të tij në proces, në funksion të respektimit të kërkesave të mësipërme, vlen pa dyshim jo vetëm në shkallën e parë, por edhe në shqyrtimin e çështjes në shkallët e tjera të gjyqimit, veçanërisht në rastet kur në këto gjykime parashikohet edhe zhvillimi i debatit me gojë.<sup>24</sup>

Ekzistenca e mbrojtjes është një tregues esencial i një procesi të rregullt penal. Që e drejta e mbrojtjes të jetë reale dhe efektive dhe jo vetëm teorike, ushtrimi i saj nuk duhet të pengohet, por përkundrazi, gjykata duhet të marrë të gjitha masat ligjore që në funksion të procesit të drejtë, jo vetëm të sigurojë praninë e mbrojtësve në gjykim, por dhe t'i japë atij mundësinë të bëjë mbrojtje reale duke respektuar barazinë e armëve.<sup>25</sup> E drejta e gjithkujt të akuzuar penalisht për të qenë efektivisht i mbrojtur nga një avokat, kur është e nevojshme edhe i caktuar kryesisht, është një nga tiparet themelore të një gjykimi të drejtë. Mungesa e një mbrojtjeje efektive në procesin penal ka lidhje të drejtpërdrejtë me realizimin e parimit të kontradiktorialitetit si mjet efikas për zbulimin e së vërtetës, duke disponuar cilësisht edhe mjetet e barabarta<sup>26</sup>.

<i><b>Treguesit e realizimit</b></i>	<i>Po/Jo</i>
A e ka kryer gjykata verifikimin e paraqitjes së palëve para se të fillojë shqyrtimi gjyqësor?	
Në rast se palët nuk janë paraqitur, a e ka verifikuar trupi gjykues nëse njoftimet janë të rregullta dhe nëse mungesa është e justifikuar?	
A ka urdhëruar gjykata që të përsëritet thirrja për gjykim, kur ka rezultuar që i pandehuri ose personi ndaj të cilit është bërë kërkesë për gjykim nga viktimi akuzuese, nuk ka marrë njoftim ose njoftimi është i dyshimtë, rezulton se mungesa është shkaktuar nga forca madhore ose ndonjë pengesë tjetër që e përjashton nga përgjegjësia?	
A është respektuar e drejta e të pandehurit të zgjedhë deri në dy mbrojtës?	

24. Vendim Alimena kundër Italisë, datë 19/02/1991, GjEDNj, Vendim nr.19/2003 i GjJK-së.

25. Vendim nr.5/2003 i GjK-së.

26. Vendim nr.33/2003 i GjK-së.

A i ka siguruar organi procedues menjëherë një mbrojtës të paguar nga shteti të pandehurit që nuk ka zgjedhur mbrojtës ose ka mbetur pa të kur janë rastet e mbrojtjes së detyrueshme?	
A i ka siguruar organi procedues të pandehurit që nuk ka mjete financiare të mjaftueshme një mbrojtës nga lista e vendosur në dispozicion nga institucionet e ndihmës juridike falas?	
A e kanë njoftuar mbrojtësin, gjykata, prokurori dhe policia gjyqësore, kur duhet të kryejnë një veprim për të cilin parashikohet ndihma e tij?	
A i është siguruar të pandehurit të mitur ndihmë juridike dhe psikologjike, në çdo gjendje dhe shkallë të procedimit, me praninë e prindit, kujdestarit ligjor ose të personave të tjerë të kërkuar nga i mituri?	
A është respektuar e drejta për të pasur një përkthyes?	
A i është njoftuar të pandehurit dhe palëve private nga sekretaria e gjykatës që ka dhënë vendimin akti i ankimit të paraqitur nga prokurori?	
A u janë dhënë palëve mundësi të barabarta për të paraqitur argumente dhe prova?	
A është respektuar e drejta për të pasur kohë dhe mundësi të mjaftueshme për të përgatitur mbrojtjen?	
A u ka dhënë gjykata palëve kohën e nevojshme dhe të barabartë për të parashtruar pretendimet e tyre?	
Në rastin e përfaqësimit nga mbrojtësi i zgjedhur nga familjarët e të pandehurit, a u provua që i pandehuri kishte dijeni se ndaj tij ka filluar një proces penal që ai ka hequr dorë vullnetarisht nga pjesëmarrja në të?	
A u trajtuan palët në mënyrë të barabartë nga trupi gjykues?	

### **Metoda e matjes**

- Analiza e vendimeve të gjykatave më të larta për vendimet e gjykatave më të ulëta për rastet kur është konstatuar shkelja e barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit.
- Analiza e jurisprudencës të GjK-së për vendimet e ankimeve të paraqituara bazuar në nenin 131/f të Kushtetutës, në kuadër të respektimit të drejtës së mbrojtjes.
- Analiza e jurisprudencës të GjEDNj-së, për vendimet kundër Shqipërisë për respektimin e nenit 6 të KEDNj-së, në kuadër të të drejtës së mbrojtjes.
- Analiza e raporteve vjetore të gjykatave.
- Analiza e statistikave vjetore për veprimtarinë e GjK-së.

## Faktori 1.1. v. Arsyetimi i vendimeve gjyqësore

### *Standardet e performancës*

Vendimet gjyqësore që japin gjykatat e të gjitha niveleve në përfundim të gjykimit, përbëjnë aktin procedural kryesor të të gjithë procesit gjyqësor. Ato përmbledhin dhe finalizojnë përfundimisht qëndrimet që mban gjykata lidhur me çështjen në gjykim. Në nenin 142/1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë deklarohet qartë detyrimi i gjykatave për të arsyetuar çdo vendim gjyqësor që jepet prej tyre.

K.Pr.C. përcakton rregulla të sakta për formën dhe përmbajtjen e vendimeve gjyqësore. Nenet 306-309 të këtij Kodi bëjnë fjalë për mënyrën e dhënies së vendimit si dhe formën e tij. Më tej, në nenin 310, jepet përmbajtja e vendimit të gjykatës. Sipas kësaj dispozite, ky vendim duhet të përmbajë pjesën hyrëse, pjesën përshkruese-arsyetuese dhe pjesën urdhëruese. Nga sa u tha më sipër, del qartë se vendimi gjyqësor në çdo rast duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre. Ato duhet të jenë në shërbim dhe funksion të njëra-tjetrës. Argumentet e pjesës arsyetuese duhet të jenë të bazuara dhe të lidhura logjikisht, duke respektuar rregullat dhe ligjet e mendimit të drejtë. Ato duhet të formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, i cili përjashton çdo kundërthënie apo kontradiksion të hapur ose të fshehtë. Këto argumente duhet të jenë gjithashtu të mjaftueshme për të mbështetur dhe pranuar pjesën urdhëruese. Konkluzionet e pjesës arsyetuese duhet të bazohen jo vetëm në aktet ligjore, por edhe në parimet dhe rregullat që karakterizojnë mendimin e shëndoshë e logjik<sup>27</sup>. Nga ana tjetër, pjesa urdhëruese e vendimit të gjykatës duhet të jetë rezultat i natyrshëm i përfundimeve të arritura në pjesën arsyetuese. Ajo është sintezë e këtyre përfundimeve dhe si e tillë, në asnjë rast, nuk mund të jetë në kundërshtim me to. Vendimi që përmban ose lejon kontradiktën logjike, cenon rëndë dhënien e drejtësisë. Ai nuk mund të jetë i kuptueshëm dhe bindës dhe, për pasojë, nuk mund të zbatohet në praktikë<sup>28</sup>. Funksion i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta apelojnë këtë vendim, si dhe organeve të apelit ta shqyrtojnë. Nga ana tjetër, vetëm duke dhënë një vendim të arsyetuar mund të realizohet një kontroll publik i administrimit të drejtësisë<sup>29</sup>.

<i><b>Treguesit e realizimit</b></i>	<i>Po/Jo</i>
A i përmban vendimi i gjykatës të gjitha elementet e parashikuara për hyrjen e vendimit?	
A i përmban vendimi i gjykatës të gjitha elementet e parashikuara për pjesën përshkruese-arsyetuese të vendimit?	

27. Vendim nr. 33/2005 i GjK-së.

28. Vendim Haxhianastasiu kundër Greqisë, datë 16/12/1992, GjEDNj-së; Vendim Balani kundër Spanjës, datë 9/12/1994, GjEDNj.

29. Vendim nr. 36/2011 i GjK-së; Vendim nr.8/2011 i GjK-së; Vendim nr.38/2010 i GjK-së; Vendim nr.7/2009 i GjK-së; Vendim nr.25/2011 i GjK-së.

A i përmban vendimi i gjykatës të gjitha elementet e parashikuara për pjesën urdhëruese të vendimit?	
A është nënshkruar vendimi nga të gjithë anëtarët e trupit gjykues?	
A kanë paraqitur palët kërkesë për ndreqjen e gabimeve në vendimin e gjykatës dhe kërkesa është gjetur e bazuar?	
A kanë paraqitur palët kërkesë për plotësimin e vendimit të gjykatës dhe kërkesa është gjetur e bazuar?	
A kanë paraqitur palët kërkesë për sqarimin dhe interpretimin e vendimit të gjykatës dhe kërkesa është gjetur e bazuar?	
A është shpallur vendimi brenda afatit të parashikuar në ligj?	
A është arsyetuar vendimi brenda afatit të parashikuar në ligj?	

### **Metoda e matjes**

- Analiza e vendimeve të gjykatave më të larta për vendimet e gjykata më të ulëta për rastet kur është konstatuar shkelja e detyrimit për arsyetimin e vendimeve gjyqësore.
- Analiza e jurisprudencës të GjK-së për vendimet e ankimeve të paraqituara bazuar në nenin 131/f të Kushtetutës, në kuadër të respektimit të detyrimit për arsyetimin e vendimeve gjyqësore.
- Analiza e jurisprudencës të GjEDNj-së, për vendimet kundër Shqipërisë për respektimin e nenit 6 të KEDNj-së, në kuadër të detyrimit për arsyetimin e vendimeve gjyqësore.
- Analiza e raporteve vjetore të gjykatave.
- Analiza e statistikave vjetore për veprimtarinë e GjK-së.

### **Faktori vi. Parimi i sigurisë juridike në procesin civil dhe administrativ**

#### **Standardet e performancës**

Siguria juridike është ndër elementet thelbësore të shtetit të së drejtës dhe kjo siguri presupozon, veç të tjerash, besueshmërinë e qytetarëve të shteti dhe pandryshueshmërinë e ligjit për marrëdhëniet e rregulluara. Koncepti i besueshmërisë ka të bëjë me bindjen e individit se nuk duhet të shqetësohet vazhdimisht ose të jetojë me frikë për ndryshueshmërinë dhe pasojat negative të akteve juridike, të cilat mund të cenojnë jetën e tij private ose profesionale dhe të përkeqësojnë një gjendje të vendosur me akte të mëparshme.

K.Pr.C. në nenin 451 përcakton rastet kur një vendim merr formë të prerë. Në harmoni me parimin e sigurisë juridike, ligji procedural civil ka sanksionuar edhe parimin e gjësë së gjykuar, parim që pengon dhënien e çdo vendimi të ri mbi atë që është gjykuar. Sipas nenit 451/a të K.Pr.C, kur vendimi ka marrë formë të prerë ai është i detyrueshëm për palët, trashëgimtarët e tyre, për personat që tërheqin të drejta nga palët, për gjykatën që ka dhënë

vendimin dhe për të gjitha gjykatat dhe institucionet e tjera. Asnjë gjykatë nuk mundet të gjykojë sërish të njëjtën padi kundrejt të njëjtave palë. Vendimi gjyqësor i formës së prerë që përbën gjë të gjykuar është shprehje e konkretizimit i të drejtës mbi marrëdhënien juridike dhe ka qëllim t'i japë jo vetëm qartësi, por dhe siguri kësaj marrëdhënieje<sup>30</sup>.

Gjëja e gjykuar përfshin jo vetëm urdhërimet e dispozitivit të vendimit gjyqësor, por dhe vërtetimet e fakteve dhe zbatimin e së drejtës, të përcaktuara në pjesën përshkruese arsyetuese të vendimit, me kusht që të jenë kryer me qëllim të dhënies së vendimit gjyqësor dhe t'u përkasin fakteve ose marrëdhënieve që kanë formuar objektin e gjykimit mbi të cilin gjykata ka dhënë vendimin e saj<sup>31</sup>. Gjëja e gjykuar mbulon jo vetëm kërkimet, por edhe prapësimet e parashtruara apo që mund dhe duhet të ishin parashtruar për të kundërshtuar faktet konstitutive të së drejtës së pretenduar në gjykim nga ana e paditësit apo kundërpaditësit. Pra, autoriteti, fuqia e gjësë së gjykuar, mbulon jo vetëm kërkimet e prapësimet e bëra gjatë gjykimit (e njohur si autoriteti i gjësë së gjykuar të shprehur), por edhe të gjitha ato që mund dhe duhet të bëheshin me anë të ngritjes së padisë, kundërpadisë dhe prapësimeve, të cilat, ndonëse të patrajtuara në vendimin e formës së prerë, prezumohen, bëjnë pjesë në mënyrë të pashmangshme në logjikën juridike të arsyetimit, të përfundimeve dhe urdhërimeve të vendimit gjyqësor të formës së prerë (e njohur si autoriteti i gjësë së gjykuar të heshtur, të nënkuptuar).

Fuqia detyruese e urdhërimit konkret të një vendimi gjyqësor të formës së prerë shtrin efektet e tij juridike ndaj palëve pjesëmarrëse në procesin gjyqësor, trashëgimtarëve të tyre dhe personave që tërheqin të drejtat prej palëve (si në rastet e neneve 199 e 200 të K.Pr.C.).

<i><b>Treguesit e realizimit</b></i>	<i>Po/Jo</i>
A ka qenë gjykata përpara ndonjë prej rasteve të parashikuara në ligj të cilat përcaktojnë kur vendimi i gjykatës merr formë të prerë?	
A është zbatuar fuqia detyruese e vendimit të formës së prerë për palët dhe mbi personat që heqin të drejta nga palët?	
A është zbatuar fuqia detyruese e vendimit të formës së prerë mbi të tjerët që nuk kanë qenë pjesëmarrës në gjykim?	
A janë vlerësuar si “gjë e gjykuar” jo vetëm urdhërimet e dispozitivit të vendimit gjyqësor, edhe vërtetimet e fakteve dhe zbatimin e së drejtës, të përcaktuara në pjesën përshkruese arsyetuese të vendimit?	
A janë vlerësuar si “gjë e gjykuar” jo vetëm kërkimet dhe prapësimet e parashtruara, por edhe kërkimet dhe prapësimet që mund dhe duhet të ishin parashtruar?	

30. Vendim nr. 24/2008 i GjK-së; Vendim nr. 15/2012 i GjK-së; Vendim nr. 9/2007 i GjK-së.

31. Vendim nr. 24/2008 i GjK-së.

## Metoda e matjes

- Analiza e vendimeve të gjykatave më të larta për vendimet e gjykatave më të ulëta për rastet kur është konstatuar shkelja e detyrimit për respektimin e parimit të sigurisë juridike.
- Analiza e jurisprudencës të GjK-së për vendimet e ankimeve të paraqitura bazuar në nenin 131/f të Kushtetutës, në kuadër të respektimit të detyrimit për respektimin e parimit të sigurisë juridike.
- Analiza e jurisprudencës të GjEDNj-së, për vendimet kundër Shqipërisë për respektimin e nenit 6 të KEDNj-së, në kuadër të detyrimit për respektimin e parimit të sigurisë juridike.
- Analiza e raporteve vjetore të gjykatave.
- Analiza e statistikave vjetore për veprimtarinë e GjK-së.

## Faktori 1.1. vii. Parimi i sigurisë juridike në procesin penal

### Standardet e performancës

Parimin i sigurisë juridike në çështjet penale materializohet në ndalimin e gjykimit më shumë se njëherë për të njëjtën vepër penale (*ne bis in idem*). Parimi *ne bis in idem*, është një instrument kryesor juridik, një garanci thelbësore e individit, e përfshirë në dokumentet më të rëndësishme ndërkombëtare për të drejtat e njeriut<sup>32</sup>, që rregullon marrëdhëniet në fushën penale të brendshme dhe ndërkombëtare. Ky parim nënkupton se asnjë individ nuk mund të gjykohet apo dënohet përsëri për të njëjtën vepër penale, për të cilën ai është shpallur i pafajshëm ose është dënuar më parë me një vendim të formës së prerë nga një gjykatë e ligjshme. Kriteri “e njëjta vepër” i referohet të njëjtit veprim, sjellje, fakt, vepër penale dhe kualifikim ligjor të tyre, të cilat formojnë bazën e kësaj vepre dhe për të cilin personi është dënuar apo liruar<sup>33</sup>. Duke u nisur nga interpretimet e mësipërme rezulton se ky parim nuk mund të gjejë zbatim në rastet kur të dyja veprat penale nuk kanë elemente të njëjta. Nëse gjenden elemente të njëjta parimi “*ne bis in idem*” ndalon çdo dënim tjetër apo procedim të mëtejshëm<sup>34</sup>. *Res judicata* nënkupton, në aspektin fomal e procedural, mosankueshmërinë e vendimit, ndërsa, në atë substancial, fuqinë e detyrueshme të vendimit<sup>35</sup>.

<i>Tregues të realizimit</i>	<i>Po/Jo</i>
A jemi përpara rastit kur një i pandehur është gjykuar apo dënuar përsëri për të njëjtën vepër penale, për të cilën ai është shpallur i pafajshëm ose është dënuar më parë me një vendim të formës së prerë?	
A janë vlerësuar si “gjë e gjykuar” veprimet, sjelljet, faktet për të cilat personi është dënuar apo shpallur i pafajshëm me një vendim të formës së prerë?	

32. Shih nenin 4, Protokollin VII i KEDNj-së; nenin 14, § 7 të Marrëveshjes Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike; nenin 50 të Kartës së të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian.

33. Vendim nr. 33/2011 i GjK-së; Vendim nr. 5/2005 i GjK-së.

34. Vendim nr.5/2005 i GjK-së.

35. Vendim nr. 29/2006 i GjK-së; Vendim nr. 47/2011 i GjK-së.

## ***Metoda e matjes***

- Analiza e vendimeve të gjykatave më të larta për vendimet e gjykatave më të ulëta për rastet kur është konstatuar shkelja e detyrimit për respektimin e parimit të sigurisë juridike.
- Analiza e jurisprudencës të GjK-së për vendimet e ankimeve të paraqitura bazuar në nenin 131/f të Kushtetutës, në kuadër të respektimit të detyrimit për respektimin e parimit të sigurisë juridike.
- Analiza e jurisprudencës të GjEDNj-së, për vendimet kundër Shqipërisë për respektimin e nenit 6 të KEDNj-së, në kuadër të detyrimit për respektimin e parimit të sigurisë juridike.
- Analiza e raporteve vjetore të gjykatave.
- Analiza e statistikave vjetore për veprimtarinë e GjK-së.

## **Faktori 1.1. viii. Parimi i disponibilitetit**

### ***Standardet e performancës***

Në përputhje me parimet e sanksionuara në nenin 42 të Kushtetutës, K.Pr.C. rregullon/ implementon të drejtën e aksesit në një sërë dispozitash të tij. Kështu, Kodi parashikon të drejtën që ka çdo individ për të ngritur padi në një gjykatë, e cila duke pasur parasysh natyrën e saj si arbitër, nuk procedon me nismën e saj, nëse nuk vihet në lëvizje nga palët. Iniciativa për të filluar procesin i takon palës së interesuar, sepse gjykata nuk merr në shqyrtim një mosmarrëveshje nëse këtë nuk e kërkon i interesuari (neni 2 i K.Pr.C.)<sup>36</sup>. Ky parim formalizohet me paraqitjen e kërkesë-padisë me shkrim në gjykatë<sup>37</sup>, përcaktimin e përmbajtjes së padisë nga paditësi<sup>38</sup>, heqjen dorë nga gjykimi i padisë ose nga drejta e padisë<sup>39</sup> etj.

Lidhur me parimin e disponibilitetit paraqet rëndësi edhe qëndrimi që duhet të ketë gjykata ndaj padisë. Gjykata që gjykon mosmarrëveshjen duhet të shprehet mbi gjithçka që kërkohet dhe vetëm për atë që kërkohet. Ajo është e detyruar të disponojë vetëm dhe për të gjitha kërkimet e objektit të padisë. Gjykatat kanë për funksion të zgjidhin konfliktet midis palëve duke dhënë drejtësi nëpërmjet zgjidhjes së këtyre rasteve sipas dispozitave ligjore dhe normave të tjera në fuqi dhe janë të kufizuara në këtë funksion nga kërkimet e palëve (nenet 2/1, 6, 28). Drejtësia e dhënë nga gjykatat është gjithmonë konkrete dhe nuk mund të jetë qëllim në vetvete<sup>40</sup>.

Përjashtimisht, pasi është vënë në lëvizje nga palët, por nuk ka kërkesë, prapësim apo ankim, gjykata kryesisht mund të konstatojë pavlefshmërinë absolute të veprimit juridik si edhe gjykata më e lartë mund të marrë në shqyrtim kryesisht dhe të prishë vendimin e gjykatës më të ulët nëse gjykimi është zhvilluar dhe vendimi është dhënë në shkelje të rëndë procedurale sikurse janë, veç të tjerave rastet e parashikuara nga neni 467 i K.Pr.C., mungesa apo pavlefshmëria e njoftimeve, pavlefshmëria e vendimit gjyqësor etj. Pasojat e ardhura nga ekzekutimi

36. Vendim nr. 18/2009 i GjK-së.

37. Neni 153 i K.Pr.C.

38. Neni 154 i K.Pr.C.

39. Neni 201 i K.Pr.C.

40. Vendim nr. 293/2010 i GjL-së.

(përmbushja) e një veprimi juridik absolutisht të pavlefshëm zgjidhen vetëm mbi kërkesën e palëve ndërgjyqëse dhe në rastin kur gjykata kryesisht konstaton pavlefshmërinë e veprimit juridik, ajo zgjidh vetëm ato pasoja që janë objekt kërkitimi të padisë apo të kundërpadisë, pa u shprehur për pasojat për të cilat nuk ka kërkesë konkrete nga palët. Kjo nuk pengon po këto palë apo persona të tretë të mund të kërkojnë në një tjetër gjykim zgjidhjen e pasojave të lëna në heshtje nga gjykimi ku veprimi juridik është konstatuar absolutisht i pavlefshëm. Shkelja e këtij parimi procedural përbën një shkelje me karakter kushtetues, pasi lidhet drejtpërdrejtë me cenimin e të drejtës për një proces të rregullt ligjor të parashikuar në nenin 42 të Kushtetutës<sup>41</sup>.

<i><b>Treguesit e realizimit</b></i>	<i>Po/Jo</i>
A e ka pranuar gjykata për gjykim kërkesë-padinë në rastet kur në përmbajtjen e saj nuk plotësohen elementet formale për marrjen në shqyrtim?	
A u ka lënë kohë gjykata palëve për të rregulluar të metat e padisë?	
A ka ndikuar trupi gjykues nëpërmjet sugjerimeve/kërkesave për ndryshimin, pakësimin apo shtimin e objektit të padisë?	
A është shprehur gjykata në vendim mbi gjithçka që është kërkuar nga paditësi në kërkesë-padi?	
Në rast se gjykata në vendim është shprehur edhe për kërkime që nuk janë parashtruar nga paditësi në kërkesë-padi, a ka qenë përpara rasteve përjashtimore të parashikuara në ligj?	
A është shprehur gjykata në vendim vetëm për atë që është kërkuar nga paditësi në kërkesë-padi?	
A i ka pranuar gjykata kërkesat e palëve për pakësimin, shtimin dhe ndryshimin e objektit të padisë kur plotësoheshin kushtet e parashikuara në ligj?	
A i ka pranuar gjykata kërkesat e palëve për heqjen dorë nga gjykimi i padisë ose nga e drejta e padisë kur plotësoheshin kushtet e parashikuara në ligj?	

### **Metoda e matjes**

- Analiza e vendimeve të gjykatave më të larta për vendimet e gjykatave më të ulëta për rastet kur është konstatuar shkelja e detyrimit për respektimin e parimit të disponibilitetit.
- Analiza e jurisprudencës të GjK-së për vendimet e ankimeve të paraqitura bazuar në nenin 131/f të Kushtetutës, në kuadër të respektimit të detyrimit për respektimin e parimit të disponibilitetit.

41. Vendim nr. 61/2001 i GjK-së.



- Analiza e jurisprudencës të GjEDNj-së, për vendimet kundër Shqipërisë për respektimin e nenit 6 të KEDNj-së, në kuadër të detyrimit për respektimin e parimit të disponibilitetit.
- Statistikat vjetore për veprimtarinë e GjK-së.

### **Faktori 1.1.ix. Parimi i mosrëndimit të pozitës së të pandehurit**

#### ***Standardet e performancës***

Pozita e të pandehurit nuk mund të rëndohet nga gjykata që shqyrton ankimin e tij. Ky është një rregull që në doktrinë dhe në jurisprudencë njihet si parimi i mosrëndimit të pozitës së të pandehurit (*reformatio in peius-lat*). Mosrëndimi i pozitës së të pandehurit përmendet shprehimisht në legjislacionin tonë procedural penal dhe konkretisht në nenin 425 pika 3. Sipas këtij rregullimi ligjor, gjykata nuk mund të caktojë një dënim më të rëndë, të zbatojë një masë sigurimi më të rëndë, t'i japë pafajësisë një shkak më pak të favorshëm nga ai i vendimit të apeluar dhe as t'i japë faktit një cilësim juridik më të rëndë. Në K.Pr.P. ka edhe një dispozitë tjetër, konkretisht neni 244 pika 3 që nuk lejon gjykatën që të caktojë një masë sigurimi më të rëndë se ajo e kërkuar nga prokurori. Megjithëse Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe KEDNj nuk e përmendin në mënyrë të shprehur këtë parim, ai në vetvete e përmban dimensionin kushtetues. Zbatimi i parimit të mosrëndimit të pozitës së të pandehurit është një garanci më shumë për të gjykuarin, me qëllim që ai të realizojë në mënyrë efektive të drejtën për t'iu drejtuar me ankim gjykatës. E drejta për t'iu drejtuar gjykatës më të lartë merr rëndë/si në një shoqëri demokratike, prandaj askush nuk mund ta humbasë këtë përparësi. Ekzistenca e këtij parimi i jep mundësi të gjykuarve që të mos heqin dorë nga garancitë që ofron Kushtetuta, vetëm nga frika se mund të dëmtohen rëndë interesat e tyre. Parë nga ky këndvështrim, mosrespektimi i *reformatio in peius* do të përbënte njëkohësisht cenim të thelbit të një gjykimi dhe në veçanti të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe të nenit 6 të Konventës Evropiane për të drejtat e njeriut<sup>42</sup>.

<b><i>Treguesit e realizimit</i></b>	<b><i>Po/Jo</i></b>
Në rast se është paraqitur ankim vetëm nga i pandehuri, a ka caktuar gjykata një dënim më të rëndë ndaj tij?	
Në rast se është paraqitur ankim vetëm nga i pandehuri, a ka zbatuar gjykata një masë sigurimi më të rëndë ndaj tij?	
Në rast se është paraqitur ankim vetëm nga i pandehuri, a i ka dhënë gjykata pafajësisë një shkak më pak të favorshëm nga ai i vendimit të apeluar ose faktit një cilësim juridik më të rëndë?	
A ka caktuar gjykata një masë sigurimi më të rëndë se ajo e kërkuar nga prokurori?	

42. Vendim nr.13/2003 i GjK-së; Vendim 15/2008 i GjK-së.

## **Metoda e matjes**

- Analiza e vendimeve të gjykatave më të larta për vendimet e gjykatave më të ulëta për rastet kur është konstatuar shkelja e detyrimit për respektimin e parimit të mosrëndimit të pozitës së të pandehurit.
- Analiza e jurisprudencës të GjK-së për vendimet e ankimeve të paraqitura bazuar në nenin 131/f të Kushtetutës, në kuadër të respektimit të detyrimit për respektimin e parimit të mosrëndimit të pozitës së të pandehurit.
- Analiza e jurisprudencës të GjEDNj-së, për vendimet kundër Shqipërisë për respektimin e nenit 6 të KEDNj-së, në kuadër të detyrimit për respektimin e parimit të mosrëndimit të pozitës së të pandehurit.
- Analiza e raporteve vjetore të gjykatave.
- Analiza e statistikave vjetore për veprimtarinë e GjK-së.

## **Faktori 1.1.x. Parimi i prezumimit të pafajësisë**

### **Standardet e performancës**

Prezumimi i pafajësisë është një nga elementet përbërëse të procesit të rregullt ligjor. Sipas nenit 30 të Kushtetutës, kushdo quhet i pafajshëm përderisa nuk i është provuar fajësia me vendim gjyqësor të formës së prerë. Prezumimi i pafajësisë përbëhet nga disa aspekte, njëri prej të cilit është *in dubio pro reo*, pra çdo dyshim shkon në favor të të pandehurit dhe barra e provës bie kryesisht mbi organin e akuzës. Gjykatat e zakonshme nuk duhet ta fillojnë procesin me bindjen se i pandehuri ka kryer veprën penale për të cilin akuzohet, se barra e provës i takon palës akuzuese, se çdo dyshim duhet të shkojë në favor të të pandehurit, se gjykata duhet ta mbështesë vendimin në prova direkte dhe indirekte që duhet të provohen nga akuza<sup>43</sup>. Prezumimi i pafajësisë është një nga elementet e procesit të rregullt ligjor që parashikohet në nenin 6 par. 2 të KEDNj-së. Ky parim konsiderohet i shkelur nëse një vendim gjyqësor, që i përket një individi të akuzuar penalisht, reflekton një opinion që ai është fajtor përpara se të jetë provuar fajësia e tij sipas ligjit. Edhe nëse nuk ka ndonjë konkluzion formal, mjafton që të ketë një arsyetim i cili lë të kuptohet se gjykata e konsideron të akuzuarin fajtor<sup>44</sup>.

<b>Treguesit e realizimit</b>	<i>Po/Jo</i>
A e ka filluar gjykata procesin gjyqësor me bindjen se i pandehuri ka kryer veprën penale për të cilin akuzohet?	
A ka vendosur gjykata të deklarojë fajtor të pandehurin duke bazuar vetëm në një provë?	

43. Vendim nr. 23/2009 i GjK-së; Vendim nr. 9/2004 i GjK-së; Vendim nr. 47/2011 i GjK-së.

44. Vendim Allenet de Ribemont kundër Francës, datë 10/02/1995, GjEDNj.

A ka shkuar çdo dyshim lidhur me akuzën në favor të të pandehurit në vendimin e gjykatës i cili ka shpallur fajtor një të pandehur?	
A e ka mbështetur gjykata vendimin në prova të cilat provojnë përtej çdo dyshimi të arsyeshëm fajësinë e të pandehurit për kryerjen e veprës penale?	
A ka qenë barra e provës mbi organin e akuzës në vendimin e gjykatës i cili ka shpallur fajtor një të pandehur?	

### **Metoda e matjes**

- Analiza e vendimeve të gjykatave më të larta për vendimet e gjykatave më të ulëta për rastet kur është konstatuar shkelja e detyrimit për respektimin e parimit të prezumimit të pafajësisë.
- Analiza e jurisprudencës të GjK-së për vendimet e ankimeve të paraqitura bazuar në nenin 131/f të Kushtetutës, në kuadër të respektimit të detyrimit për respektimin e parimit të prezumimit të pafajësisë.
- Analiza e jurisprudencës të GjEDNj-së, për vendimet kundër Shqipërisë për respektimin e nenit 6 të KEDNj-së, në kuadër të detyrimit për respektimin e parimit të mosrëndimit të prezumimit të pafajësisë.
- Statistikat vjetore për veprimtarinë e GjK-së.

### **Faktori 1.1.xi. Parimet e mosdënimit pa ligj dhe ligjit penal favorizues i cili ka fuqi prapavepruese**

#### **Standardet e performancës**

E drejta e shtetasve për të mos u dënuar pa ligj, sanksionuar në nenin 29 të Kushtetutës dhe në nenin 7 të KEDNj-së, është një element thelbësor i shtetit të së drejtës. Ky parim duhet të interpretohet dhe zbatohet në mënyrë që të ofrojë garanci efektive kundër ndjekjes, deklarimit fajtor dhe dënimit arbitrar<sup>45</sup>.

Garancia e nenit 7 të Konventës mishëron një parim të përgjithshëm sipas të cilit, çdo vepër penale duhet të parashikohet me ligj dhe individit duhet të jetë objektivisht në gjendje të kuptojë përmbajtjen e normës penale dhe nëse është e nevojshme, me ndihmën e interpretimeve gjyqësore të saj, se çfarë veprimesh apo mosveprimesh do ta bëjnë atë përgjegjës penalisht. Kur bëhet fjalë për mundësinë e individit për të parashikuar pasojat e veprimeve të tij, nuk është e thënë që të nënkuptohet një qartësi absolute. Ligji duhet të jetë në gjendje të ndjekë rrethanat e ndryshme dhe, për këtë arsye, një standard i një parashikueshmërie të arsyeshme është i mjaftueshëm<sup>46</sup>.

Sipas nenit 29/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ligji penal favorizues ka fuqi

45. Vendim nr.14/2007 i GjK-së.

46. Vendim Veeber kundër Estonisë, datë 21/01/2003, GjEDNj; Vendimi nr. 16/2009 i GjK-së.

prapavepruese (*lex retro agit in mitius* ose *lex mitior retro agit*). Parimi i përgjithshëm që vepron në sistemin e së drejtës është ai i ndalimit të fuqisë prapavepruese të ligjit. Përrjashtimi që bëhet nga rregulli i përgjithshëm, duke i dhënë fuqi prapavepruese vetëm ligjit penal që favorizon pozitën e të pandehurit, synon t'i përgjigjet në mënyrë sa më të shpejtë e të përshtatshme vlerësimeve të ligjvënësit mbi rrezikshmërinë shoqërore të veprimeve apo mosveprimeve të caktuara si dhe të subjekteve që i kanë kryer apo mund t'i kryejnë ato në të ardhmen<sup>47</sup>. Është e drejtë sovrane e ligjvënësit që në një moment të caktuar, në përputhje me kushtet ekonomike dhe shoqërore të vendit, politikën penale apo detyrimet ndërkombëtare, të vlerësojë si të nevojshme ndryshimin e ligjit penal, duke mos dënuar ose dënuar me masa më të buta veprime apo mosveprime të caktuara që kryhen brenda territorit të tij. Dhe nëse një vlerësim i tillë është bërë tashmë nga ligjvënësi, është detyrë e organeve shtetërore (gjykatave) për ta zbatuar ligjin e ri në jetën e përditshme, menjëherë dhe sa më mirë, duke pasur parasysh parimin se "... ligji më i butë duhet të zbatohet nga gjykatat kombëtare si përsa i përket përcaktimit të veprës penale, ashtu edhe sanksioneve të parashikuara prej saj..."<sup>48</sup>

Një gjë e tillë diktohet para së gjithash për shkak të domosdoshmërisë së garantimit të stabilitetit dhe të sigurisë së marrëdhënieve juridike që vendosen ndërmjet subjekteve të ndryshme të së drejtës. Në rastin e ligjit penal, i cili si rregull kufizon lirinë individuale, është mëse e nevojshme që çdo qytetar, të dijë paraprakisht kufijtë e lirisë së tij, si dhe sanksionet që mund t'i vijnë për shkak të kapërcimit të këtyre kufijve. Ai nuk duhet të ndiejë për asnjë çast rrezikun që një ligj i ri penal që mund të parashikojë si të dënueshëm një veprim apo mosveprim të caktuar ose që mund të rëndojë pozitën e tij si i pandehur, do të ketë në të ardhmen fuqi prapavepruese<sup>49</sup>.

<b><i>Treguesit e realizimit</i></b>	<i>Po/Jo</i>
Në kohën kur ka ndodhur veprimi ose mosveprimi për të cilën është shpallur fajtor i pandehuri, a parashikohej ky veprim/mosveprim në ligj si vepër penale?	
Në kohën kur ka ndodhur veprimi ose mosveprimi për të cilën është shpallur fajtor i pandehuri, a parashikohej në ligj lloji dhe masa e dënimit?	
Në rast se ligji i ri nuk e dënon veprën penale, a është proceduar me mosfillimin e ekzekutimit të dënimit ndaj personit të dënuar ose me pushimin e ekzekutimit të dënimit në qoftë se ekzekutimi kishte filluar?	
Në rast se ligji i kohës kur është kryer vepra penale dhe ligji i mëvonshëm kanë qenë të ndryshëm, a është zbatuar ai ligj dispozitat e të cilit janë më të favorshme për personin që ka kryer veprën penale?	
Nëse vepra penale ose dënimi është amnistuar, a është pushuar çështja penale?	

47. Vendim nr.35/2005 i GjK-së; Vendim nr. 14/2007 i GjK-së.

48. Vendim G. Kundër Francës, datë 27/09/1995, GjEDNj.

49. Vendim nr. 35/2005 i GjK-së.

Nëse amnistia e veprës penale ka hyrë në fuqi pas dhënies së vendimit, a është liruar menjëherë i dënuari?	
Nëse kanë kaluar afatet e parashkrimit të ndjekjes penale, a është filluar procedim penal ndaj personit?	
Nëse kanë kaluar afatet e parashkrimit të ekzekutimit të dënimit, a ka filluar ekzekutimi i dënimit ndaj personit të dënuar?	

### **Metoda e matjes**

- Analiza e vendimeve të gjykatave më të larta për vendimet e gjykatave më të ulëta për rastet kur është konstatuar shkelja e detyrimit për respektimin e parimit të mosdënimit pa ligj dhe ligjit penal favorizues i cili ka fuqi prapavepruese.
- Analiza e jurisprudencës të GjK-së për vendimet e ankimeve të paraqitura bazuar në nenin 131/f të Kushtetutës, në kuadër të respektimit të detyrimit për respektimin e parimit të mosdënimit pa ligj dhe ligjit penal favorizues i cili ka fuqi prapavepruese.
- Analiza e jurisprudencës të GjEDNj-së, për vendimet kundër Shqipërisë për respektimin e nenit 6 të KEDNj-së, në kuadër të detyrimit për respektimin e parimit të mosdënimit pa ligj dhe ligjit penal favorizues i cili ka fuqi prapavepruese.
- Analiza e raporteve vjetore të gjykatave.
- Analiza e statistikave vjetore për veprimtarinë e GjK-së.

### **Faktori 1.2 - Gjykimi nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme**

#### **Standardet e performancës**

Në vështrim të nenit 7 të Kushtetutës pushteti ligjvënës, ekzekutiv dhe gjyqësor janë të ndarë, efektivisht të pavarur dhe të balancuar midis tyre. Ndonëse renditen njëri pas tjetrit, tri pushtetet e përmendura nuk qëndrojnë në varësi hierarkike nga njëri-tjetri dhe as nuk dominojnë apo i nënshtrohen ndikimeve reciproke extra-ligjore<sup>50</sup>.

Në nenin 145/1 të Kushtetutës parashikohet se: *“Gjyqtarët janë të pavarur dhe u nënshtrohen vetëm Kushtetutës dhe ligjeve”*. Pavarësia e gjyqtarëve dhe e gjykatave është një element thelbësor i shtetit të së drejtës. Gjykata ka theksuar se parimi i pavarësisë, i deklaruar në disa dispozita të Kushtetutës kërkon, në radhë të parë, që gjyqtarët dhe gjykatat, ndërsa japin drejtësi, t’u nënshtrohen vetëm Kushtetutës dhe ligjeve. Ata duhet të jenë të paanshëm dhe objektivë në gjykimin e çështjeve<sup>51</sup>. Gjykatat kanë të drejtën ekskluzive për funksionin e dhënies së drejtësisë. Asnjë institucion tjetër shtetëror apo zyrtar publik, përveç gjykatave të pavarura, nuk mund ta ushtrojë këtë funksion. Ky funksion i gjykatave përcakton vendin e gjyqësorit në sistemin e institucioneve të pushtetit shtetëror dhe statusin e gjyqtarëve<sup>52</sup>.

50. Vendim nr. 11/2010 i GjK-së; Vendim nr. 19/2007 i GjK-së.

51. Vendim nr. 19/2007 i GjK-së.

52. Vendim nr. 11/2010 i GjK-së; Vendim nr. 11/2008 i GjK-së.

Pavarësia e gjyqësorit kuptohet si:

- **pavarësi substanciale**, që do të thotë liri e gjykatave për të dhënë vendime, të cilat nuk bazohen në interesat e ndonjë dege tjetër të pushtetit;
- **pavarësi strukturale** që lidhet me parashikimin në Kushtetutë apo në ligj të ekzistencës së institucionit, të mënyrës së formimit të përbërjes së tij;
- **pavarësi organizative** që përfshin strukturimin e brendshëm administrativ të gjykatave;
- **pavarësi financiare** që nënkupton autonomi në hartimin e buxhetit nga vetë institucioni dhe miratimin nga legjislativi, si një zë i veçantë i buxhetit të shtetit, fonde të përshtatshme e të mjaftueshme për të realizuar qëllimin dhe detyrat e institucionit e sovranitet në lidhje me administrimin e fondeve të akorduara;
- **pavarësi personale**, që kërkon emërim në bazë të kritereve objektive, imunitet, garanci ekonomike, garanci për karrierën, sistem të transferimit dhe një sistem disiplinor<sup>53</sup>.

Në funksion të garantimit të pavarësisë së pushtetit gjyqësor duhet të jetë edhe statusi ligjor i gjyqtarëve. Garancitë kushtetuese për statusin e gjyqtarit lidhen kryesisht me emërimin, paprekshmërinë dhe palëvizshmërinë e tyre nga detyra pa shkaqe të përligjura, pa vendim të motivuar të KLGj-së si dhe me garancitë financiare. Vlerësimi i sistemit të garancive dhe pavarësia e gjyqtarëve janë ngushtësisht të ndërlidhura ndërmjet tyre<sup>54</sup>.

Një nga elementet e rëndësishme të procesit të rregullt ligjor apo të procesit të drejtë të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, është edhe ai i paanshmërisë së gjykatës në gjykimin e çështjes. Në këtë kuadër, parimi i paanshmërisë ka në vetvete elementin e vet *subjektiv*, i cili lidhet ngushtë me bindjen e brendshme që krijon gjyqtari për zgjidhjen e çështjes në gjykim, si dhe elementin *objektiv* me të cilin kuptohet dhënia e garancive të nevojshme për gjykim të paanshëm nga vetë gjykata, përmes mënjanimin prej saj të çdo dyshimi të përligjur në këtë drejtim. Ndër të tjera, gjykata duhet të jetë e kujdesshme dhe të mbajë parasysh veçanërisht problemin e përbërjes së trupit gjykues, në mënyrë që të mënjanohej nga gjykimi i çështjes gjyqtarët që nuk kanë garancitë e kërkuara për paanshmëri në kuptimin objektiv<sup>55</sup>. Një gjyqtar prezumohet i lirë nga çdo anshmëri dhe e kalon barrën e provës në këtë rast te kundërshtuesi i prezumimit dhe, se çdo gjyqtar është i paanshëm, deri sa të provohet e kundërta. Lidhur me paanësinë objektive, GjEDNj është shprehur në shumë raste se fakti i thjeshtë që gjyqtari ka marrë vendim, në vetvete, nuk mjafton për të mbështetur dyshimet rreth paanësisë së tij. Ajo që ka rëndësi është qëllimi dhe natyra e veprimeve që kryen ai gjatë procesit gjyqësor<sup>56</sup>.

Në shtetin e së drejtës, kjo kërkesë merr rëndësi të veçantë në funksion të besimit në dhënien e drejtësisë që duhet të krijojnë në çdo rast në shoqërinë demokratike jo vetëm palët në gjykim, por çdo qytetar i thjeshtë. Jurisprudenca ka konkluduar gjithashtu se, ky parim kërkon që *drejtësia jo vetëm duhet të bëhet, por ajo gjithashtu duhet të shikohet që bëhet*<sup>57</sup>.

53. Vendim nr. 11/2010 i GJK-së; Vendim nr. 5/2012 i GJK-së.

54. Vendim nr. 26/2009 i GJK-së; Vendim nr. 11/2008 i GJK-së; Vendim nr. 11/2004 i GJK-së.

55. Vendim nr. 12/2007 i GJK-së; Vendim nr. 4/2009 i GJK-së; Vendim nr. 15/2012 i GJK-së.

56. Vendim nr. 11/2008 i GJK-së; Vendim Hausschildt kundër Danimarkës datë 24/05/1989, GjEDNj; Vendim Fey kundër Austrisë, datë 24.02.1993, GjEDNj. Vendim Gautrin et al kundër Francës, datë 20.05.1998, GjEDNj.

57. Vendim nr. 12/2007 i GJK-së; Vendim nr. 4/2009 i GJK-së; Vendim nr. 15/2012 i GJK-së.

Përveç se e paanshme, gjykata duhet të jetë dhe e pavarur. Për të vlerësuar nëse një organ mund të konsiderohet “i pavarur”, duhet të shqyrtohet, *inter alia*, mënyra e zgjedhjes së anëtarëve të tij dhe kohëzgjatja e mandatit, ekzistenca e garancive ndaj presioneve të jashtme dhe nëse organi paraqitet si i pavarur<sup>58</sup>. Parimi i pavarësisë së gjykatës, duhet pasur parasysh veçanërisht prej ekzekutivit<sup>59</sup>.

Gjyqtari, i cili është caktuar me short për gjykimin e mosmarrëveshjes mund të ndodhet përpara një konflikti interesi me objektin dhe me palët ndërgjyqëse dhe, për rrjedhojë, legjislacioni ka parashkuar disa pengesa për gjykimin e mosmarrëveshjes. Në rast se gjyqtari ndodhet përpara këtyre rasteve, ai është i detyruar të heqë dorë nga gjykimi i çështjes që i është paraqitur për gjykim ose palët mund të kërkojnë përjashtimin e tij.

<b><i>Treguesit e realizimit</i></b>	<i>Po/Jo</i>
A është caktuar gjyqtari nëpërmjet zbatimit të procedurës së shortit?	
A është zhvilluar dhe dokumentuar në përputhje me ligjin nga personat përgjegjës kryerja e procedurës së shortit?	
A kishte gjyqtari interes në çështje ose në një mosmarrëveshje tjetër që ka lidhje me atë në gjykim?	
A kishte gjyqtari ose familjarë të tij marrëdhënie familjare me njërën nga palët ose nga mbrojtësit?	
A kishte gjyqtari ose familjarë të tij konflikt gjyqësor ose ishte në armiqësi apo në marrëdhënie kredie apo huaje me njërën prej palëve, ose njërin prej përfaqësuesve?	
A kishte dhënë gjyqtari këshilla ose kishte shfaqur mendim për çështjen në gjykim apo kishte marrë pjesë në gjykimin e çështjes në një shkallë tjetër të procesit, është pyetur si dëshmitar, si ekspert ose si përfaqësues i njëres apo tjetres palë?	
A ishte gjyqtari kujdestar, punëdhënës i njëres prej palëve, administrator ose kishte një detyrë tjetër në një ent, shoqatë, shoqëri ose institucion tjetër që kishte interesa për çështjen në gjykim?	
A kishte gjyqtari ndonjë shenjë korrupsioni, frikësimi, ngacmimi apo kërcënimi?	
A ishte siguria personale e gjyqtarëve, prokurorëve, avokatëve dhe familjeve të tyre, viktimave dhe dëshmitarëve, si dhe siguria e ambienteve të gjykatës, e mbrojtur mjaftueshëm?	
A ishin individë me ndikim politik dhe/ose financiar të pranishëm në sallën e gjyqit dhe/ose ndërvepruan me gjyqtarët?	

58. Vendim Langborger kundër Suedisë, datë 22/06/1989, GjEDNj.

59. Vendim Belilos kundër Zvicrës, datë 29/04/1988, GjEDNj.

A paraqitën dyshime nga publiku, OJF-të, avokatët apo mediet mbi pavarësinë apo paanësinë e gjyqtarëve?	
A kishte ndonjë gjyqtar interes (personal, financiar, politik, etnik apo ideologjik) apo çdo konflikt tjetër të mundshëm interesi në shqyrtimin e mosmarrëveshjes?	
A paraqiti gjyqtari kërkesë për të hequr dorë dhe a është pranuar kërkesa?	
A kemi qenë përpara rasteve për përjashtimin e gjyqtarit dhe a është pranuar kërkesa?	
A është zbatuar drejtë procedura për emërimin dhe shkarkimin nga detyra të gjyqtarëve?	
Në rast se gjyqtari ka pasur një mandat të caktuar për ushtrimin e funksionit, a ka qenë trupi gjykues brenda afatit të mandatit për të shqyrtuar mosmarrëveshjen?	
A është zgjatur mandati i gjyqtarit me vendim/ndikimin e pushtetit ekzekutiv në funksion të gjykimit të çështjeve të caktuara?	
A ishte gjykata e pavarur financiarisht?	
A ishte publike lista e ekspertëve nga e cila u caktua eksperti për kryerjen e aktit të ekspertimit?	
A u zbatua një sistem rotacioni në caktimin nga gjykata të ekspertit për kryerjen e aktit të ekspertimit?	

<b><i>Treguesit e realizimit</i></b>	<i>Përqindje</i>
A ishte e ndikuar gjykata në marrjen e vendimit nga pushteti ekzekutiv?	
A ishte e ndikuar gjykata në marrjen e vendimit për shkak të korrupsionit apo ndonjë ndikimi tjetër të paligjshëm?	
A ishte e ndikuar gjykata në marrjen e vendimit për shkak të interesave me karakter personal, financiar, politik, etnik apo ideologjik?	
A ishte e ndikuar gjykata në marrjen e vendimit për shkak të mungesës së sigurisë personale të anëtarëve?	



## ***Metoda e matjes***

- Analiza e vendimeve të gjykatave më të larta për vendimet e gjykatave më të ulëta për rastet kur është konstatuar shkelja e të drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme.
- Analiza e jurisprudencës të GjK-së për vendimet e ankimeve të paraqitura bazuar në nenin 131/f të Kushtetutës, në kuadër të respektimit të drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme.
- Analiza e jurisprudencës të GjEDNj-së, për vendimet kundër Shqipërisë për respektimin e nenit 6 të KEDNj-së, në kuadër të së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme.
- Analiza e raporteve vjetore të gjykatave.
- Analiza e statistikave vjetore për veprimtarinë e GjK-së.
- Zhvillimi i sondazheve lokale dhe kombëtare.

## **Faktori 1.3 – Gjykimi nga një gjykatë e caktuar me ligj**

### ***Standardet e performancës***

Një nga elementet e procesit të rregullt ligjor, sipas nenit 42 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 6 të KEDNj-së është dhe shqyrtimi i çështjes nga një *“gjykatë e caktuar me ligj”*. Ky element karakterizohet, në sensin material, nga funksioni i saj gjyqësor, që ka të bëjë me zgjidhjen e çështjeve nga organe të ngarkuara me ligj për të dhënë drejtësi. Përveç këtij kushti, këto organe duhet të shqyrtojnë dhe të vendosin mbi çështje që janë në kompetencë të tyre gjatë një procesi të zhvilluar mbi një procedurë ligjërishit të përcaktuar dhe në pajtim me rendin juridik. E drejta e çdo pale për t'u dëgjuar në seancë përpara një gjykate kompetente dhe të caktuar me ligj nënkupton që gjykata të ketë juridiksion për të gjykuar çështjen dhe që kompetenca për të vendosur për të, t'i jetë njohur nëpërmjet ligjit<sup>60</sup>. Përcaktimi i saktë i kompetencës është detyrim që rrjedh nga parimi i shtetit të së drejtës, sanksionuar në nenin 4 të Kushtetutës sipas të cilit, e drejta përbën bazën dhe kufijtë e veprimtarisë së shtetit<sup>61</sup>. Objekti i termit *“gjykatë e caktuar me ligj”* në nenin 42/2 të Kushtetutës, është të sigurojë që organizimi gjyqësor në një shoqëri demokratike të mos varet në diskrecionin e ekzekutivit, por të rregullohet me ligj të parlamentit. Shprehja *“gjykatë e caktuar me ligj”* mbulon jo vetëm bazën ligjore për ekzistencën e vetë *“gjykatës”*, por edhe përbërjen e trupit gjykues të ngarkuar për gjykimin e çdo çështjeje konkrete<sup>62</sup>.

Përbërja e rregullt e trupit gjykues është një ndër komponentët kryesorë të së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë në përputhje me ligjin. Gjykata e shkallës së parë dhe gjykata e apelit gjykojnë me trup gjykues të përbërë nga 1 dhe 3 gjyqtarë, ndërsa GjL gjykon në kolegje me trup gjykues të përbërë nga 3 dhe 5 gjyqtarë dhe në kolegje të bashkuara me pjesëmarrjen

60. Vendim nr.31/2005 i GjK-së; Vendim nr.7/2009 i GjK-së.

61. Vendim nr. 27/2009 i GjK-së.

62. Vendim nr. 18/2007 i GjK-së.

e të gjithë gjyqtarëve<sup>63</sup>.

Në çështjet penale, gjykatat e rretheve gjyqësore dhe Gjykata e Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar gjykojnë me 1 dhe 3 gjyqtarë<sup>64</sup>. Gjykatat e Apelit dhe Gjykata e Apelit kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar shqyrtojnë në shkallë të dytë, me trup gjykues të përbërë nga 1 dhe 3 gjyqtarë<sup>65</sup>. GjL gjykon në kolegje me trup gjykues të përbërë nga 3 dhe 5 gjyqtarë dhe në kolegje të bashkuara me pjesëmarrjen e të gjithë gjyqtarëve<sup>66</sup>.

<b><i>Treguesit e realizimit</i></b>	<i>Po/Jo</i>
A ishte themeluar gjykata që shqyrtonte mosmarrëveshjen në përputhje me ligjin?	
A kishte gjykata juridiksion për të gjykuar mosmarrëveshjen?	
A kishte gjykata kompetencën lëndore dhe tokësore për të gjykuar mosmarrëveshjen?	
A ishin emëruar gjyqtarët në përbërje të trupit gjykues në përputhje me ligjin?	
A i respektoi gjykata parashikimet ligjore për caktimin e trupit gjykues?	
A i respektoi gjykata parashikimet ligjore për përbërjen e trupit gjykues? (U gjykua mosmarrëveshja nga numri i duhur i gjyqtarëve?)	
A ishin të gjithë gjyqtarët vazhdimisht të pranishëm gjatë gjithë procesit?	
A ishin të gjithë gjyqtarët vazhdimisht të vëmendshëm gjatë gjithë procesit?	
Në rastin se janë themeluar dhe janë kompetente gjykata të veçanta për të mitur dhe për gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative, a janë shqyrtuar mosmarrëveshjet nga këto gjykata?	
Në rast se gjyqtari ka pasur një mandat të caktuar për ushtrimin e funksionit, a ka qenë trupi gjykues brenda afatit të mandatit për të shqyrtuar mosmarrëveshjen?	
A është përcaktuar në kërkesë-padi vlera e padisë?	

63. Neni 35 i K.Pr.C.

64. Neni 13 i K.Pr.P.

65. Neni 14 i K.Pr.P.

66. Neni 14/a i K.Pr.P.

## **Metoda e matjes**

- Analiza e vendimeve të gjykatave më të larta për vendimet e gjykatave më të ulëta për rastet kur është konstatuar shkelja e të drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj.
- Analiza e jurisprudencës të GjK-së për vendimet e ankimeve të paraqitura bazuar në nenin 131/f të Kushtetutës, në kuadër të respektimit të drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj.
- Analiza e jurisprudencës të GjEDNj-së, për vendimet kundër Shqipërisë për respektimin e nenit 6 të KEDNj-së, në kuadër të të drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj.
- Analiza e raporteve vjetore të gjykatave.
- Analiza e statistikave vjetore për veprimtarinë e GjK-së.

## **Faktori 1.4 – E drejta për të pasur një gjykim publik**

### **Standardet e performancës**

Seanca e hapur gjyqësore përbën një tipar thelbësor të së drejtës për një proces të rregullt ligjor. Karakteri i hapur i procedimeve para organeve gjyqësore sipas nenit 6/1 të KEDNj-së mbron palët ndërgjyqëse kundrejt ushtrimit të drejtësisë në fshehtësi dhe pa mbikëqyrje publike. Publiciteti në ushtrimin e drejtësisë kontribuon në përmbushjen e synimit për një proces të drejtë gjyqësor, garantimi i të cilit përbën një nga parimet themelore të një shoqërie demokratike<sup>67</sup>.

Në rastin e gjykimeve të mosmarrëveshjeve civile, seancat gjyqësore janë të hapura, përveç kur parashikohet ndryshe<sup>68</sup>. Gjykata mund të mos lejojë pjesëmarrjen e organeve të medias dhe ë tpublikut gjatë një pjese ose gjatë gjithë zhvillimit të procesit gjyqësor në interes të moralit, të rendit publik, të ruajtjes së informacionit të klasifikuar ose sigurisë kombëtar, kur e kërkojnë interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve dhe pjesëmarrësve në gjyq, kur përmenden sekrete tregtare ose shpikje industriale, në rrethana të veçanta, publikimi mund të paragjykojë interesat e drejtësisë. Në çdo rast vendimi përfundimtar i gjykatës shpallet publikisht.

<b><i>Treguesit e realizimit</i></b>	<b><i>Po/Jo</i></b>
A ishte seanca publike dhe a ishin anëtarët e publikut në gjendje të merrnin pjesë në të?	
A u bë publike koha dhe vendi i seancës?	

67. Vendim Axen kundër Republikës Federale të Gjermanisë, datë 08/12/1983, GjEDNj; Vendim nr. 17/2005 i GjK-së.

68. Neni 26 i K.Pr.C.

Nëse është përjashtuar i gjithë publiku ose një pjesë e tij nga pjesëmarrja në seancë, a u dhanë arsye ligjore të cilat justifikojnë përjashtimin e publikut (p.sh., në interes të moralit, të rendit publik, të ruajtjes së informacionit të klasifikuar ose sigurisë kombëtare, e kërkonin interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve dhe pjesëmarrësve në gjyq, përmenden sekrete tregtare ose shpikje industriale, nga publikimi i të cilave mund të cenoheshin interesa që mbrohen me ligj, publikimi mund të paragjykonte interesat e drejtësisë)?	
A morën pjesë në seancë gjyqësore me dyer të mbyllura të mitur nën 16-vjeç?	
A morën pjesë në seancë persona që ishin në gjendje dehje, intoksikimi ose çrregullimi mendor?	
A morën pjesë në seancë persona të armatosur, me përjashtim të pjesëtarëve të forcave të ruajtjes së rendit?	
A u shpall publikisht vendimi i gjykatës?	
A u kërcënuan ndonjë grup individësh, aktivistësh, reporterësh apo OJF për të parandaluar pjesëmarrjen e tyre në gjyq?	
A i ka informuar trupi gjykues personat që marrin pjesë në një gjykim me dyer të mbyllura për detyrimin që kanë për të mbajtur konfidencial informacionin e mësuar në seancë?	

### **Metoda e matjes**

- Analiza e vendimeve të gjykatave më të larta për vendimet e gjykatave më të ulëta për rastet kur është konstatuar shkelja e të drejtës për të pasur një gjykim publik.
- Analiza e jurisprudencës të GjK-së për vendimet e ankimeve të paraqitura bazuar në nenin 131/f të Kushtetutës, në kuadër të respektimit të të drejtës për të pasur një gjykim publik.
- Analiza e jurisprudencës të GjEDNj-së, për vendimet kundër Shqipërisë për respektimin e nenit 6 të KEDNj-së, në kuadër të të drejtës për të pasur një gjykim publik.
- Statistikat vjetore për veprimtarinë e GjK-së.

### **Faktori 1.5 Efektiviteti i të drejtës së ankimit**

#### **Standardet e performancës**

Në nenin 43 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë deklarohet shprehimisht se “Kushdo ka të drejtë të ankohet kundër një vendimi gjyqësor në një gjykatë më të lartë, përveçse kur në Kushtetutë parashikohet ndryshe”.

E drejta e ankimit në kuptim të nenit 43 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, duhet kuptuar si një mundësi e çdo individi për të pasur mjete të caktuara procedurale për të

kundërshtuar në një gjykatë më të lartë vendimin e dhënë ndaj tij nga një gjykatë më e ulët. Pra, me Kushtetutë, kujdo i garantohet e drejta për t'u ankuar të paktën një herë kundër çdo vendimi gjyqësor të dhënë ndaj tij. Kjo garanci e rëndësishme kushtetuese është edhe një tejkallim pozitiv krahasuar me Standardet që ofron në këtë drejtim KEDNj. Në nenin 6 të kësaj Konvente nuk parashikohet e drejta për të pretenduar mjete ankimi kundër vendimeve gjyqësore, e për pasojë, as detyrimi i shteteve palë për të ngritur gjykata apeli ose rishikimi (Gjykata të Larta ose Kasacioni)<sup>69</sup>.

Megjithatë, në nenin 2 të Protokollit 7 të Konventës, vetëm për çështjet penale, është parashikuar e drejta e çdo personi të dënuar për kryerjen e një veprë penale që të paraqesë të paktën një herë për shqyrtim në një gjykatë më të lartë çështjen e deklarimit të fajësisë ose të masës së dënimit të tij. Por, sipas paragrafit të dytë të nenit 2 të Protokollit 7 të Konventës, edhe në këto raste, shtetet palë kanë liri mjaft të gjerë vlerësimi dhe veprimi për të përjashtuar nga e drejta e ankimit vepra të lehta penale ose rastet kur personi është gjykuar në shkallë të parë nga gjykata më e lartë, etj. Madje, edhe në rastet kur parashikohet shprehimisht e drejta e ankimit në çështjet penale, ato (pra shtetet palë) janë të lira ta vlerësojnë e lejojnë atë edhe për çështje të faktit dhe të ligjit ose ta kufizojnë vetëm për çështje të ligjit.<sup>70</sup>

Në gjykimin e çështjeve civile dhe administrative mjetet e ankimit të parashikuara nga ligji për të paraqitur kundërshtimet kundër vendimeve të gjykatave janë:

- Ankimi në gjykatën e apelit, afati i të cilit është 15 ditë.
- Rekursi në GjL, afati i të cilit është 30 ditë.
- Kërkesa për rishikim, afati i të cilit është 30 ditë.
- Ankimi ose rekursi i veçantë, afati i të cilëve është 5 ditë.

<b><i>Treguesit e realizimit</i></b>	<i>Po/Jo</i>
A është paraqitur ankimi/rekurs kundër një vendimi ndaj të cilit ligji parashikon të drejtën e ankimit?	
A është paraqitur ankimi/rekursi brenda afatit të parashikuar në ligj?	
A është paraqitur ankimi/rekursi përpara gjykatës kompetente?	
A u është njoftuar ankimi/rekursi palëve pjesëmarrëse në gjykim?	
A është nënshkruar ankimi që i drejtohet gjykatës së apelit nga vetë pala, avokati ose përfaqësuesi i pajisur me prokurë?	
A janë pasqyruar në përmbajtjen e ankimit palët ndërgjyqëse, vendimi kundër të cilit bëhet ankimi, shkaqet për të cilat bëhet ankimi dhe çfarë kërkohet me ankimin?	

69. Vendim Froëein–Peukert, EMRK–Komentar, 2.Auflage, Engel Verlag 1996, f.209.

70. Vendim Krombach kundër Francës, datë 13.02.2001 GjEDNj.

A i janë bashkëlidhur ankimit kopje të ankimit/rekursit dhe të dokumenteve të tjera, aq sa janë personat që marrin pjesë në çështje si palë dhe prokura kur ankimi paraqitet nga avokati ose përfaqësuesi i palës?	
A ka qenë gjykata përpara rastit për të vendosur mospranimin e ankimit?	
A është kryer njoftimi për ditën dhe orën e gjykimit, si dhe përbërjen e trupit gjykues në përputhje me procedurën e parashikuar në ligj?	
Në rastet kur palët kanë depozituar të dhënat elektronike, a është bërë njoftimi për datën dhe orën e seancës në të dhënat elektronike?	
A është kryer shpallja ose njoftimi për seancën në gjykatën e apelit/Lartë të paktën 15 ditë para datës së gjykimit?	
A e ka shqyrtuar gjykata e apelit çështjen në mungesë, pavarësisht se dëgjimi i palëve ishte një nga detyrat e rigjykimit ose kur njoftimi ka qenë i parregullt?	
A e ka shqyrtuar gjykata e apelit/GjL çështjen brenda kufijve të ankimit/rekursit?	
A e ka shqyrtuar gjykata e apelit çështjen duke mbajtur parasysh, për aq sa janë të zbatueshme, dispozitat mbi procedurën e gjykimit në shkallë të parë?	
A ka vendosur gjykata e apelit në dhomë këshillimi për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve në rast se debati gjyqësor ishte i nevojshëm?	
A janë nënshkruar rekursi dhe të gjitha kërkesat e tjera që paraqiten në GjL nga avokati që e përfaqëson palën?	
A janë pasqyruar në përmbajtjen e rekursit palët ndërgjyqëse, vendimi që kundërshtohet, paraqitja e përmbledhur të fakteve të çështjes, shkaqet për të cilat kundërshtohet vendimi, si dhe argumentet që mbështesin pretendimin se ekzistojnë shkaqe për rekurs?	
A e ka vendosur Gjykata e Lartë në dhomë këshillimi për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve në rast se debati gjyqësor ishte i nevojshëm ose çështja paraqet rëndësi nga pikëpamja e së drejtës për njësimin ose zhvillimin e praktikës gjyqësore?	

## ***Metoda e matjes***

- Analiza e vendimeve të gjykatave më të larta për vendimet e gjykatave më të ulëta për rastet kur është konstatuar shkelja e të drejtës së ankimit.
- Analiza e jurisprudencës të GjK-së për vendimet e ankimeve të paraqitura bazuar në nenin 131/f të Kushtetutës, në kuadër të respektimit të drejtës së ankimit.
- Analiza e jurisprudencës të GjEDNj-së, për vendimet kundër Shqipërisë për respektimin e nenit 6 të KEDNJ-s, në kuadër të të drejtës së ankimit.
- Analiza e raporteve vjetore të gjykatave.
- Analiza e statistikave vjetore për veprimtarinë e GjK-së.

## **Faktori 1.6 Masat preventive për mbrojtjen e palëve në proces**

### ***Standardet e performancës***

Në gjykimin e mosmarrëveshjeve civile, paditësi mund të kërkojë marrjen e masës së përkohshme të sigurimit të padisë kur ekziston mundësia e një të drejte, mbrojtja e së cilës po kërkohet ose do të kërkohet në një proces gjyqësor dhe ekziston mundësia që ekzekutimi i vendimit për të drejtën që kërkohet të mbrohet do të bëhet i pamundur ose i vështirë. Masa e sigurimit të padisë mund të vendoset nëse:

- padia mbështetet në prova me shkresë.
- paditësi jep garanci, në masën dhe në llojin e caktuar nga gjykata, për dëmin që mund t'i shkaktohet të paditurit nga sigurimi i padisë.

Në rastin e gjykimin të mosmarrëveshjeve administrative, ligji ka parashikuar që paditësi mund t'i kërkojë gjykatës marrjen e masave të sigurimit të padisë, në rastet kur ai tregon se gjatë kohës së nevojshme të procesit, derisa të arrihet në marrjen e vendimit të themelit, ekziston mundësia e ardhjes së një dëmi të rëndë e të pariparueshëm, që rrjedh nga ekzekutimi i veprimit administrativ. Gjykata vendos masën e sigurimit të padisë nëse ekziston dyshimi i arsyeshëm, i bazuar në shkresa, për mundësinë e shkakimit të një dëmi të rëndë, të pakthyeshëm dhe të atëçastshëm për paditësin, nuk cenohet rëndë interesi publik dhe nëse shihet e nevojshme nga gjykata, paditësi jep garanci, në llojin dhe masën e caktuar për dëmin, që mund t'i shkaktohet të paditurit nga sigurimi i padisë<sup>71</sup>.

Nga ana tjetër, K.Pr.C. ka parashikuar edhe mundësinë e pezullimit të ekzekutimit të një vendimi gjyqësor të formës së prerë nga GjL:

- ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit do të sillte pasoja të rënda e të pariparueshme;

dhe/ose

- pala që ka bërë rekursin, depoziton garanci materiale që siguron ekzekutimin vendimit.

---

71. Neni 28 i ligjit nr. 49/2012.

<i>Treguesit e realizimit</i>	<i>Po/Jo</i>
A është shqyrtuar nga gjykata kërkesa për sigurimin e padisë brenda afatit 5-ditor të regjistrimit në gjykatë?	
A e ka shqyrtuar gjykata kërkesën për marrjen e masës së sigurimit të padisë në prani të palëve dhe a është njoftuar rregullisht pala tjetër për datën dhe orën e seancës për shqyrtimin e kërkesës?	
Nëse kërkesa është shqyrtuar në dhomë këshillimi, a ka qenë gjykata përpara rasteve të veçanta dhe të ngushtme për të shqyrtuar kërkesën pa praninë e palëve?	
A ka vendosur gjykata marrjen e masës së sigurimit për një kërkesë/kërkesë-padi pa palë kundërshtare?	
A i është njoftuar palës tjetër kërkesa për sigurimin e padisë dhe provat e paraqitura në mbështetje të kërkesës përpara seancës dhe duke i dhënë kohë të mjaftueshme për të organizuar mbrojtjen?	
Në rastin kur kërkesa për sigurimin e padisë është shqyrtuar përpara ngritjes së padisë, a kemi qenë përpara rasteve të veçanta dhe të ngushtme për të shqyrtuar kërkesën pa u paraqitur kërkesë-padia?	
A është vendosur një nga masat e sigurimit të padisë të parashikuara në ligj?	
A i është njoftuar palës tjetër nga GjL kërkesa për pezullimin e ekzekutimit të vendimit të Gjykatës së Apelit përpara se të merret në shqyrtim?	
A është arsyetuar nga GjL vendimi për kërkesën për pezullimin e ekzekutimit të vendimit të Gjykatës së Apelit?	
A i është njoftuar të gjitha palëve vendimi i GjL mbi kërkesën për pezullimin e ekzekutimit të vendimit të Gjykatës së Apelit?	

### ***Metoda e matjes***

- Analiza e vendimeve të gjykatave më të larta për vendimet e gjykatave më të ulëta për rastet kur është konstatuar shkelja e dispozitave ligjore për zbatimin ose refuzimin e masës së sigurimit të padisë dhe pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë.
- Analiza e jurisprudencës të GjEDNj-së, për vendimet kundër Shqipërisë për zbatimin e nenit 39 të KEDNj-së, në kuadër të zbatimit të masave provizore.
- Analiza e raporteve vjetore të gjykatave.



## Faktori 1.7 Komunikimi i gjykatave me publikun

### *Standardet e performancës*

Ligji nr. 115/2016<sup>72</sup> i ka dhënë rëndësi të veçantë komunikimit të gjykatave me publikun dhe ka ngarkuar KLGj-në me detyrat e mëposhtme:

- Krijimin, zhvillimin dhe mirëmbajtjen e një portali elektronik në internet, me qëllim ofrimin e informacionit të duhur për qasjen në drejtësi;
- Bërjen të mundur që secila gjykatë të ketë hapësirën e saj të veçantë në portalin në internet dhe t'i lejohet të publikojë në të, të dhëna për gjykatën dhe çështjet gjyqësore;
- Marrjen e masave që publiku dhe palët e interesuara të informohen mbi veprimtarinë e gjykatave, si dhe për çështje të veçanta gjyqësore;
- Miratimin dhe përditësimin e udhëzuesit standard të shtypit.

KL Gj cakton një nga anëtarët e tij për kryerjen e detyrave në lidhje me marrëdhëniet me publikun dhe cakton të paktën një gjyqtar për mediet për çdo juridiksion apeli.

Nëpërmjet vendimit nr. 590, datë 26.11.2020 KLGj ka miratuar "Planin Strategjik të Komunikimit për Sistemin Gjyqësor" nëpërmjet të cilit synohet përcaktimi i bazave për përmirësimin e marrëdhënieve të gjyqësorit me medien dhe publikun, të kuptuarit prej publikut të mjeteve dhe mënyrës së komunikimit me gjykatat, të veprimtarisë dhe të shërbimeve që ofrohen nga gjykatat, të mënyrës së marrjes së vendimeve dhe kufizimet në punën e gjyqtarëve. Gjithashtu, KLGj ka miratuar me vendimin nr. 592 datë 26.11.2020 Rregulloren "Për komunikimin e KLGj-së me medien", e cila synon lehtësimin e aksesit të informacionit për përfaqësuesit e medieve.

<i><b>Treguesit e realizimit</b></i>	<i><b>Përqindje</b></i>
Cili është niveli i kënaqësisë së përdoruesve të gjykatave me informacionin e pasqyruar në portalin elektronik në internet <a href="http://www.gjykata.gov.al">www.gjykata.gov.al</a> ?	
Cili është niveli i kënaqësisë së përfaqësuesve të medies me informacionin e pasqyruar në portalin elektronik në internet <a href="http://www.klgj.al">www.klgj.al</a> ?	
Sa funksionale janë të dhënat e kontaktit të publikuara në faqet zyrtare të internetit?	
Cili është niveli i kënaqësisë së përfaqësuesve të medies me informacionin e vendosur në dispozicion nga KLGj nëpërmjet kërkesave për informacion?	
Cili është raporti i gjykatave që kanë ose jo nëpunës të dedikuar për marrëdhëniet me medien dhe publikun?	

72. Neni 91 i ligjit nr. 115/2016.

Cili është raporti i rasteve kur është respektuar ose jo afati për vendosjen në dispozicion të informacionit nëpërmjet kërkesave për informacion?	
Cili është raporti i rasteve kur informacioni i publikuar në faqet në internet është publikuar njëherësh edhe në platformat e medieve sociale?	
Sa efektiv ka qenë komunikimi i përfaqësuesve të medias me gjyqtarët e medias në kuadër të përmirësimit dhe lehtësimit të raportimit të veprimtarisë së gjykatave dhe të informimit sa më të saktë e të shpejtë të publikut?	

<b><i>Treguesit e realizimit</i></b>	<i>Po/Jo</i>
A përmban portali elektronik në internet <a href="http://www.gjykata.gov.al">www.gjykata.gov.al</a> informacion të detajuar për strukturën e gjyqësorit dhe të gjykatave të veçanta, natyrën dhe qëllimin e procedurave gjyqësore, ndihmën juridike, kohëzgjatjen mesatare të çështjeve, tarifat gjyqësore, mjetet alternative të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve dhe çështje të tjera me interes publik?	
A është bërë publik në faqen zyrtare të Këshillit regjistrimi audio i mbledhjes plenare brenda 24 orëve nga dita e mbledhjes?	
A i është komunikuar medias përmbledhje e vendimeve gjyqësore për çështje që kanë interes të veçantë publik?	
A kanë qytetarët që flasin/lexojnë gjuhët e pakicave kombëtare akses në një version zyrtar në gjuhën e tyre për publikimet që faqet zyrtare në internet?	
A kishte gjykata një zyrë informacioni për vizitorët?	
Nëse po, a ishte zyra e informacionit për vizitorët e hapur gjatë të gjithë orarit zyrtar të punës?	
A kishte gjykata të disponueshme përmbledhje informacioni që shpërndaheshin në formën e fletëpalosjeve ose publikimeve të afishuara në ambientet e saj, për të drejtat e palëve në procesin gjyqësor, ndihmën juridike, tarifat gjyqësore, mjetet alternative të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve, etj?	
A kanë qenë të mjaftueshme burimet financiare për t'iu përgjigjur nevojave të gjykatave për të ofruar shërbime në kohë dhe cilësore për publikun?	
A kanë qenë të mjaftueshme burimet financiare për të zhvilluar aktivitete sensibilizuese dhe informuese për publikun dhe medien?	
A janë kryer trajnime nga ShM për anëtarët e KLGj-së, gjyqtarët për mediet, administratën e KLGj-së dhe nëpunësit civilë gjyqësorë të përfshirë në veprimtaritë e marrëdhënieve me publikun?	

## **Metoda e matjes**

- Zhvillimi i sondazheve me qytetarët përdorues të gjykatave.
- Zhvillimi i sondazheve me përfaqësuesit e medieve.
- Këqyrja e faqeve zyrtare në internet.
- Paraqitja e kërkesave për informacion.

## **Faktori 1.8 Kufizimi i aksesit të publikut në të dhënat personale në vendimet gjyqësore**

### **Standardet e performancës**

Të dhëna personale është çdo informacion në lidhje me një person fizik, të identifikuar ose të identifikueshëm, direkt ose indirekt, në veçanti duke iu referuar një numri identifikimi ose një a më shumë faktorëve të veçantë për identitetin e tij fizik, fiziologjik, mendor, ekonomik, kulturor apo social<sup>73</sup>. Në përmbajtjen e kërkesë-padisë që paraqitet në gjykatë paditësi ndër të tjera ka detyrim të plotësojë për çdonjërin palët ndërgjyqëse: emrin, atësinë, mbiemrin, vendbanimin ose vendqëndrimin e paditësit e të paditurit dhe të personave që përkatësisht i përfaqësojnë ata, kur ka të tillë<sup>74</sup>. Gjithashtu, vendimi i gjykatës ndër të tjera duhet të përmbajë të dhënat lidhur me palët, duke u shënuar identitetin<sup>75</sup> si dhe informacion dhe të dhëna lidhur me identitetin e ekspertëve dhe dëshmitarëve.

Në procesin penal, vendimi i gjykatës sipas rastit përmban të dhëna për identitetin e të pandehurit, subjektit ndaj të cilin kërkohet të zbatohet një masë shtrënguese dhe ndaluese, kallëzuesit, viktimës akuzuese, ekspertëve, dëshmitarëve, etj.

Në këtë mënyrë, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka miratuar Udhëzimin nr. 15 datë 23.12.2011, "Për përpunimin dhe publikimin e të dhënave personale në sistemin gjyqësor". Ky udhëzim ndër të tjera parashikon që të dhënat personale ose sensitive që përmban vendimi gjyqësor, bëhen publike vetëm nëse nga ky publikim nuk cenohen interesat legjitime të subjekteve të të dhënave dhe se subjekti i të dhënave personale informohet mbi të dhënat e tij, të cilat do të publikohen me iniciale ose të koduara në faqen zyrtare në internet, me qëllim bërjen e tij të paidentifikueshëm<sup>76</sup>. Gjithashtu, ky udhëzim parashikon edhe masat organizative dhe teknike që duhet të ndërmarrin gjykatat për zbatimin e detyrimeve të lidhura me mbrojtjen e të dhënave personale dhe sanksionet përkatëse në rast të publikimit të paautorizuar të të dhënave personale.

Vendimet gjyqësore të formës së prerë mund të përdoren për qëllime shkencore, statistikore, literature apo gazetarie dhe për përpunimin e të dhënave të parashikuara në këto vendime zbatohen kërkesat e neneve 10 dhe 11 të ligjit nr.9887, datë 10.3.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale".

73. Neni 3.1 i ligjit nr.9887, datë 10.3.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale".

74. Neni 154.1.b i K.Pr.C.

75. Neni 310.4 i K.Pr.C.

76. Paragrafi IV pikat 1 dhe 2 të Udhëzimit nr. 15 datë 23.12.2011, "Për përpunimin dhe publikimin e të dhënave personale në sistemin gjyqësor".

<i><b>Treguesit e realizimit</b></i>	<i>Po/Jo</i>
A ka marrë administrata gjyqësore masa organizative dhe teknike të parashikuara në ligj për të mbrojtur të dhënat personale nga shkatërrime të paligjshme, aksidentale, humbje aksidentale, për të mbrojtur aksesin ose përhapjen nga persona të paautorizuar?	
A janë informuar të punësuarit në sistemin gjyqësor që vijnë në dijeni me të dhënat e përpunuara gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre, që detyrohen të ruajnë konfidencialitetin edhe pas përfundimit të funksionit?	
A është siguruar aksesin në vendimin e plotë të publikuar në faqen zyrtare në internet t'u lejohet vetëm personave që kanë interes të ligjshëm në të?	
A u jepet nga administrata gjyqësore kopja fizike e vendimit gjyqësor vetëm personave që kanë interes të ligjshëm në lidhje me çështjen gjyqësore?	
A është lejuar që vendimet gjyqësore të formës së prerë mund të përdoren për qëllime shkencore, statistikore, literature apo gazetarie sipas kriterëve ligjore?	

<i><b>Treguesit e realizimit</b></i>	<i>Përqindje</i>
Cili është niveli i kënaqësisë së gazetarëve, avokatëve dhe studiuesve të së drejtës për përdorimin për qëllime shkencore, statistikore, literature apo gazetarie të vendimeve gjyqësore të formës së prerë?	
Cili është niveli i kënaqësisë së qytetarëve për mbrojtjen e aksesit ose përhapjes nga persona të paautorizuar të të dhënave personale ose sensitive që përmban vendimi gjyqësor?	
Cili është niveli i kënaqësisë së avokatëve për krijimin e aksesit nga gjykata të informacionit për mosmarrëveshjet në gjykim?	

### **Metoda e matjes**

- Analiza e vendimeve të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.
- Këqyrja e faqes zyrtare në internet të gjykatës.
- Monitorimi fizik i ofrimit të shërbimeve nga administrata gjyqësore.
- Paraqitja e kërkesave për informacion.
- Zhvillimi i sondazheve me gazetarë, avokatë dhe studiues të së drejtës.

## Pjesa 2

# AKSESI NË DREJTËSI NËPËRMJET NDIHMËS JURIDIKE

### **Faktori 2.1 Ndhma juridike për t'u njohur me legjislacionin dhe për të zgjidhur problemet ligjore**

#### ***Standardet e performancës***

Ndhmë juridike parësore është:

- i. dhënia e informacioneve në lidhje me sistemin ligjor të Republikës së Shqipërisë, aktet normative në fuqi, të drejtat dhe detyrimet e subjekteve të ligjit dhe metodat për ushtrimin e këtyre të drejtave në procesin gjyqësor dhe në atë jashtëgjyqësor;
- ii. dhënia e këshillimit;
- iii. dhënia e këshillimit mbi procedurat e ndërmjetësimit dhe zgjidhjeve alternative të mosmarrëveshjeve;
- iv. dhënia e ndihmës në hartimin dhe përpilimin e dokumenteve të nevojshme për të vënë në lëvizje administratën shtetërore ose për të kërkuar ndihmë juridike dytësore;
- v. përfaqësimi përpara organeve administrative;
- vi. dhënia e të gjitha formave të tjera të mbështetjes së nevojshme juridike që nuk përbëjnë ndihmë juridike dytësore.<sup>77</sup>

Ligji ka parashikuar dy kategori përfituesish të ndihmës juridike parësore:

- i. Kategoritë e veçanta të përfituesve të ndihmës juridike, të cilëve iu ofrohet ndihma juridike pavarësisht të ardhurave dhe pasurisë së tyre;<sup>78</sup>
- ii. Përfituesit e ndihmës juridike me të ardhura dhe pasuri të pamjaftueshme, të cilët kanë të drejtën për të përfituar ndihmë juridike kur provojnë se kanë të ardhura dhe pasuri të pamjaftueshme për të përballuar shpenzimet për këshillim, përfaqësim dhe/ose mbrojtje në çështjet penale, në çështjet administrative dhe në çështjet civile<sup>79</sup>.

Ndhma juridike parësore jepet nga:

- a. *Punonjësit me trajnim të posaçëm*; Ndhma juridike parësore jepet pranë qendrave të shërbimit të ndihmës juridike parësore ose në ambiente të tjera të përshtatshme, nga punonjësit me trajnim të posaçëm të punësuar pranë këtyre qendrave.
- b. *Nga OJF të autorizuara*; OJF japin shërbime të ndihmës juridike parësore në përputhje

77. Neni 3.b i ligjit Nr. 111/2017.

78. Neni 11 i ligjit Nr. 111/2017.

79. Neni 12 i ligjit Nr. 111/2017.

me autorizimin e miratuar nga MD. Procedurat dhe dokumentacioni për autorizimin e tyre përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave. OJF të autorizuar për dhënien e ndihmës juridike parësore përfitojnë financime nga buxheti i shtetit, pas një procesi konkurrues dhe transparent përzgjedhjeje.

- c. *Nga klinikat ligjore pranë institucioneve të arsimit të lartë; DNjF bashkëpunon me klinikat ligjore, sipas kushteve dhe kriterëve të parashikuara në marrëveshjet përkatëse të bashkëpunimit për trajnimin dhe përditësimin e njohurive të studentëve të përfshirë pranë këtyre klinikave, mbi çështjet e lidhura me ndihmën juridike parësore*<sup>80</sup>.

Kërkesa për dhënien e ndihmës juridike parësore bëhet me gojë ose me shkrim nga personi i interesuar pranë një qendre shërbimi për ndihmë juridike parësore ose një OJF të autorizuar. Personi, i cili kërkon të përfitojë ndihmën juridike parësore duhet të nënshkruajë një vetëdeklarim se përmbush kriteret e përcaktuara në këtë ligj, sipas formularit të vetëdeklarimit të miratuar nga MD, të shoqëruar me dokumentacionin justifikues<sup>81</sup>.

<b><i>Treguesit e realizimit</i></b>	<i>Po/Jo</i>
A është miratuar një strategji kombëtare për edukimin ligjor të publikut?	
A janë publikuar në një format të aksesueshëm formularët për të kërkuar përfitimin e ndihmës juridike parësore?	
A janë themeluar në një numër të mjaftueshëm Qendrat e Ndhmës Juridike Parësore?	
A janë vendosur Qendrat e Ndhmës Juridike Parësore pranë vendeve që mund të aksesohen lehtësisht nga qytetarët?	
A janë autorizuar OJF për të ofruar ndihmë juridike?	
A kanë përfituar mbështetje financiare nga buxheti i shtetit OJF të autorizuar për të ofruar ndihmë juridike?	
A është publikuar lista e OJF-ve të autorizuar që ofrojnë shërbime të ndihmës juridike parësore dhe adresat e tyre të kontaktit?	
A janë lidhur kontrata me OJF për shërbimet e ndihmës juridike parësore, sipas parashikimeve të ligjit dhe a janë kryer pagesat përkatëse?	
A janë Klinikat e Ligjit një instrument efektiv për ofrimin e ndihmës juridike parësore?	
A janë trajnuar mjaftueshëm punonjësit që ofrojnë shërbim pranë qendrave të shërbimit të ndihmës juridike parësore ose në ambiente të tjera të përshtatshme?	

80. Nenet 13, 14 dhe 15 i ligjit Nr. 111/2017.

81. Neni 17 i ligjit Nr. 111/2017.

A ka pasur raste në të cilat nuk kanë përfituar ndihmë juridike parësore subjekte të cilat përfshihen te kategoritë e veçanta të përfituesve të ndihmës juridike ose te përfituesit e ndihmës juridike me të ardhura dhe pasuri të pamjaftueshme?	
A ka qenë i përjashtuar nga konflikti i interesit subjekti i cili ka ofruar shërbimin e ndihmës juridike parësore?	

<i><b>Treguesit e realizimit</b></i>	<i>Përqindje</i>
Sa janë të informuar qytetarët për mundësinë për të përfituar ndihmë juridike parësore falas?	
Sa janë të informuar qytetarët për kriteret për të përfituar ndihmë juridike parësore falas?	
Sa janë të informuar qytetarët për mënyrën e plotësimit të formularëve për të përfituar ndihmë juridike parësore falas?	
Sa janë të informuar qytetarët për procedurat për të përfituar ndihmë juridike dytësore falas?	
Sa janë të informuar qytetarët për vendndodhjen e subjekteve që ofrojnë ndihmë juridike parësore falas?	
Sa është niveli i kënaqësisë së përfituesve për cilësinë e shërbimit ligjor të përfituar nga çdonjëri nga subjektet e parashikuara në ligj për ofrimin e ndihmës juridike parësore falas?	
Cili është raporti ndërmjet ankesave të paraqitura kundër ofruesve të shërbimit dhe masave disiplinore të zbatuara?	
Sa është niveli i kënaqësisë i përfituesve për cilësinë e komunikimit të ofruesve të ndihmës juridike parësore falas?	
Sa është niveli i kënaqësisë i përfituesve për vendndodhjen e subjekteve të parashikuara në ligj për ofrimin e ndihmës juridike parësore falas?	
Cili është raporti i përfituesve të cilët do të riktheheshin ose jo për të përfituar sërish shërbime nga subjektet të cilat ofrojnë ndihmë juridike parësore falas?	
Cili është raporti i rasteve në të cilat nuk kanë përfituar ndihmë juridike parësore subjekte të cilat përfshihen te kategoritë e veçanta të përfituesve të ndihmës juridike ose te përfituesit e ndihmës juridike me të ardhura dhe pasuri të pamjaftueshme?	
Cili është raporti ndërmjet numrit total të përfituesve të ndihmës juridike parësore dhe përfituesve nga pakicat kombëtare?	

<i>Treguesit e realizimit</i>	<i>Shifra</i>
Sa është numri i ofruesve të ndihmës juridike parësore për 100 000 banorë?	

### ***Metoda e matjes***

- Analiza e raportit vjetor që paraqet MD në Kuvend për gjendjen e sistemit të ndihmës juridike.
- Analiza e buxhetit vjetor për ndihmën juridike.
- Analiza e raporteve tremujore mbi zbatimin e ligjit dhe mbi përdorimin e mjeteve financiare buxhetore të alokuara për ofrimin e ndihmës juridike që DNJF i paraqet MD.
- Analiza e raporteve vjetore për veprimtarinë e saj në lidhje me zbatimin e ligjit dhe të politikës shtetërore në fushën e ndihmës juridike që DNJF i paraqet MD.
- Monitorimi i bashkëpunimit të DNJF me organizata ndërkombëtare, me klinika ligjore dhe me OJF vendëse dhe të huaja në zhvillimin e sistemit të ndihmës juridike, nëpërmjet rritjes së ndërgjegjësimit dhe edukimit ligjor të publikut.
- Monitorimi fizik i ofrimit të shërbimeve në qendrat e shërbimit të ndihmës juridike parësore, në ambientet e gjykatave të rretheve gjyqësore ose në ambiente të tjera të përshtatshme, organizatat jofitimprurëse të autorizuara dhe Klinikat e Ligjit pranë institucioneve të arsimit të lartë.
- Monitorimi i bashkëpunimit të DNJF me Departamentin e Administratës Publike për miratimin e programeve të trajnimit fillestar dhe të vazhdueshëm për punonjësit me trajnim të posaçëm.
- Zhvillimi i sondazheve lokale dhe kombëtare.

### **Faktori 2.2 Ndhimja juridike për të aksesuar gjykatën**

#### ***Standardet e performancës***

Ndihmë juridike dytësore është:

- a. *shërbimi juridik* që ofrohet për përpilimin e akteve të nevojshme për të vënë në lëvizje gjykatën;
- b. *ofrimi i këshillimit*, i përfaqësimit dhe i mbrojtjes para gjykatës në çështjet administrative, civile dhe penale, për të cilat nuk zbatohet mbrojtja e detyrueshme, sipas përcaktimeve të legjislacionit procedural penal<sup>82</sup>.

Ndhimja juridike dytësore jepet nga avokatët që përfshihen në listën e miratuar nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë, në bazë të kërkesës së personit që gëzon të drejtën për përfitimin e ndihmës juridike dytësore.

Kategoritë e përfituesve dhe kriteret për përfitimin e ndihmës juridike dytësore janë të njëjta me ato për përfitimin e ndihmës juridike parësore, me përjashtim të rastit kur nëse

82. Neni 3.c i ligjit Nr. 111/2017.



një person, i cili jeton në një familje, kërkon ndihmë juridike dytësore për një çështje kundër një anëtari tjetër të së njëjtës familje, nuk do të zbatohet rregulli që të ardhurat e një personi, i cili jeton në një familje, konsiderohen të pamjaftueshme, nëse të ardhurat në total të të gjithë pjesëtarëve të familjes, të pjesëtuara për numrin e anëtarëve të familjes, janë më të ulëta se 50 për qind e pagës minimale mujore të përcaktuar sipas legjislacionit në fuqi. Në këtë rast, të ardhurat e këtij personi konsiderohen të pamjaftueshme, nëse janë më të ulëta se niveli i pagës minimale të përcaktuar sipas legjislacionit në fuqi.

Kërkesa hartohet sipas formularit të kërkesës, të miratuar nga MD. Kërkesa për dhënien e ndihmës juridike dytësore paraqitet nga personi i interesuar personalisht ose me anë të shërbimit postar pranë gjykatës ose organit procedues që fillon hetimet, përpara fillimit të një procesi gjyqësor, në fillim të një procesi gjyqësor dhe/ose në çdo fazë të procesit gjyqësor, derisa nuk është deklaruar i mbyllur hetimi gjyqësor, sipas rregullave të parashikuara në legjislacionin procedural. Personi që gëzon të drejtën për ndihmë juridike dytësore, mund ta paraqesë kërkesën e parashikuar nëpërmjet një përfaqësuesi ligjor apo të pajisur me prokurë, ose nëpërmjet bashkëshortit/es, bashkëjetuesit/es ose një të afërmi të shkallës së parë. Personi, i cili kërkon të përfitojë ndihmë juridike dytësore, nënshkruan një vetëdeklarim se përmbush kriteret e përfitimit, të përcaktuara në këtë ligj, sipas formularit të vetëdeklarimit të miratuar nga MD, të shoqëruar me dokumentacionin justifikues. Vendimi në lidhje me kërkesën për ndihmë juridike dytësore merret nga gjykata kompetente:

- a) brenda 5 ditëve nga data e regjistrimit të kërkesës, kur kërkesa paraqitet përpara fillimit të procesit gjyqësor;
- b) gjatë veprimeve paraprake ose në seancën përgatitore përpara se të caktohet seanca gjyqësore, kur kërkesa për ndihmë juridike është paraqitur bashkë me kërkesë-padinë;
- c) sipas parashikimeve të legjislacionit procedural dhe dispozitave të këtij ligji, kur kërkesa paraqitet gjatë shqyrtimit gjyqësor.

Kundër vendimit të gjykatës për rrëzimin e kërkesës për ndihmën juridike dytësore mund të bëhet ankimi i veçantë. Ankimi i vendimit nuk pengon vazhdimin e shqyrtimit të çështjes. Ankimi bëhet sipas formularit tip të miratuar nga MD, i cili i jepet kërkuarit së bashku me vendimin për rrëzimin e kërkesës. Gjykata e apelit shqyrton çështjen në dhomë këshillimi dhe merr vendim brenda 15 ditëve nga regjistrimi i çështjes. Kundër këtij vendimi nuk lejohet rekurs në GJL. DNJF mund të ankimojë vendimin e gjykatës për pranimin e kërkesës për ndihmë juridike dytësore, nëse pretendon se kjo kërkesë është dukshëm abuzive ose haptazi e pabazuar. Kundër vendimit të gjykatës së apelit nuk lejohet rekurs në GJL<sup>83</sup>.

Kërkesa për ndihmë juridike dytësore paraqitet në gjykatën kompetente për shqyrtimin e çështjes në themel, përveçse kur parashikohet ndryshe në këtë ligj. Kërkesa për ndihmë juridike dytësore e të pandehurit pa mjete të mjaftueshme financiare paraqitet pranë organit procedues që fillon hetimet<sup>84</sup>. Kërkuari mund ta kundërshtojë vendimin e organit procedues për rrëzimin e kërkesës për ndihmë juridike dytësore, me padi në gjykatën penale të shkallës

83. Neni 22 i ligjit Nr. 111/2017.

84. Nenet 18, 19 dhe 20 të ligjit Nr. 111/2017.

së parë, kompetente për shqyrtimin e çështjes në themel, brenda 5 ditëve nga marrja dijani për këtë vendim. Gjykata shqyrton çështjen me një gjyqtar, sipas rregullave të parashikuara në legjislacionin procedural, brenda 15 ditëve nga regjistrimi i çështjes. Kundër këtij vendimi lejohet ankimi i veçantë në gjykatën e apelit brenda 5 ditëve nga marrja dijani. Gjykata e apelit e shqyrton ankimin në dhomë këshillimi brenda 10 ditëve nga data e marrjes së akteve<sup>85</sup>.

<b><i>Treguesit e realizimit</i></b>	<i>Po/Jo</i>
A janë publikuar në një format të aksesueshëm formularët për të kërkuar përfitimin e ndihmës juridike dytësore?	
A është publikuar lista e avokatëve që ofrojnë shërbimet e ndihmës juridike dytësore?	
A është publikuar lista e avokatëve që ofrojnë shërbimet e ndihmës juridike dytësore në faqen zyrtare të Dhomës Kombëtare të Avokatisë?	
A janë caktuar avokatët që ofrojnë shërbime të ndihmës juridike dytësore duke zbatuar parimin e rotacionit?	
A janë trajnuar mjaftueshëm avokatët që ofrojnë shërbimet e ndihmës juridike dytësore?	
A janë respektuar nga prokuroria dhe gjykatat afatet për shqyrtimin e kërkesave për ndihmë juridike dytësore?	
A ka pasur raste kur qytetarët janë asistuar nga ofruesit e ndihmës juridike parësore për paraqitjen e kërkesave për ndihmë juridike dytësore dhe kërkesat nuk janë pranuar nga gjykata për shkak se dokumentacioni përkatës nuk ishte plotësuar në përputhje me ligjin?	
A ka qenë i përjashtuar nga konflikti i interesit subjekti i cili ka ofruar shërbimin e ndihmës juridike dytësore?	
A janë ankimuar nga DNJF vendimet e gjykatave për miratimin e kërkesës për ndihmë juridike dytësore dhe janë lënë në fuqi këto vendime nga gjykatat më të larta?	

<b><i>Treguesit e realizimit</i></b>	<i>Përqindje</i>
Sa janë të informuar qytetarët për mundësinë për të përfituar ndihmë juridike parësore dytësore?	
Sa janë të informuar qytetarët për kriteret për të përfituar ndihmë juridike dytësore falas?	
Sa janë të informuar qytetarët për mënyrën e plotësimit të formularëve për të përfituar ndihmë juridike dytësore falas?	

85. Neni 21 i ligjit Nr. 111/2017.

Sa janë të informuar qytetarët për procedurat për të përfituar ndihmë juridike dytësore falas?	
Sa është niveli i kënaqësisë së përfituesve për cilësinë e shërbimit të ndihmës juridike dytësore falas të përfituar nga avokatët?	
Cili është raporti ndërmjet ankesave të paraqitura kundër ofruesve të shërbimit dhe masave disiplinore të zbatuara?	
Sa është niveli i kënaqësisë i përfituesve për cilësinë e komunikimit të avokatëve gjatë ofrimit të shërbimit të ndihmës juridike dytësore falas?	
Cili është raporti i përfituesve të cilët do të riktheheshin ose jo për të përfituar sërish shërbime të ndihmës juridike dytësore falas nga avokatët?	
Cili është raporti i rasteve në të cilat kërkesat për ndihmë juridike dytësore janë rrëzuar nga gjykatat e shkallëve të para dhe vendimet janë ndryshuar nga gjykatat e apelit?	
Cili është raporti ndërmjet numrit total të përfituesve të ndihmës juridike dytësore dhe përfituesve nga pakicat kombëtare?	

<i><b>Treguesit e realizimit</b></i>	<i>Shifra</i>
Sa është numri i ofruesve të ndihmës juridike dytësore për 100 000 banorë?	

### **Metoda e matjes**

- Analiza e vendimeve të gjykatave të apelit për vendimet e gjykatave të shkallës së parë për rastet që kanë shqyrtuar kërkesat për ndihmë juridike dytësore falas.
- Monitorimi fizik i ofrimit të shërbimeve nga avokatët në sallat e gjykatave.
- Analiza e raportit vjetor që paraqet MD në Kuvend për gjendjen e sistemit të ndihmës juridike.
- Analiza e raporteve tremujore mbi zbatimin e ligjit dhe mbi përdorimin e mjeteve financiare buxhetore të alokuara për ofrimin e ndihmës juridike që DNJF i paraqet MD.
- Analiza e raporteve vjetore për veprimtarinë e saj në lidhje me zbatimin e ligjit dhe të politikës shtetërore në fushën e ndihmës juridike që DNJF i paraqet MD.
- Monitorimi i bashkëpunimit të DNJF me organizata ndërkombëtare, me klinika ligjore dhe me OJF vendëse dhe të huaja në zhvillimin e sistemit të ndihmës juridike, nëpërmjet rritjes së ndërgjegjësimit dhe edukimit ligjor të publikut.
- Analiza e buxhetit vjetor për ndihmën juridike.
- Zhvillimi i sondazheve lokale dhe kombëtare.

## Faktori 2.3 Përjashtimi nga pagesa e tarifave dhe shpenzimeve gjyqësore

### *Standardet e performancës*

Kategoritë e përfituesve dhe kriteret për përjashtimin nga pagesa e tarifave dhe shpenzimeve gjyqësore janë të njëjta me ato për përfitimin e ndihmës juridike dytësore. Personat, të cilët kanë të drejtën për të marrë ndihmë juridike dytësore, gëzojnë të drejtën për përjashtim nga:

- a) pagimi i tarifave të përgjithshme dhe të veçanta, sipas përcaktimeve të ligjit për tarifatat gjyqësore në Republikën e Shqipërisë;
- b) pagimi i shpenzimeve gjyqësore (shpenzimet për dëshmitarët, ekspertët, përkthyesit dhe për këqyrjen e sendeve ose këqyrjen në vend), sipas përcaktimeve të legjislacionit procedural;
- c) detyrimi për të parapaguar tarifën e vënies në ekzekutim të urdhrit të ekzekutimit pranë shërbimit përmbartimor gjyqësor shtetëror.

Përjashtimi nga pagimi i tarifave gjyqësore dhe i shpenzimeve gjyqësore jepet në bazë të një kërkesë që hartohet sipas formularit të kërkesës së miratuar nga MD. Kërkesa për përjashtim nga pagimi i tarifave gjyqësore dhe i shpenzimeve gjyqësore mund të paraqitet personalisht ose nëpërmjet shërbimit postar.

Kërkesa për përjashtim nga pagimi i tarifave gjyqësore dhe i shpenzimeve gjyqësore mund të paraqitet:

- a) së bashku me kërkesën për ndihmë juridike dytësore;
- b) bashkëlidhur kërkesëpadisë, në përputhje me parashikimet e legjislacionit procedural;
- c) në çdo fazë të procesit, derisa nuk është deklaruar i mbyllur hetimi gjyqësor.

Kërkesa për përjashtim nga pagimi i tarifave gjyqësore dhe i shpenzimeve gjyqësore paraqitet në gjykatën kompetente për shqyrtimin e çështjes në themel. Vendimi i pranimi të kërkesës për përjashtim nga pagimi i tarifave gjyqësore dhe i shpenzimeve gjyqësore i njoftohet menjëherë DNJF. Vendimi gjyqësor për përjashtimin nga pagimi i tarifave dhe i shpenzimeve gjyqësore përbën titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në përputhje me parashikimet e legjislacionit procedural<sup>86</sup>.

<b><i>Treguesit e realizimit</i></b>	<i>Po/Jo</i>
A janë publikuar në një format të aksesueshëm formularët për të kërkuar përjashtimin nga pagesa e tarifave dhe e shpenzimeve gjyqësore?	
A ka pasur raste kur qytetarët janë asistuar nga ofruesit e ndihmës juridike parësore për paraqitjen e kërkesave për përjashtimin nga pagesa e tarifave dhe e shpenzimeve gjyqësore dhe kërkesat nuk janë pranuar nga gjykata për shkak se dokumentacioni përkatës nuk ishte plotësuar në përputhje ligjin?	

86. Nenet 25, 26, 27 dhe 28 të ligjit Nr. 111/2017.

A është ekzekutuar vullnetarisht vendimi i gjykatës për përjashtimin nga pagesa e tarifave dhe e shpenzimeve gjyqësore?	
Në rast se jo, a është realizuar ekzekutimi i detyrueshëm nëpërmjet shërbimit përmbarrimor gjyqësor?	
A ka qenë i mjaftueshëm buxheti i alokuar për pagimin e tarifave gjyqësore dhe e shpenzimeve gjyqësore nga skema shtetërore e ndihmës juridike?	

<i><b>Treguesit e realizimit</b></i>	<i>Përqindje</i>
Sa janë të informuar qytetarët për mundësinë për të përfituar përjashtimin nga pagesa e tarifave dhe e shpenzimeve gjyqësore?	
Sa janë të informuar qytetarët për kriteret për të përfituar përjashtimin nga pagesa e tarifave dhe e shpenzimeve gjyqësore?	
Sa janë të informuar qytetarët për mënyrën e plotësimit të formularëve për të përfituar përjashtimin nga pagesa e tarifave dhe e shpenzimeve gjyqësore?	
Sa janë të informuar qytetarët për procedurat për të kërkuar përjashtimin nga pagesa e tarifave dhe e shpenzimeve gjyqësore?	
Cili është raporti i përfituesve të cilët do të riktheheshin ose jo për të përfituar sërish shërbime të ndihmës juridike dytësore falas nga avokatët?	
Cili është raporti i rasteve në të cilat kërkesat për përjashtimin nga pagesa e tarifave dhe e shpenzimeve gjyqësore janë rrëzuar nga gjykatat e shkallëve të para dhe vendimet janë ndryshuar nga gjykatat e apelit?	

### **Metoda e matjes**

- Analiza e vendimeve të gjykatave të apelit për vendimet e gjykatave të shkallës së parë për rastet që kanë shqyrtuar kërkesat për përjashtimin nga pagesa e tarifave dhe e shpenzimeve gjyqësore;
- Analiza e raporteve tremujore mbi zbatimin e ligjit dhe mbi përdorimin e mjeteve financiare buxhetore të alokuara për ofrimin e ndihmës juridike që DNJF i paraqet MD;
- Analiza e raporteve vjetore për veprimtarinë e saj në lidhje me zbatimin e ligjit dhe të politikës shtetërore në fushën e ndihmës juridike që DNJF i paraqet MD;
- Analiza e raportit vjetor që paraqet MD në Kuvend për gjendjen e sistemit të ndihmës juridike;
- Analiza e buxhetit vjetor për ndihmën juridike;
- Zhvillimi i sondazheve lokale dhe kombëtare.

## Faktori 2.4 Efektiviteti i praktikave të punës së organeve përgjegjëse për funksionimin e skemës shtetërore të ndihmës juridike

### *Standardet e performancës*

Institucionet përgjegjëse për administrimin dhe funksionimin e sistemit të ndihmës juridike janë:

i) MD, i cili zhvillon politikën shtetërore në fushën e ndihmës juridike. Përgjegjësitë kryesore të tij janë propozimi te Ministria e Financave i projektbuxhetit vjetor për ndihmën juridike, mbikëqyrja e mirëfunksionimit të sistemit të ndihmës juridike dhe zbatimin e buxhetit vjetor për ndihmën juridike. MD raporton çdo vit në Kuvend për gjendjen e sistemit të ndihmës juridike<sup>87</sup>.

ii) DNJF, e cila zbaton politikën shtetërore në fushën e ndihmës juridike; Përgjegjësitë kryesore të saj janë menaxhimi i fondeve buxhetore për dhënien e ndihmës juridike, mbledhja dhe analiza e informacionit mbi dhënien e ndihmës juridike për të përmirësuar funksionimin e sistemit të ofrimit të ndihmës juridike dhe organizimi i fushatave për rritjen e ndërgjegjësimit publik mbi ofrimin e ndihmës juridike dhe kushtet për përftimin e saj. DNJF i paraqet MD raporte tremujore mbi zbatimin e ligjit dhe mbi përdorimin e mjeteve financiare buxhetore të alokuara për ofrimin e ndihmës juridike<sup>88</sup>.

iii) Dhoma Kombëtare e Avokatisë, e cila miraton kriteret dhe procedurat për përzgjedhjen e avokatëve që ofrojnë shërbimet e ndihmës juridike dytësore, rregullat për zbatimin e parimit të rotacionit në caktimin e avokatëve që ofrojnë shërbime të ndihmës juridike dytësore, miraton listën e avokatëve që ofrojnë shërbimet e ndihmës juridike dytësore, përgatit dhe organizon programet e trajnimit të vazhdueshëm për avokatët e përfshirë në listën e avokatëve që ofrojnë shërbimet e ndihmës juridike dytësore, etj<sup>89</sup>.

<b><i>Treguesit e realizimit</i></b>	<b><i>Po/Jo</i></b>
A janë miratuar nga MD kriteret dhe metodologjia për vlerësimin e cilësisë së ofrimit të shërbimeve të ndihmës juridike dhe procedurat e mbikëqyrjes nga DNJF të shërbimeve të ndihmës juridike?	
A janë miratuar nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë dhe DNJF kriteret dhe procedurat për përzgjedhjen e avokatëve që ofrojnë shërbimet e ndihmës juridike dytësore?	
A janë miratuar nga MD formularët, kontratat dhe aktet e tjera të përcaktuara në ligj?	
A është miratuar nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë lista e avokatëve që ofrojnë shërbimet e ndihmës juridike dytësore brenda datës 1 shkurt të çdo viti kalendarik?	

87. Neni 8 i ligjit nr. 111/2017.

88. Neni 9 i ligjit nr. 111/2017.

89. Neni 10 i ligjit nr. 111/2017.

Nëse po, në hartimin e kësaj liste, a është mbajtur parasysh, përfshirja e avokatëve të të gjitha specialiteteve dhe niveleve dhe respektimin e barazisë gjinore?	
A janë lidhur deri më 1 mars të çdo viti kalendarik, kontratat e përvitshme të shërbimit me avokatët e përfshirë në listën e miratuar nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë për ofrimin e ndihmës juridike dytësore?	
A janë kryer pagesat, bazuar në tarifatat përkatëse të shpërblimit të avokatëve, të cilët ofrojnë shërbimet e ndihmës juridike dytësore?	
A është kryer autorizimi i OJF-ve për të ofruar ndihmë juridike në mënyrë periodike?	
A i kanë përmbushur kriteret e parashikuara në ligj OJF-të që autorizohen për dhënien e shërbimeve të ndihmës juridike parësore?	
A janë zbatuar procedurat dhe rregullat e përzgjedhjes së OJF-ve të autorizuar, që përfitojnë financime nga buxheti i shtetit nëpërmjet një procesi konkurrues dhe transparent përzgjedhjeje?	
A janë lidhur kontratat me OJF-të për shërbimet e ndihmës juridike parësore dhe a janë kryer pagesat përkatëse?	
A e ka publikuar MD dhe DNJF listën e avokatëve që ofrojnë shërbimet e ndihmës juridike dytësore dhe listën e OJF-ve të autorizuar që ofrojnë shërbime të ndihmës juridike parësore në faqen e saj zyrtare?	
A janë përgatitur dhe organizuar programet e trajnimit të vazhdueshëm për avokatët e përfshirë në listën e avokatëve që ofrojnë shërbimet e ndihmës juridike dytësore?	
A është kryer në mënyrë periodike nga DNJF vlerësimi i cilësisë së dhënies së ndihmës juridike?	
Nëse po, a ka zbatuar DNJF një sistem për të kryer vlerësimin e cilësisë së dhënies së ndihmës juridike?	
A janë realizuar nga DNJF fushata për rritjen e ndërgjegjësimit publik për kushtet për përftimin e ndihmës juridike?	
A janë ndërmarrë nisma nga DNJF për të bashkëpunuar me organizata ndërkombëtare, me klinika ligjore dhe me OJF vendëse dhe të huaja për zhvillimin e sistemit të ndihmës juridike?	
A ka rezultuar i mjaftueshëm planifikimi i kostove dhe i shpenzimeve të lidhura me dhënien e ndihmës juridike nga DNJF?	
A janë menaxhuar fondet buxhetore për dhënien e ndihmës juridike nga DNJF në përputhje me ligjin?	

<b><i>Treguesit e realizimit</i></b>	<b><i>Përqindja</i></b>
Sa të efektshme kanë qenë fushatat e organizuara nga DNJF për rritjen e ndërgjegjësimit publik mbi ofrimin e ndihmës juridike dhe kushtet për përftimin?	
Sa është niveli i kënaqësisë i qendrave të shërbimit të ndihmës juridike parësore për administrimin e tyre nga DNJF?	
Sa është niveli i kënaqësisë i OJF dhe Klinikave të Ligjit për bashkëpunimin nga ana e DNJF?	
Sa është niveli i kënaqësisë i OJF për transparencën dhe bazueshmërinë në ligj të procedurës për dhënien e autorizimit për ofrimin e shërbimeve të ndihmës juridike parësore?	
Sa është niveli i kënaqësisë i OJF për transparencën dhe bazueshmërinë në ligj të procedurës për financimin nga buxheti i shtetit për ofrimin e shërbimeve të ndihmës juridike parësore?	
Sa është niveli i kënaqësisë së OJF-ve lidhur me disbursimin e pagesave brenda afateve?	
Sa është niveli i kënaqësisë së avokatëve lidhur me disbursimin e pagesave brenda afateve?	
Sa është niveli i kënaqësisë i avokatëve për cilësinë e programeve të trajnimit të vazhdueshëm të përgatitura dhe të organizuara nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë në bashkëpunim me DNJF?	

### ***Metoda e matjes***

- Analiza e raportit vjetor që paraqet MD në Kuvend për gjendjen e sistemit të ndihmës juridike;
- Analiza e raporteve tremujore mbi zbatimin e ligjit dhe mbi përdorimin e mjeteve financiare buxhetore të alokuara për ofrimin e ndihmës juridike që DNJF i paraqet MD;
- Analiza e raporteve vjetore për veprimtarinë e saj në lidhje me zbatimin e ligjit dhe të politikës shtetërore në fushën e ndihmës juridike që DNJF i paraqet MD;
- Monitorimi i bashkëpunimit të DNJF me organizata ndërkombëtare, me klinika ligjore dhe me OJF vendëse dhe të huaja në zhvillimin e sistemit të ndihmës juridike, nëpërmjet rritjes së ndërgjegjësimit dhe edukimit ligjor të publikut;
- Analiza e buxhetit vjetor për ndihmën juridike;
- Monitorimi i publikimeve në faqet zyrtare në internet të MD, DNJF dhe DHA.
- Analiza e raporteve të Këshillit të Lartë të Shtetit mbi menaxhimin e fondeve buxhetore për dhënien e ndihmës juridike nga DNJF;
- Paraqitja e kërkesave për informacion drejtuar MD dhe DNJF.
- Zhvillimi i intervistave të thelluara me juristët të cilët ofrojnë ndihmë juridike parësore dhe avokatët të cilët ofrojnë ndihmë juridike dytësore.
- Zhvillimi i intervistave *focus groups* me juristët të cilët ofrojnë ndihmë juridike parësore dhe avokatët të cilët ofrojnë ndihmë juridike dytësore.
- Zhvillimi i sondazheve lokale dhe kombëtare.



## Pjesa 3

# MONITORIMI I GJENDJES SË AKSESIT FIZIK NË GJYKATA

### **Faktori 3.1 Efektiviteti i hartës gjyqësore në kuadër të aksesit të qytetarëve në proceset gjyqësore dhe shërbimet administrative**

#### *Standardet e performancës*

Një ndër qëllimet kryesore të Reformës në Drejtësi ishte garantimi i aksesit në drejtësi të qytetarëve, reduktimi i kostove, si dhe rritja e cilësisë dhe e performancës në dhënien e drejtësisë, si një shërbim publik i barabartë për të gjithë qytetarët.

Në kushtet në të cilat ndodhet aktualisht sistemi ynë i drejtësisë, si pasojë e vakancave të shumta të krijuara si rrjedhojë e procesit të vetingut të magistratëve, burimeve gjithmonë e më të pakta për plotësimin e këtyre vakancave nga ana e SHM, si dhe rritjes së backlog-ut të çështjeve gjyqësore në gjykata, gjë e cila cenon aksesin në drejtësi të qytetarëve, harta e re gjyqësore do të duhet të realizojë një ekuilibër të drejtë ndërmjet faktorëve të mëposhtëm:

- garantimit të aksesit në drejtësi, që lidhet me afërsinë e individit me gjykatën;
- uljen e kostove, me qëllim përdorimin me efektshmëri të burimeve publike;
- rritjen e cilësisë dhe përshtatshmërisë së shërbimeve të ofruara.

Përpara miratimit të hartës së re gjyqësore, sistemi gjyqësor në Shqipëri përbëhej nga 29 gjykata të shkallës së parë, ku 22 ishin gjykata rrethi me juridiksion të përgjithshëm, 6 gjykata administrative dhe 1 gjykatë e posaçme, 8 gjykata apeli, ku 6 ishin gjykata apeli me juridiksion të përgjithshëm, 1 gjykatë administrative dhe 1 gjykatë e posaçme dhe 1 GJL.

Nëpërmjet Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 495, datë 21.7.2022 “Për riorganizimin e rretheve gjyqësore dhe kompetencave tokësore të gjykatave” është vendosur: riorganizimi i gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm, nga njëzet e dy gjykata të rretheve gjyqësore në trembëdhjetë gjykata të tilla dhe riorganizimi i gjykatave administrative të shkallës së parë, nga gjashtë gjykata administrative në dy gjykata të tilla.

Sipas propozimit të KLGj-së, rezultatet e pritshme të reduktimit të numrit të gjykatave të shkallës së parë janë:

- Shërbime të përmirësuara për qytetarët, duke përqendruar shërbimet në gjykatat më të mëdha;
- Reduktimi i vonesave në procedurat gjyqësore dhe kohët e gjykimit.
- Zvogëlimi i ndjeshëm i delegimeve, që nënkupton një shpërndarje më të mirë të kohës gjyqësore, duke rritur kështu cilësinë dhe sasinë e vendimmarrjes;

Gjithashtu, vendimi i mësipërm i Këshillit të Ministrave ka vendosur riorganizimin e gjykatave të apelit të juridiksionit të përgjithshëm, nga gjashtë gjykata apeli, në një Gjykatë Apeli të Juridiksionit të Përgjithshëm, që organizohet dhe funksionon në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, me seli në qytetin Tiranë.

Sipas propozimit të KLGj-së, rezultatet e pritshme të reduktimit të numrit të gjykatave të apelit janë:

- Zvogëlimi i afatit kohor për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve të regjistruara në gjykatat e shkallës së dytë.
- Uniformizimi i praktikës gjyqësore të gjykatës së apelit dhe i praktikës gjyqësore të gjykatave të shkallës së parë.
- Ulje graduale e numrit të çështjeve të prapambetura, nëpërmjet krijimit të shumë seksioneve me gjyqtarë të specializuar dhe rritjes të efikasitetit në ushtrimin e veprimtarisë gjyqësore.
- Lehtësira në menaxhimin nga KLGj të nevojave për gjyqtarë në gjykatat e apelit.

<i><b>Treguesit e realizimit</b></i>	<i><b>Përqindje</b></i>
Cila është përqindja e qytetarëve që deklarojnë se kanë akses në sistemin gjyqësor për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve?	
Cila është përqindja e qytetarëve që deklarojnë se kanë qasje në sistemin gjyqësor për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, të ndara sipas gjinisë, përkatësisë në pakicat kombëtare dhe ndarjes administrative?	
Cili është perceptimi i qytetarëve lidhur me distancën e gjykatave dhe mundësitë e tyre për t'i aksesuar ato?	
A janë gjykuar brenda një afati më të shkurtër/gjatë mosmarrëveshjet mbas riorganizimit të gjykatave të shkallëve të para?	
A është ulur/rritur numri i qytetarëve që kanë adresuar mosmarrëveshjet në gjykatë për shkak të rritjes së distancës ndërmjet vendbanimit/vendqëndrimit të tyre dhe gjykatës mbas zbatimit të hartës së re gjyqësore?	
A janë rritur/ulur kostot e qytetarëve për të zhvilluar një proces gjyqësor mbas zbatimit të hartës së re gjyqësore?	
Sa është niveli i kënaqësisë së qytetarëve me shërbimet administrative të ofruara nga gjykatat mbas zbatimit të hartës së re gjyqësore?	
A është ulur/rritur numri i qytetarëve që kanë paraqitur ankim pranë Gjykatës së Apelit për shkak të rritjes së distancës ndërmjet vendbanimit/vendqëndrimit të tyre dhe gjykatës mbas zbatimit të hartës së re gjyqësore?	
A është ulur/rritur numri i qytetarëve që kanë marrë pjesë në seancën gjyqësore për shqyrtimin e ankimit pranë Gjykatës së Apelit për shkak të rritjes së distancës ndërmjet vendbanimit/vendqëndrimit të tyre dhe gjykatës mbas zbatimit të hartës së re gjyqësore?	

A janë rritur/ulur kostot e qytetarëve për të ndjekur shqyrtimin e ankimit pranë Gjykatës së Apelit mbas zbatimit të hartës së re gjyqësore?	
Në rast se po, sa përqind janë rritur kostot e qytetarëve për të ndjekur shqyrtimin e ankimit pranë Gjykatës së Apelit?	
Sa është niveli i kënaqësisë së qytetarëve me shërbimet administrative të ofruara nga gjykatat mbas zbatimit të hartës së re gjyqësore?	
Sa është niveli i kënaqësisë së qytetarëve me vendimmarrjen e Gjykatës së Apelit mbas zbatimit të hartës së re gjyqësore?	
Sa është niveli i vendimeve të Gjykatës së Apelit të lëna në fuqi, të ndryshuara dhe të prishura nga GjL mbas zbatimit të hartës së re gjyqësore?	
Sa është niveli i kënaqësisë së juristëve dhe të avokatëve lidhur me përmirësimin e uniformizimit të praktikës gjyqësore të gjykatës së apelit dhe praktikës gjyqësore të gjykatave të shkallës së parë mbas zbatimit të hartës së re gjyqësore?	
Cili është raporti i seancave të zhvilluara në salla dhe zyra?	
Cili është raporti i seancave të regjistruara në sistem audio dhe të regjistruara në mënyrë manuale?	
Në cilën masë janë plotësuar nga KLP dhe KLGj rekomandimet e përcjella në rezolutën e miratuar nga Kuvendi për raportet e tyre vjetore?	
Në cilën masë janë plotësuar nga KLGj rekomandimet për përmirësimin e efikasitetit të gjykatave ose për zvogëlimin e ngarkesës së punës së gjyqtarëve dhe personelit të gjykatës?	

<b><i>Treguesit e realizimit</i></b>	<i>Po/Jo</i>
A janë dhomat e pritjes të palëve dhe të avokatëve me kushte të pranueshme dhe të një standardi të arsyeshëm?	
A janë dhomat e pritjes të organizuara në mënyrë që palët e kundërta të mos presin së bashku?	
A ka dhoma pritje në gjykatë ku avokatët mund të takohen dhe të bisedojnë në privatësi me klientët e tyre?	
A është gjykata e pajisur me një hapësirë parkimi për palët dhe avokatët?	

<b><i>Treguesit e realizimit</i></b>	<i>Shifra</i>
Sa është numri i gjykatave për 100 000 banorë?	

## ***Metoda e matjes***

- Analiza e raportit vjetor të KLGj-së mbi gjendjen e sistemit gjyqësor dhe veprimtarinë e KLGj-së.
- Analiza e raportit vjetor të KLGj-së për ngarkesën e çështjeve gjyqësore dhe të punës së gjykatave për vitin kalendarik të mëparshëm.
- Analiza e raporteve vjetore të gjykatave.
- Analiza e vjetarit statistikor të MD.
- Paraqitja e kërkesave për informacion.
- Monitorimi në ambientet e gjykatave.
- Zhvillimi i sondazheve lokale dhe kombëtare.

## **Faktori 3.2 Zbatimi i procedurave elektronike në gjykimin e mosmarrëveshjeve**

### ***Standardet e performancës***

Në gjykimin e mosmarrëveshjeve civile dhe administrative K.Pr.C. parashikon zbatimin e procedurave elektronike në disa raste gjatë zhvillimit shqyrtimit gjyqësor.

Gjykata, kur e çmon të dobishme dhe kur pala ose personi i tretë ka dhënë pëlqimin paraprak, urdhëron që thirrja në gjykatë të bëhet nëpërmjet njoftimit me mjete të komunikimit elektronik<sup>90</sup>. Të dhënat elektronike të kontaktit të palës paditëse ose të përfaqësuesit, nëse ka një të tillë, mund të regjistrohen me paraqitjen e kërkesëpadisë,<sup>91</sup> ndërkohë që të dhënat elektronike të kontaktit të palës së paditur mund të regjistrohen nëpërmjet paraqitjes së deklaratës së mbrojtjes;<sup>92</sup> Palët ose personat e tretë, për çdo ndryshim të mëvonshëm të adresës dhe të të dhënave elektronike të kontaktit të tyre ose të përfaqësuesit të tyre, detyrohen të njoftojnë gjykatën. Shkelja e këtij detyrimi e bën të papranueshëm pretendimin për pavlefshmëri njoftimi<sup>93</sup>. Në rastin e njoftimit me shpallje (shih për më gjerë “Faktorin 1.1 - Gjykimi i drejtë”), njoftimi botohet edhe në një rubrikë të posaçme në faqen zyrtare në internet të gjykatës, dhe/ose në një portal elektronik kombëtar të krijuar për këtë qëllim<sup>94</sup>.

Njoftimi elektronik i akteve bëhet me mjete të komunikimeve elektronike, nëpërmjet dërgimit nga punonjësi i gjykatës të letërthirrjes ose akteve të tjera që duhet t'i njoftohen personit të caktuar si marrës, në të dhënat e tij të kontaktit. Ky njoftim duhet të pasqyrohet në një procesverbal të posaçëm, në të cilin duhet të tregohen të dhënat e kontaktit dhe mjete të komunikimeve elektronike të përdorura për njoftim, data dhe ora e saktë e komunikimit, personi me të cilin komunikon dhe qëllimi i njoftimit. Procesverbali hartohet nga sekretari gjyqësor dhe nënshkruhet prej tij dhe punonjësit të gjykatës të ngarkuar për kryerjen e njoftimeve. Ky procesverbal bëhet pjesë e dosjes gjyqësore.<sup>95</sup>

Regjistrimi i të dhënave elektronike të kontaktit të palëve është i rëndësishëm edhe në kuadër të

90. Neni 129 paragrafi 2 i K.Pr.C.

91. Neni 154 paragrafi 2.a. i K.Pr.C.

92. Neni 158 paragrafi 42.a. i K.Pr.C.

93. Neni 129 paragrafi 2 i K.Pr.C.

94. Neni 133/b.3 paragrafi 3 i K.Pr.C.

95. Neni 141 i K.Pr.C.

shqyrtimit të mosmarrëveshjeve në apel. Njoftimi për ditën dhe orën e gjykimit, si dhe përbërjen e trupit gjykues që shqyrton çështjen, bëhet nga gjykata e apelit me shpallje në ambientet e saj dhe në gjykatën përkatëse të shkallës së parë. Ky njoftim bëhet gjithashtu në faqen e internetit të gjykatës së apelit, si dhe, nëse ka, edhe në faqen e internetit të gjykatës përkatëse të shkallës së parë dhe me njoftim individual në rastin kur palët ose përfaqësuesit e tyre kanë lënë të dhënat elektronike të kontaktit në shkallën e parë të gjykimit. Shpallja ose njoftimi bëhet të paktën 15 ditë para datës së gjykimit<sup>96</sup>. Të njëjtat rregulla zbatohen edhe për shqyrtimin e rekursit në GjL ku sekretaria e GjL-së shpall listat e shqyrtimit të rekurseve të paktën 15 ditë përpara datës së shqyrtimit dhe njoftimi për ditën, orën, si dhe përbërjen e trupit gjykues që shqyrton rekursin bëhet me shpallje në ambientet e GjL-së, si dhe në faqen e saj të internetit dhe me njoftim individual kur palët ose përfaqësuesit e tyre kanë lënë të dhënat e tyre elektronike të kontaktit në shkallët e tjera të gjykimit<sup>97</sup>.

K.Pr.C. parashikon mundësinë e shqyrtimit të disa prej mosmarrëveshjeve nëpërmjet përdorimit të teknologjisë së informacionit. Në lidhje me paditë me vlerë deri në njëzetfishin e pagës minimale në shkallë vendi, gjykata vendos që palët të sjellin shpjegimet me shkrim ose nëpërmjet videokonferencës. Me kërkesë të arsyetuar të palëve, si dhe kur gjykata e çmon të arsyeshme, ato mund të pyeten nëpërmjet mënyrave dhe mjeteve të tjera të komunikimit në distancë. Aspektet vizuale dhe zanore të seancës të videokonferencës transmetohen në kohë reale të vendndodhjes me sallën ku zhvillohet procesi gjyqësor. Aspektet vizuale dhe zanore të transmetuara nuk regjistrohen. Vendimet e mësipërme janë të paankimueshme.<sup>98</sup> Në shqyrtimin e padive me vlerë deri në njëzetfishin e pagës minimale në shkallë vendi, gjykata mund të vendosë që dëshmitë e dëshmitarëve të merren me anë të deklaratave me shkrim ose videokonferencës, të siguruara jashtë ambienteve të gjykatës. Në deklaratën me shkrim të dëshmitarit duhet të shënohet paralajmërimi i përgjegjësisë ligjore për deklaram të rremë. Vërtetimi i nënshkrimit vërtetohet nga noteri ose sekretaria e gjykatës<sup>99</sup>.

Në rastin e shqyrtimit të akuzave penale, K.Pr.P. ka parashikuar gjithashtu procedura për njoftimin e të pandehurit nëpërmjet të dhënave elektronike të kontaktit. Në rast se njoftimi i të pandehurit person juridik në selinë e tij, nuk është i mundur, ai kryhet nëpërmjet afishimit të njoftimit në adresën e deklaruar të selisë, këndin e afishimit të gjykatës dhe në faqen elektronike të saj, si dhe nëpërmjet afishimit në faqen elektronike të Qendrës Kombëtare të Bizneseve në rastet e personave juridikë të regjistruar në regjistrin tregtar.<sup>100</sup> Në rastin e shqyrtimit të rekursit, sekretaria e GjL-së njofton palët nëpërmjet afishimit në këndin e njoftimeve dhe faqen elektronike zyrtare për datën dhe orën e gjykimit të paktën 30 ditë përpara. Kur palët kanë adresa elektronike të deklaruara apo të njohura, sekretaria kryen njoftimin edhe në këto adresa<sup>101</sup>.

Lidhur me zhvillimin e seancës gjyqësore dhe pjesëmarrjen e të pandehurit, në rast se ky i fundit me sjelljen e tij pengon zhvillimin e rregullt të seancës, pavarësisht se gjykata ka vendosur t'i caktojë gjobë deri në shumën 30 000 lekë, gjykata mund të urdhërojë largimin e tij nga salla për një kohë të caktuar. Kur i pandehuri vijon të pengojë zhvillimin normal të gjykimit edhe pas

96. Neni 460.5 i K.Pr.C.

97. Neni 482.3 i K.Pr.C.

98. Neni 285/a i K.Pr.C.

99. Neni 236/a i K.Pr.C.

100. Neni 436 i K.Pr.P.

101. Neni 436 i K.Pr.P.

kthimit, gjykata mund të urdhërojë largimin e tij deri në shpalljen e vendimit. Kur është e mundur, i pandehuri i larguar nga salla e ndjek seancën nëpërmjet lidhjes audio dhe/ose video<sup>102</sup>.

<b><i>Treguesit e realizimit</i></b>	<b><i>Po/Jo</i></b>
A është kryer nga gjykata e shkallës së parë njoftimi i palës e cila ka regjistruar të dhënat e saj elektronike të kontaktit me mjete të komunikimit elektronik për ditën dhe orën e gjykimit, si dhe përbërjen e trupit gjykues që shqyrton çështjen?	
A është kryer njoftimi në adresën e re të deklaruar nga palët në rast se palët kanë ndryshuar dhënat elektronike të kontaktit të tyre?	
A është kryer njoftimi me shpallje në faqen zyrtare në internet të gjykatës, dhe/ose në një portal elektronik kombëtar të krijuar për këtë qëllim?	
A është pasqyruar njoftimi me mjete të komunikimit elektronik në një procesverbal të posaçëm?	
A është kryer nga Gjykata e Apelit njoftimi me mjete të komunikimit elektronik për ditën dhe orën e gjykimit, si dhe përbërjen e trupit gjykues që shqyrton çështjen e palës e cila ka lënë të dhënat e saj elektronike të kontaktit në shkallën e parë të gjykimit?	
A është kryer nga GjL njoftimi me mjete të komunikimit elektronik për ditën dhe orën e gjykimit, si dhe përbërjen e trupit gjykues që shqyrton çështjen e palës e cila ka lënë të dhënat e saj elektronike të kontaktit në shkallët e tjera të gjykimit?	
A u respektua e drejta e mbrojtjes, barazia e armëve dhe kontradiktoriteti në shqyrtimin e mosmarrëveshjeve nëpërmjet përdorimit të teknologjisë së informacionit?	
A ishte e mundur për palët të komunikojnë me gjykatën për paraqitjen e shpjegimeve/prapësimeve në mënyrë elektronike?	
A u respektuan detyrimet që burojnë nga legjislacioni për mbrojtjen e të dhënave personale në shqyrtimin e mosmarrëveshjeve nëpërmjet përdorimit të teknologjisë së informacionit?	

<b><i>Treguesit e realizimit</i></b>	<b><i>Përqindje</i></b>
Sa është niveli i kënaqësisë së palëve pjesëmarrëse në shqyrtimin e mosmarrëveshjeve nëpërmjet përdorimit të teknologjisë së informacionit?	
Sa ishin më të ulëta/larta shpenzimet gjyqësore të palëve për të marrë pjesë në shqyrtimin e mosmarrëveshjeve nëpërmjet përdorimit të teknologjisë së informacionit?	

102. Neni 436 i K.Pr.P.

## ***Metoda e matjes***

- Analiza e vendimeve të gjykatave më të larta për vendimet e gjykatave më të ulëta për rastet kur është konstatuar shkelja e të drejtës së mbrojtjes.
- Analiza e jurisprudencës të GjK-së për vendimet e ankimeve të paraqitura bazuar në nenin 131/f të Kushtetutës, në kuadër të respektimit të të drejtës së mbrojtjes dhe barazisë së armëve.
- Statistikat vjetore për veprimtarinë e GjK-së.
- Këqyrja e faqes zyrtare në internet të gjykatës, dhe/ose portalit elektronik kombëtar për të verifikuar nëse është publikuar njoftimi me shpallje.
- Zhvillimi i sondazheve publike dhe lokale.

## **Faktori 3.3 Aksesi në gjykatë i personave me aftësi të kufizuara**

### ***Standardet e performancës***

Aksesi në drejtësi është një nga elementet thelbësore të një shoqërie demokratike, i cili ka për qëllim promovimin, respektimin dhe zbatimin praktik të të drejtave të anëtarëve të shoqërisë, pa përjashtime dhe pa diskriminime. Instrumenti i parë ndërkombëtar që garanton aksesin në drejtësi të të gjithë anëtarëve të një shoqërie, duke vënë theksion te heqja e barrierave kufizuese dhe penguese për aksesin në drejtësi të personave me aftësi të kufizuara, është Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (KDPAK). Në funksion të këtij të fundit është ngritur edhe Komiteti mbi të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, i cili vë theksin te të drejtat dhe mbrojtja që personat me aftësi të kufizuara gëzojnë në të gjitha llojet e proceseve, administrative apo gjyqësore dhe përgjatë gjithë fazave procedurale.

Legjislacioni ka parashikuar disa masa për garantimin e aksesit në drejtësi për personat me aftësi të kufizuara. Koncretisht:

- Ligji për ndihmën juridike të garantuar nga shteti, ka parashikuar si përfitues të ndihmës juridike parësore, dytësore dhe përjashtimit nga pagesa e tarifave dhe e shpenzimeve gjyqësore, personat të cilët i nënshtrohen trajtimit të pavullnetshëm në institucionet e shërbimit të shëndetit mendor, personat të cilët i nënshtrohen trajtimit vullnetar në institucionet e shërbimit të shëndetit mendor për sëmundjet e rënda mendore, personat, ndaj të cilëve kërkohet heqja ose kufizimi i zotësisë për të vepruar ose u është hequr ose kufizuar zotësia për të vepruar.  
MD duhet të marrë masat e nevojshme për publikimin e formularëve të ndihmës juridike në format të aksesueshëm nga personat me aftësi të kufizuara.
- K.Pr.P. parashikon që personi nën hetim ose i pandehuri ka të drejtë të përdorë gjuhën e shenjave, si dhe të ndihmohet nga një interpretues nëse ka aftësi të kufizuara në të folur dhe në të dëgjuar. Në rastin e të pandehurit që nuk dëgjon dhe nuk flet ose është me aftësi të kufizuara, që e pengojnë për të realizuar vetë të drejtën e mbrojtjes, organi procedues duhet t'i sigurojë menjëherë një mbrojtës të paguar nga shteti në rast se

nuk ka zgjedhur mbrojtës ose ka mbetur pa të. Në rastin e pyetjes së dëshmitarëve, nuk mund të pyeten si të tillë personat që, për shkak të aftësive të kufizuara fizike ose psikike, nuk janë në gjendje të bëjnë dëshmi të rregullt.

- K.Pr.C., parashikon që kur merret në pyetje një person që nuk flet ose nuk dëgjon, në qoftë se pyetja e tyre nuk mund të bëhet me shkrim, gjykata thërret një person që i kupton shenjat e personit që merret në pyetje.

<b><i>Treguesit e realizimit</i></b>	<i>Po/Jo</i>
A kanë hartuar rregullore të brendshme institucionet e drejtësisë, me qëllim garantimin e aksesit të plotë dhe efektiv për personat me aftësi të kufizuara?	
A janë vendosur pajisje/mekanizma të cilat bëjnë të mundur aksesin e plotë dhe efektiv për personat me aftësi të kufizuara të ambienteve të gjykatës?	
A është trajnuar administrata gjyqësore për ofrimin e shërbimeve për personat me aftësi të kufizuara?	
A janë caktuar persona të cilët bëjnë të mundur shoqërimin e personave me aftësi të kufizuara në ambientet e gjykatës?	
A është e pajisur gjykata me hapësirë parkimi me vende të rezervuara për personat me aftësi të kufizuara?	
A janë vendosur pajisje/mekanizma të cilat bëjnë të mundur aksesin e plotë dhe efektiv për personat me aftësi të kufizuara të ambienteve të ofruesve të shërbimit të ndihmës juridike?	
A janë publikuar formularët e ndihmës juridike në format të aksesueshëm për personat me aftësi të kufizuara?	
A rezulton që gjykatat të komunikojnë me mjete të përshtatshme për dhënien e informacionit për personat me aftësi të kufizuara?	
Në rastin e personit nën hetim ose të pandehurit, a i është siguruar nga organi procedues e drejta të përdorë gjuhën e shenjave, si dhe të ndihmohet nga një interpretues nëse ka paaftësi të kufizuar në të folur dhe në të dëgjuar?	
Në rastin e të pandehurit që nuk dëgjon dhe nuk flet ose është me aftësi të kufizuara që e pengojnë për të realizuar vetë të drejtën e mbrojtjes, a i është siguruar mbrojtja e detyrueshme nga organi procedues duke i siguruar menjëherë një mbrojtës të paguar nga shteti?	
A është zbatuar nga organi procedues ndalimi i pyetjes në cilësinë e dëshmitarëve të personave që nuk janë në gjendje të bëjnë dëshmi të rregullt, për shkak të aftësive të kufizuara fizike ose psikike?	



Kur është marrë në pyetje një person që nuk flet ose nuk dëgjon në një proces civil ose administrativ dhe pyetja e tyre nuk mund të bëhet me shkrim, a ka thirrur gjykata një person që i kupton shenjat e personit që merret në pyetje?	
Në rastin kur paditësi/i padituri nuk fliste ose ishte me aftësi të kufizuara, që e pengonin për të realizuar vetë të drejtën e mbrojtjes, a ka mundur t'i realizojë plotësisht të drejtat procedurale?	
A ka pasur raste në të cilat nuk kanë përfituar ndihmë juridike subjekte të cilat përfshihen te kategoritë e veçanta të përfituesve të ndihmës juridike për shkak të aftësive të kufizuara mendore ose psikike?	

<i><b>Treguesit e realizimit</b></i>	<i>Përqindje</i>
A kanë informacion personat me aftësi të kufizuara mbi të drejtat e tyre dhe si t'i kërkojnë këto të drejta?	
A janë të efektshme rregulloret e brendshme të hartuara nga institucionet e drejtësisë me qëllim garantimin e aksesit të plotë dhe efektiv për personat me aftësi të kufizuara?	
A janë të efektshme pajisjet/mekanizmat e vendosura nga institucionet e drejtësisë me qëllim aksesin e ambienteve të tyre nga personat me aftësi të kufizuara?	
Sa është niveli i kënaqësisë së përfituesve për cilësinë e shërbimit ligjor të përfituar nga çdonjëri nga subjektet e parashikuara në ligj për ofrimin e ndihmës juridike parësore dhe dytësore?	
Cili është raporti i rasteve në të cilat kërkesat për ndihmë juridike dytësore dhe përjashtimin nga pagesa e tarifave dhe e shpenzimeve gjyqësore për shkak të aftësive të kufizuara mendore ose psikike të kërkuarit, janë rrëzuar nga gjykatat e shkallëve të para dhe vendimet janë ndryshuar nga Gjykata e Apelit?	

### **Metoda e matjes**

- Paraqitja e kërkesave për informacion.
- Zhvillimi i sondazheve kombëtare dhe lokale.
- Analiza e vendimeve të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.
- Analiza e vendimeve të gjykatave më të larta për vendimet e gjykatave **më të ulëta për** rastet kur është konstatuar shkelja e dispozitave ligjore për procedimin dhe gjykimin penal të personave nën hetim ose të pandehurve me aftësi të kufizuara mendore ose psikike.
- Këqyrja e faqeve zyrtare në internet të DNjF-së dhe MD-së.

## Faktori 3.4 Akuza private në procesin penal

### *Standardet e performancës*

Sistemet e drejtësisë penale duhet të japin shërbimet, informacionet dhe të drejtat e nevojshme për viktimat gjatë procedimit penal<sup>103</sup>. Në KEDNj nuk janë parashikuar në mënyrë direkte të drejtat e të dëmtuarve nga veprat penale, por GjEDNj në jurisprudencën e saj i ka gjetur shtetet në shkelje për shkak të mosrespektimit të të drejtave të të dëmtuarve<sup>104</sup>.

Dispozitat e K.Pr.P. rregullojnë të drejtat procedurale të viktimave, duke parashikuar që këto të fundit mund të dërgojnë vetë çështjen në gjykatë për veprat penale: “Ai që është dëmtuar nga veprat penale të parashikuara nga nenet 90, 91, 92, 112 paragrafi i parë, 119, 119/b, 120, 121, 122, 125, 127, dhe 254 të Kodit Penal ka të drejtë të paraqesë kërkesë në gjykatë dhe të marrë pjesë në gjykim si palë për të vërtetuar akuzën dhe për të kërkuar shpërblyerjen e dëmit”. Prokurori merr pjesë në gjykimin e këtyre çështjeve dhe, sipas rastit, kërkon dënimin e të pandehurit ose pafajësinë e tij<sup>105</sup>.

Procesi i gjyimit me viktimën akuzuese është një proces *sui generis*, pasi bën përjashtim nga rregulli i përgjithshëm ku ndjekja penale dhe akuza përfaqësohen nga prokurori, ndërsa në këtë lloj gjykimi akuza përfaqësohet nga vetë pala që është dëmtuar nga vepra penale. Thelbi i akuzës private është vënia para përgjegjësisë së autorit të një vepre penale nga e cila të dëmtuarit, sipas vlerësimit të tij subjektiv, i kanë ardhur pasoja negative. Kusht i domosdoshëm për të ngritur këtë akuzë është që i dëmtuari të jetë viktimë e njëres prej veprave penale të parashikuara në ligjin procedural penal<sup>106</sup>.

Rrethi i subjekteve që përfshihen në konceptin “viktimë akuzues” janë si personat fizikë ashtu edhe personat juridikë. Viktima akuzuese i drejtohet gjykatës nëpërmjet një kërkesë me shkrim, e cila depozitohet në sekretarinë e gjykatës kompetente. Në nenin 60 të K.Pr. Penale ka parashikuar në mënyrë të detajuar elementet që duhet të përmbajë kërkesa, me qëllim mundësimin e zhvillimit të një procesi gjyqësor normal. Mosparaqitja e personit të dëmtuar apo përfaqësuesit të tij në seancë gjyqësore pa shkaqe të arsyeshme, sjell pushimin e gjyimit.

<b><i>Treguesit e realizimit</i></b>	<b><i>Po/Jo</i></b>
Në rast se përmbajtja e kërkesës së të dëmtuarit akuzues nuk ka plotësuar elementet e parashikuara në ligj, a i ka caktuar afat trupi gjykues që të plotësojë të metat e kërkesës?	
Kur viktima akuzuese nuk ka pasur zotësi për të vepruar, a janë ushtruar nëpërmjet përfaqësuesit ligjor të drejtat që i janë njohur me ligj?	

103. Direktiva 2012/29/EU e Bashkimit Evropian.

104. Vendimi Hugh Jordan kundër Mbretërisë së Bashkuar, datë 04.05.2001, GjEDNj. Vendimin Giuliani dhe Gaggio kundër Italisë, datë 24.05.2011, GjEDNj.

105. Neni 59 i K.Pr.P.

106. Vendim i GJK nr.3/2008.

A është kërcënuar viktima akuzuese për të mos u paraqitur në seancë dhe/ose për të tërhequr kërkesën?	
A përputhet qëndrimi i prokurorit për dënimin e të pandehurit ose pafajësinë e tij me vendimin përfundimtar të gjykatës?	
A i është njoftuar kërkesa nga gjykata personit që akuzohet brenda një kohe të arsyeshme për të organizuar mbrojtjen?	

### **Metoda e matjes**

- Analiza e vendimeve të gjykatave më të larta për vendimet e gjykatave më të ulëta lidhur me shqyrtimin e ankimeve për procedimet penale të iniciuara nga viktima akuzuese.
- Analiza e raporteve vjetore të gjykatave.

## **Faktori 3.5 Tarifat dhe shpenzimet gjyqësore**

### **Standardet e performancës**

Nëpërmjet ligjit nr. 98/2017 “Për tarifat gjyqësore në Republikën e Shqipërisë” janë përcaktuar llojet e tarifave gjyqësore, masa, mënyra dhe afati i pagesës së tyre. Lidhur me tarifat gjyqësore të përgjithshme, ky ligj ka parashikuar që llojet dhe masat përkatëse të tarifave gjyqësore të përgjithshme, sipas këtij neni, për çdo shkallë gjykimi, përcaktohen me udhëzim të përbashkët të ministrit përgjegjës për drejtësinë dhe ministrit përgjegjës për financat, me propozimin e KLGj-së, mbi bazën e natyrës së çështjes, parimeve të proporcionalitetit dhe progresivitetit. Aktualisht, akti nënligjor i parashikuar më sipër nuk është miratuar ende dhe tarifat gjyqësore parashikohen nëpërmjet shtojcës nr. 1 të Udhëzimit të përbashkët të ministrit të Financave dhe MD nr. 5668, datë 20.11.2013 për një ndryshim në Udhëzimin nr. 13, datë 12.02.2009 “Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për veprime e shërbime të administratës gjyqësore e MD, Shërbimit Përmbarimor, Prokurorisë, Noterisë dhe Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.

Për ngritjen e padisë dhe në momentin e paraqitjes së saj paguhet taksa mbi aktet, në rastet dhe në masën e caktuar sipas ligjit<sup>107</sup>. Taksa mbi aktet paguhet në bazë të vlerës së padisë<sup>108</sup>. Pala që kërkon njoftimin duhet të shoqërojë kërkesën me shpenzimet e nevojshme të njoftimit<sup>109</sup>. Shpenzimet gjyqësore parapagohen nga pala kërkuuese, por gjykata, duke marrë parasysh rrethanat e çështjes dhe gjendjen pasurore të palëve, mund të ngarkojë njërin ose të dyja palët që të paguajnë shpenzimet e tyre, pavarësisht se kush prej tyre ka kërkuar pyetjen e dëshmitarëve, kryerjen e ekspertimit ose të këqyrjes. Kur një palë është e detyruar që të paguajë shpenzimet gjyqësore dhe nuk i paguan vullnetarisht, gjykata urdhëron me

107. Nenet 102, 156 të K.Pr.C.

108. Neni 104 i K.Pr.C.

109. Neni 136 i K.Pr.C.

vendim nxjerrjen e tyre të detyrueshme<sup>110</sup>.

Taksa mbi aktet dhe shpenzimet e tjera gjyqësore, nga pagimi i të cilave pala është përjashtuar, i ngarkohen palës tjetër në masën e pjesës së padisë që është pranuar nga gjykata<sup>111</sup>. I padituri ka të drejtë të kërkojë pagimin e shpenzimeve gjyqësore që ka bërë, edhe në rast se është vendosur pushimi i gjykimit. Kur çështja përfundon me pajtim, shpenzimet gjyqësore mbeten në ngarkim të secilës palë që i ka bërë, përveç kur ka marrëveshje të kundërt. Kur çështja përfundon me pajtim, shpenzimet gjyqësore mbeten në ngarkim të secilës palë që i ka bërë, përveç kur ka marrëveshje të kundërt<sup>112</sup>. Për caktim të gabuar të vlerës së padisë dhe për llogaritje të gabuar të taksave mbi aktet dhe të shpenzimeve të tjera gjyqësore mund të bëhet ankim i veçantë.

Në këtë mënyrë, është përcaktuar përgjegjësia e palëve për shpenzimet gjyqësore gjatë procesit gjyqësor, përbërja e tyre, mënyra e caktimit, e parapagimit dhe cilës palë i ngarkohen ato. Ligji procedural detyron gjykatën që jo vetëm të shprehet në vendimin e saj në përfundim të hetimit gjyqësor se kujt i ngarkohet pagimi i tyre, por edhe e detyron gjykatën të bëjë përllogaritjen e këtyre shpenzimeve. Nenet 102, 103,104 të K.Pr.C, e detyrojnë gjykatën të bëjë edhe urdhërimet e nevojshme në rast parapagimi të shpenzimeve gjyqësore në bazë të nenit 105 të K.Pr.C.

E drejta e ankimit për caktimin e shpenzimeve gjyqësore lidhet me faktin kur llogaritja e shpenzimeve gjyqësore ose caktimi i tyre është bërë në mënyrë të gabuar dhe jo në rastin kur gjykata nuk i ka parashikuar aspak vlerat e tyre. Në këtë rast pala ka të drejtën të kërkojë pagimin e shpenzimeve gjyqësore.<sup>113</sup> Kur nga përmbajtja e vendimit nuk rezultojnë të parashikuara këto shpenzime, apo pavarësisht se janë parashikuar dhe i janë ngarkuar njërës palë, por pa u specifikuar, personi në favor të të cilit njihen këto shpenzime duhet të vërë në lëvizje gjykatën me kërkesën për plotësim të vendimit bazuar në nenin 313 të K.Pr.C, apo nëpërmjet një ndreqje gabimi sipas nenit 312 të K.Pr.C<sup>114</sup>.

<b><i>Treguesit e realizimit</i></b>	<i>Po/Jo</i>
A janë informuar palët për tarifat dhe shpenzimet gjyqësore përpara fillimit të procesit?	
A është paguar tarifa për paraqitjen e padisë?	
A është depozituar në dosjen gjyqësore dokumentacioni financiar i cili pasqyron shpenzimet gjyqësore?	
A janë pasqyruar në vendimin përfundimtar të gjykatës shpenzimet gjyqësore?	

110. Neni 105 i K.Pr.C.

111. Neni 106 i K.Pr.C.

112. Neni 108 i K.Pr.C.

113. Vendim nr. 20/2012 i GjL-së.

114. Vendim nr. 587/2014 i GjL-së.

A i janë ngarkuar tarifat dhe shpenzimet gjyqësore palës që ka humbur gjyqin?	
A është përcaktuar drejt nga gjykata masa e tarifës së padisë?	
A është përcaktuar drejt nga gjykata masa e shpenzimeve gjyqësore për pagesën e shpërblimit të ekspertit?	
A është përcaktuar drejt nga gjykata masa e shpenzimeve gjyqësore për pagesën e shpërbimit të avokatit?	
A është përcaktuar drejt nga gjykata masa e shpenzimeve gjyqësore për pagesën e shpërblimit të dëshmitarit?	
A u organizuan dhe u zhvilluan procedurat gjyqësore në mënyrë të tillë që shpenzimet për palët dhe subjektet e tjera të përfshira në proces të minimizohen?	
A ka një sistem nëpërmjet të cilit palët mund të informohen kur seanca shtyhet apo vonohet?	

<b><i>Treguesit e realizimit</i></b>	<b><i>Përqindja</i></b>
Cili është niveli i perceptimit të përdoruesve të gjykatës lidhur me nivelin e kostove të procesit gjyqësor?	
Cili është niveli i perceptimit të përdoruesve të gjykatës lidhur me transparencën dhe bazueshmërinë e tarifës së zbatuar nga gjykata për pagesën e shpërblimit të ekspertit?	
Cili është niveli i perceptimit të përdoruesve të gjykatës lidhur me masat organizative të marra nga gjykata në mënyrë të tillë që shpenzimet për palët dhe subjektet e tjera të përfshira në proces të minimizohen?	

### ***Metoda e matjes***

- Analiza e vendimeve të gjykatave më të larta për vendimet e gjykatave më të ulëta lidhur me shqyrtimin e ankimeve për llogaritjen dhe caktimin në ngarkim të tarifave dhe të shpenzimeve gjyqësore.
- Analiza e raporteve vjetore të gjykatave.
- Zhvillimi i sondazhit kombëtar.

## Pjesa 4

### MONITORIMI I GJYKIMIT BRENDA NJË AFATI TË ARSYESHËM

#### **Faktori 4.1 Veprimtaria e gjykatave në respektimin e afateve të arsyeshme për zhvillimin e proceseve gjyqësore**

##### *Standardet e performancës*

Në nenin 42, paragrafi 2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, e drejta për realizimin e një gjykimi brenda një afati të arsyeshëm, parashikohet si një nga komponentët më të rëndësishëm të zhvillimit të një procesi të rregullt ligjor (gjyqësor). Kjo e drejtë është e lidhur ngushtë me parimet themelore të shtetit të së drejtës. Një drejtësi joefikase dhe e vonuar çon në dëmtimin e besimit të qytetarëve tek institucionet e shtetit. Një vendim i vonuar, madje mund të zhbëjë edhe vetë arsyen për të cilën është dhënë vendimi, pasi dhënia e tij në vonesë mund të bëjë që ai të jetë krejt i pavlefshëm për palën e interesuar.

Në analizë të sa u tha më sipër, në çështjet civile periudha e arsyeshme që merret në konsideratë për zhvillimin e procesit të rregullt ligjor, fillon me ngritjen e padisë dhe përfundon kur vendimi merr formë të prerë. Në kuptim të nenit 6, parag.1 të KEDNj-së, përcaktuese për atë që konsiderohet “*afat i arsyeshëm*” janë:

- i. shkalla e kompleksitetit të çështjes;
- ii. sjellja e organeve kompetente për shqyrtimin e saj;
- iii. sjellja e palëve ndërgjyqëse dhe kryesisht e palës që vë në lëvizje gjykatën;

##### **i. shkalla e kompleksitetit të çështjes;**

Për vlerësimin e kompleksitetit të procedimeve duhet të kenë rëndësi të gjitha aspektet e çështjes, përfshi objektin e çështjes, faktet e kundërshtuara dhe volumin e provave shkresore<sup>115</sup>.

##### **ii. sjellja e organeve kompetente për shqyrtimin e saj;**

Gjykatat kanë për detyrë të sigurojnë, që të gjitha subjektet që marrin pjesë në proces të sillen në mënyrë që të evitojnë çdo vonesë të panevojshme. Kjo detyrë e gjykatave gjen artikullimin e saj edhe në dispozitat procedurale civile, e konkretisht në nenin 4 të K.Pr.C sipas të cilit “*gjykata kujdeset për zhvillimin e rregullt të procesit gjyqësor*”. Për këtë qëllim, në bazë të kompetencave që i jep ky Kod, gjykata vendos për afatet dhe urdhëron marrjen e masave

---

115. Vendim nr. 9/2009 i GjK-së; Vendim nr. 8/2010 i GjK-së; Vendim nr. 14/2010 i GjK-së; Vendim nr.50/2011 i GjK-së; Vendim nr. 10/2012 i GjK-së; Vendim nr. 49/2012 i GjK-së.

të nevojshme dhe në nenin 171/a të K.Pr.C sipas të cilit *“gjkata ushtron të gjitha të drejtat e përcaktuara në këtë Kod, që janë të nevojshme për zhvillimin sa më të mirë të procesit gjyqësor”*. Gjykata cakton seancat dhe afatet brenda të cilave palët dhe personat e tjerë të thirrur prej saj duhet të kryejnë aktet procedurale dhe veprimet e tjera të kërkuara prej saj<sup>116</sup>.

Edhe pse kuadri procedural civil ka parashikuar parimin se iniciativat procedurale u takojnë palëve (neni 2 i K.Pr.C), kjo nuk i shkarkon gjykatat nga detyrimi për të siguruar një gjykim të shpejtë, siç kërkon neni 42 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe neni 6/1 i KEDNj-së. Në këtë drejtim edhe GjEDNj-ja ka mbajtur të njëjtin qëndrim<sup>117</sup>.

### iii. **sjellja e palëve ndërgjyqëse dhe kryesisht e palës që vë në lëvizje gjykatën;**

Shtyrja e gjykimit për shkaqe që i ngarkohen paditësit, që lidhen më së shumti me përmbushjen dhe ushtrimin e të drejtave të saj procedurale, të parashikuara nga K.Pr.C si p.sh. rregullimi i të metave të padisë, plotësimi i bazës ligjore të saj, parashtrimi i provave mbi të cilat mbështetet kërkitimi i ngritur, apo edhe me pamundësinë objektive për të ndjekur seancën gjyqësore, për shkak se mbrojtësit e saj në të njëjtën ditë dhe orë ndodhet në gjykime të tjera<sup>118</sup>, duke u përdorur nga ana e tij të gjitha procedurat e parashikuara nga e drejta e brendshme, me qëllim sigurimin e mbrojtjes, nuk mund të përdoret si argument kundër tij<sup>119</sup>.

Nga ana tjetër, duhet theksuar se në gjykimet civile pritet që palët të kenë qëndrim më aktiv se në një proces penal. Palët duhet të evitojnë shtyrjet e pajustificuara të procesit apo taktikat për të krijuar vonesa, ç’ka nënkupton se ato duhet të rezervohen me paraqitjen e kërkesave që çojnë në zgjatjen e çështjes, dhe duhet të marrin të gjitha masat për një përfundim sa më të shpejtë të procesit<sup>120</sup>.

Në rastin e gjykimeve civile dhe administrative, afate të arsyeshme të përfundimit të hetimit, gjykimit apo ekzekutimit të një vendimi të formës së prerë, do të konsiderohen:

- a) në gjykimin administrativ në shkallën e parë dhe në apel, përfundimi i gjykimit brenda 1 viti nga fillimi i tij në secilën shkallë; Lidhur me afatet e gjykimit të mosmarrëveshjeve administrative, neni 48 i ligjit nr. 49/2012 parashikon se *“gjkata e apelit e shqyrton ankimin brenda 30 ditëve nga data e ardhjes së tij nga gjykata ku është paraqitur”*.
- b) në gjykimin civil në shkallë të parë përfundimi i procesit të gjykimit brenda 2 viteve, në gjykim civil në apel brenda 2 viteve; dhe gjykimin civil në GjL, brenda 2 viteve;
- c) në procedurën e ekzekutimit të një vendimi civil apo administrativ, me përjashtim të detyrimeve periodike ose të përcaktuara në kohë, afati njëvjeçar fillon nga dita e paraqitjes së kërkesës për vënie në ekzekutim;
- ç) në hetimin e veprave penale afati maksimal i kohëzgjatjes së hetimeve, sipas K.Pr.P ;
- d) në gjykimin penal në shkallë të parë, afati i gjykimit të krimeve 2 vjet dhe i kundërvajtjeve 1 vit, në gjykimin në apel përfundimi i gjykimit për krimet në një afat kohor prej 1 viti

116. Vendim nr. 12/2012 i GjK-së.

117. Vendim Surmeli kundër Gjermanisë, datë 08/06/2006, GjEDNj.

118. Vendim nr. 9/2009 i GjK-së.

119. Vendim nr. 50/2011 i GjK-së; Vendim nr. 14/2010 i GjK-së; Vendim nr. 10/2012 i GjK-së.

120. Vendim nr. 549/2012 i GjL-së.

dhe për kundërvajtjet 6 muaj dhe në GjL, përfundimi i gjykimit për krimet në një afat kohor prej 1 viti dhe për kundërvajtjet 6 muaj.

Në rast se gjykata vendos masën e arrestit në burg ose në shtëpi, jo më vonë se 3 ditë nga zbatimi i masës, gjykata e merr në pyetje personin për të cilin ka vendosur masën. Për masat e tjera të sigurimit, shtrënguese ose ndaluese, gjykata procedon me marrjen në pyetje brenda 5 ditëve nga zbatimi i masës<sup>121</sup>.

Kundër vendimit të gjykatës për caktimin e masës së sigurimit, mospranimin ose rrëzimin e saj, lejohet ankim brenda 5 ditëve nga njoftimi i vendimit të gjykatës. Gjithashtu, kundër vendimit të gjykatës për vazhdimin, revokimin ose zëvendësimin e masës së sigurimit, prokurori, i pandehuri dhe mbrojtësi i tij mund të bëjnë ankim brenda 5 ditëve. Ankimi shqyrtohet brenda 10 ditëve nga marrja në dorëzim e akteve. Gjukata vendos, sipas rastit, shfuqizimin, ndryshimin ose miratimin e vendimit, edhe për arsye të ndryshme nga ato që janë parashtruar ose nga ato që tregohen në pjesën arsyetuese të vendimit. Gjukata depoziton vendimin e arsyetuar brenda 10 ditëve<sup>122</sup>.

Në rastin e arrestimit në flagrancë ose të ndalimit të dyshuarit për një krim, prokurori kur nuk urdhëron lirimin e menjëhershëm, brenda 48 orëve nga arrestimi ose ndalimi, kërkon vleftësimin e masës në gjykatën e vendit ku është kryer arrestimi ose ndalimi. Mosrespektimi i këtij afati bën që arrestimi ose ndalimi të humbasë fuqinë. Gjukata cakton seancën e vleftësimit sa më shpejt duke lajmëruar prokurorin dhe mbrojtësin.<sup>123</sup> Arrestimi ose ndalimi e humbet fuqinë kur vendimi i gjykatës për vleftësimin nuk është shpallur brenda 48 orëve të ardhshme nga çasti në të cilin kërkesa e prokurorit është paraqitur në gjykatë<sup>124</sup>.

Kërkesa e prokurorit ose e të pandehurit për revokimin, zëvendësimin ose bashkimin e masave të sigurimit shqyrtohet nga gjykata ku ndodhen aktet, brenda 5 ditëve nga depozitimi i saj<sup>125</sup>.

<b><i>Treguesit e realizimit</i></b>	<i>Po/Jo</i>
A përfundoi gjykimi administrativ në shkallën e parë dhe në apel, brenda 1 viti nga fillimi i tij në secilën shkallë?	
A përfundoi në gjykimin civil në shkallë të parë gjykimit brenda 2 viteve, në apel brenda 2 viteve dhe në GjL, brenda 2 viteve?	
A përfundoi hetimi i veprave penale brenda afateve maksimale të parashikuara në ligj?	
A përfundoi gjykimi penal në shkallë të parë, brenda afatit 2-vjeçar në rastin e gjykimit për krimet dhe 1 vit për kundërvajtjet, gjykimi në apel në një afat kohor prej 1 viti për krimet dhe 6 muaj për kundërvajtjet dhe gjykimi në GjL, një afat kohor prej 1 viti për krimet dhe për kundërvajtjet 6 muaj.	

121. Neni 248 i K.Pr.P.

122. Neni 249 i K.Pr.P.

123. Neni 258 i K.Pr.P.

124. Neni 259 i K.Pr.P.

125. Neni 260/4 i K.Pr.P.



A e ka shqyrtuar gjykata administrative e apelit ankimin brenda 30 ditëve nga data e ardhjes së tij nga gjykata ku është paraqitur?	
A është marrë në pyetje nga gjykata personi për të cilin ka vendosur masën e arrestit në burg ose në shtëpi, jo më vonë se 3 ditë nga zbatimi i masës?	
A është marrë në pyetje nga gjykata personi për të cilin është vendosur ndonjë nga masat e tjera të sigurimit, jo më vonë se 5 ditë nga zbatimi i masës?	
A është shqyrtuar nga gjykata e apelit ankimi kundër vendimit që cakton masën e sigurimit brenda 10 ditëve nga marrja në dorëzim e akteve?	
A e ka depozituar vendimin e arsyetuar gjykata e apelit brenda 10 ditëve?	
A është kërkuar nga prokurori vleftësimi i masës në gjykatë brenda 48 orëve nga arrestimit në flagrancë ose ndalimit të dyshuarit për një krim?	
A është caktuar nga gjykata seanca e vleftësimit brenda një afati sa më të shpejtë?	
A është shpallur vendimi i gjykatës për vleftësimin e masës brenda 48 orëve nga çasti në të cilin kërkesa e prokurorit është paraqitur në gjykatë?	

<b><i>Treguesit e realizimit</i></b>	<i>Përqindje</i>
Sa është niveli i kënaqësisë së palëve lidhur me afatet për përfundimin e gjykimeve në shkallën e parë?	
Sa është niveli i kënaqësisë së palëve lidhur me afatet për shqyrtimin e ankimeve/rekurseve në gjykatat e apelit dhe në Gjykatën e Lartë?	
Sa është niveli i kënaqësisë së palëve lidhur me afatet për përfundimin e procedimeve penale?	

### ***Metoda e matjes***

- Analiza e vendimeve të gjykatave më të larta për vendimet e gjykatave më të ulëta për rastet kur është konstatuar shkelja e të drejtës për të pasur një gjykim brenda një afati të arsyeshëm.
- Analiza e jurisprudencës të GjK-së për vendimet e ankimeve të paraqituara bazuar në nenin 131/f të Kushtetutës, në kuadër të respektimit të drejtës për të pasur një gjykim brenda një afati të arsyeshëm.
- Analiza e jurisprudencës të GjEDNj-së, për vendimet kundër Shqipërisë për respektimin e nenit 6 të KEDNj-së, në kuadër të të drejtës për të pasur një gjykim brenda një afati të arsyeshëm.

- Statistikat vjetore për veprimtarinë e GjK-së.
- Zhvillimi i sondazheve lokale dhe kombëtare.

## **Faktori 4.2 Roli i gjykatave më të larta në mbikëqyrjen e garantimit e të drejtës për t'u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm.**

### ***Standardet e performancës***

K.Pr.C. ka përcaktuar se cilat konsiderohen afate të arsyeshme (neni 399/2), llojet e mjeteve për t'u mbrojtur nga cenimi, si kërkesa për përshpejtimin e procedurave (neni 399/4), kërkesa për dëmshpërblim dhe çfarë konsiderohet shpërblim i drejtë (neni 399/3), cila është gjykata kompetente për shqyrtimin e kërkesës (nenet 399/4 dhe 399/6), rregullat për gjykimin e kërkesës (neni 399/7) deri te marrja e vendimit dhe zbatimi i tij (nenet 399/8 – 399/12). Për rrjedhojë, ligji procedural ka parashikuar mjete ligjore nëpërmjet të cilave individit i garantohet mbrojtja në rastet e cenimit të së drejtës për gjykimin ose për ekzekutimin e vendimit gjyqësor brenda afatit të arsyeshëm.

Personat që kanë pësuar një dëm pasuror ose jopasuror, për shkak të kohëzgjatjes së paarsyeshme të çështjes si më sipër mund të paraqesin kërkesë për shpërblimin e dëmit. Palët në proces mund të kërkojnë konstatimin e tejzgjatjes së procedurave, edhe pa kaluar afatet e mësipërme (shih faktorin 4.1), duke pasur parasysh kompleksitetin e çështjes, objektin e mosmarrëveshjes, të procedimit ose të gjykimit, sjelljen e organit që po kryen procedurat, si dhe të çdo personi tjetër të lidhur me çështjen, kur pretendojnë zvarritje të hetimit, gjykimit ose ekzekutimit të vendimit. Në kohëzgjatjen e gjykimit ose të procedimit, nuk llogaritet koha kur çështja është pezulluar për shkaqe ligjore, kur është shtyrë për shkak të kërkesave të palës kërkuese, sipas këtij kreu, ose kur shfaqen rrethana të pamundësisë objektive për procedim<sup>126</sup>. Ligjvënësi në miratimin e neneve 399/1 e vijues të KPC-së ka synuar krijimin e një mjeti juridik efektiv për t'i garantuar individit të drejtën kushtetuese të procesit të rregullt ligjor, duke i dhënë një rol specifik gjykatave të juridiksionit të zakonshëm dhe në veçanti GjL-së, që përmes shqyrtimit të kërkesave për përshpejtim, të parandalojnë shkeljet kushtetuese në zbatim të parimit të subsidiaritetit, pasi, siç është pohuar në jurisprudencën kushtetuese, kontrolli i respektimit të standardeve kushtetuese është, në radhë të parë, funksion i gjykatave të zakonshme<sup>127</sup>.

<b><i>Treguesit e realizimit</i></b>	<i>Po/Jo</i>
A është marrë vendim nga gjykata për kërkesën për konstatimin e shkeljes së afatit dhe përshpejtimin e procedurave brenda afatit 45-ditor?	
A është shqyrtuar brenda afatit 3-mujor kërkesëpapia për shpërblimin e dëmit në rastin kur është konstatuar shkelja e afatit?	

126. Nenet 399/1 dhe 399/2 të K.Pr.C.

127. Vendim nr. 2/2022 i GjK-së; Vendim nr. 3/2021 i GjK-së; Vendim nr. 11/2018 i GjK-së.

Duke pasur parasysh kompleksitetin e çështjes, objektin e mosmarrëveshjes, të procedimit ose të gjykimit, sjelljen e organit që ka kryer procedurat, si dhe të çdo personi tjetër të lidhur me çështjen, a është vendosur konstatimi i tejzgjatjes së procedurave gjyqësore, pavarësisht se nuk janë tejkaluar afatet e përcaktuara në ligj?	
A ka vendosur gjykata masën e shpërblimit të drejtë brenda kufijve të parashikuara në ligj?	
A i është përcjellë ILD-së vendimi i cili ka konstatuar shkeljen e afatit të arsyeshëm për përfundimin e gjykimit për të vlerësuar nëse vonesat e shkaktuara nga gjyqtarët përbëjnë shkelje disiplinore?	

### **Metoda e matjes**

- Analiza e vendimeve të gjykatave për rastet kur është konstatuar kërkesa për shkeljen e afatit, përshpejtimin e procedurave dhe shpërblimin e dëmit.
- Analiza e jurisprudencës të GjK-së për vendimet e ankimeve të paraqitura bazuar në nenin 131/f të Kushtetutës, në kuadër të respektimit të detyrimit për respektimin e parimit të gjykimit brenda një afati të arsyeshëm.
- Analiza e jurisprudencës të GjEDNj-së, për vendimet kundër Shqipërisë për respektimin e nenit 6 të KEDNj-së, në kuadër të detyrimit për respektimin e parimit të gjykimit brenda një afati të arsyeshëm.
- Statistikat vjetore për veprimtarinë e GjK-së.
- Analiza e vjetarit statistikor të MD-së.
- Paraqitja e kërkesave për informacion.

### **Faktori 4.3 Efektiviteti i ekzekutimit të vendimeve gjyqësore**

#### **Standardet e performancës**

Në pikën 3 të nenit 142 të Kushtetutës sanksionohet se palët janë të detyruara të ekzekutojnë vendimet gjyqësore të formës së prerë. Norma kushtetuese nuk lejon asnjë hapësirë dhe justifikim të çfarëdo natyre dhe për cilindo, aq më tepër për organet shtetërore, që të mos ekzekutojnë atë që disponohet me vendimin gjyqësor të formës së prerë, përse kohë ky titull ekzekutiv të mos jetë shpallur i pavlefshëm apo se detyrimi nuk ekziston sipas nenit 609 të K.Pr.C., me anë të një vendimi tjetër gjyqësor të dhënë në një gjykim të posaçëm të mëvonshëm. Titulli ekzekutiv, pra edhe kur ai është një vendim gjyqësor, nëse ka fakte e rrethana të ngjara pas dhënies së vendimit titull ekzekutiv, duhet që të kundërshtohet në gjykatë. ***Në përputhje me parashikimet e nenit 449 dhe 451 të KPC-së, vendimi i gjykatës së apelit është i formës së prerë dhe ushtrimi i rekursit ndaj tij pranë GjL-së nuk ka efekt pezullues, me përjashtim të rasteve kur kjo e fundit vendos pezullimin e vendimit të rekursuar, në bazë të nenit 479 të KPC-së<sup>128</sup>.*** Pra, me dhënien e vendimit nga Gjykata e Apelit, debitori duhet të

128. Vendim nr. 56/2012 i GjK-së.

marrë masa të menjëhershme për ekzekutimin e vendimit të kësaj gjykate, pasi ekzekutimi nuk kushtëzohet as me ankimin në GjL, as me bërjen e kërkesës në organet përmbarimore. Në rast se debitori pretendon se ekzekutimi i vendimit është i pamundur, ky fakt nuk përbën shkak të mbështetur në ligj për mosekzekutimin e vendimit, sepse është detyrim i debitorit që në çdo këtë rast të gjejë mundësitë e duhura për të përmbushur detyrimin që rrjedh nga vendimi gjyqësor i formës së prerë. Mosekzekutimi i vendimit gjyqësor të formës së prerë nga autoritetet e ngarkuara nga ligji dhe brenda një afati të arsyeshëm, passjell cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, e parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe neni 6/1 i KEDNj-së.

K.Pr.C. lejon mundësinë e kundërshtimit të procesit të ekzekutimit të detyrueshëm, duke parashikuar mjetet mbrojtëse kundër ekzekutimit të vendimit të formës së prerë. Ky kundërshtim mund të bëhet nëpërmjet:

- Pavlefshmërisë së titullit ekzekutiv (neni 609 i K.Pr.C.); Debitori mund të kërkojë në gjykatën kompetente të vendit të ekzekutimit që të deklarohet se titulli ekzekutiv është i pavlefshëm, detyrimi nuk ekziston, detyrimi ekziston në një masë më të vogël, detyrimi është shuar më pas.
- Kundërshtimit të veprimeve përmbarimore (neni 610 i K.Pr.C.); Kundër veprimeve të përmbaruesit gjyqësor dhe kundër refuzimit të përmbaruesit gjyqësor për të kryer një veprim që ia ngarkon ligji, palët mund të bëjnë ankim në gjykatën që ekzekuton vendimin, brenda 5 ditëve nga dita e kryerjes së veprimit ose refuzimit, ose nga dita që u është njoftuar ose kanë marrë dijeni për veprimin ose refuzimin.
- Kërkimi i sendit nga personi i tretë (neni 612 i K.Pr.C.); Çdo person i tretë që pretendon se është pronar i sendit mbi të cilin bëhet ekzekutimi, mund të ngrejë padi për të ushtruar të drejtën e tij dhe kur është rasti për të përjashtuar sendin nga sekuestrimi dhe shitja.

<b><i>Treguesit e realizimit</i></b>	<i>Po/Jo</i>
A i ka vendosur në dispozicion administrata gjyqësore vendimin e formës së prerë palës që ka fituar gjyqin brenda një kohe të arsyeshme?	
A ka kryer përmbaruesi të gjitha veprimet e nevojshme për ekzekutimin e vendimit gjyqësor?	
A i është drejtuar përmbaruesi debitorit duke i dërguar lajmërimet për ekzekutim vullnetar, për ekzekutimin e detyrueshëm, urdhrat për vendosjen e sekuestrove, kërkesa për përmbushjen e detyrimit, gjoba të ndryshme?	
A i ka respektuar përmbaruesi afatet procedurale për kryerjen e veprimeve të mësipërme?	
A i ka përmbushur përmbaruesi detyrimet e vendosura nga gjykata për pezullimin e ekzekutimit të titullit ekzekutiv ose veprimeve përmbarimore?	

A kanë përmbushur organet e shtetit detyrimin që buron nga vendimi gjyqësor vullnetarisht?	
A i kanë përmbushur organet e shtetit detyrimin që buron nga vendimi gjyqësor nëpërmjet procedurës së ekzekutimit të detyrueshëm?	

### **Metoda e matjes**

- Analiza e vendimeve të gjykatave më të larta për vendimet e gjykatave më të ulëta për rastet kur është konstatuar shkelja e të drejtës për t'u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm për shkak të mosekzekutimit të vendimit.
- Analiza e jurisprudencës të GjK-së për vendimet e ankimeve të paraqitura bazuar në nenin 131/f të Kushtetutës, në kuadër të respektimit të të drejtës për t'u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm për shkak të mosekzekutimit të vendimit.
- Analiza e jurisprudencës të GjEDNj-së, për vendimet kundër Shqipërisë për respektimin e nenit 6 të KEDNj-së, në kuadër të të drejtës për t'u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm për shkak të mosekzekutimit të vendimit.
- Paraqitja e kërkesave për informacion.

### **Faktori 4.4 Efektiviteti i vendimeve të organeve të drejtësisë për garantimin e të drejtës për t'u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm**

#### **Standardet e performancës**

KL Gj me vendimin nr. 78, datë 30.05.2019, ka miratuar rregullat për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve nga Gjykata e Apelit. Nëpërmjet këtij vendimi, ndër të tjera, janë parashikuar rastet kur mosmarrëveshjet shqyrtohen me procedurë të përshpejtuar. Shqyrtimi i një çështjeje, mund të përshpejtohet vetëm mbi kërkesë të palëve, për shkak të natyrës dhe të kategorisë specifike të çështjes ose për shkaqe veçanërisht të rënda dhe të motivuara, kur kjo nuk vjen në kundërshtim me ligjin. Shkaqet e mësipërme janë parashikuar në përmbajtjen e vendimit të KLGj-së.

Kërkesa për përshpejtimin e shqyrtimit të çështjes bëhet në formë të shkruar dhe duhet të nënshkruhet, me pasojë refuzimin e shqyrtimit, nga vetë pala apo përfaqësuesi i saj, i zgjedhur me prokurë ose me deklaram përpara gjykatës. Gjyqtari relator shqyrton kërkesën e palës për përshpejtimin e shqyrtimit të çështjes, jo më vonë se 30 ditë nga dita e dorëzimit të kërkesës.

Lidhur me procedurën e shqyrtimit të gjyqësorit në GjL, nëpërmjet Urdhërit nr.284, datë 06.11.2017 të Kryetarit të GjL-së, janë përcaktuar rregullat për shqyrtimin e rekurseve dhe kërkesave për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm ose për përshpejtimin e procedurave të gjykimit.

<b><i>Treguesit e realizimit</i></b>	<i>Po/Jo</i>
A kanë paraqitur palët kërkesë për përshpejtimin e gjykimit?	
A kanë paraqitur palët dokumentacion shkresor për të provuar shkakun e pretenduar për përshpejtimin e gjykimit?	
A e ka shqyrtuar Gjykata e Apelit kërkesën për përshpejtimin e gjykimit dhe ka marrë një vendim për të?	
A është shqyrtuar kërkesa e palës për përshpejtimin e shqyrtimit të çështjes nga gjyqtari relator, jo më vonë se 30 ditë nga dita e dorëzimit të kërkesës?	
A ka qenë gjykata përpara rasteve të parashikuara në ligj për të vendosur përshpejtimin e shqyrtimit të çështjes?	
A është shqyrtuar ankimi brenda afatit të përcaktuar në vendimin i cili ka pranuar kërkesën për përshpejtimin e gjykimit të çështjes?	
A janë ndërmarrë inspektime nga ILD lidhur me moszbatimin nga gjykatat të kalendarit për gjykimin e çështjeve sipas radhës së regjistrimit?	
A janë marrë masa për të siguruar një shpërndarje të drejtë dhe efikase të ngarkesës ndërmjet gjyqtarëve (domethënë monitorimi i ecurisë së proceseve gjyqësore, shpërndarja e drejtë e numrit të çështjeve që i janë caktuar secilit gjyqtar, pjesëmarrja e gjyqtarëve në aktivitete të tjera, etj.)?	

<b><i>Treguesit e realizimit</i></b>	<i>Përqindje</i>
Cili është raporti i rasteve në të cilat janë pranuar dhe refuzuar kërkesat për përshpejtimin e gjykimit?	
Cili është raporti i rasteve ndërmjet pranueshmërisë së kërkesave për përshpejtimin e gjykimit dhe pranueshmërisë së ankimeve si të bazuara në ligj?	
Cili është raporti i kërkesave për përshpejtimin e gjykimit të paraqitura nga avokatë të caktuar dhe të pranuar nga gjyqtarë të caktuar?	
Cili është niveli i perceptimit të qytetarëve për masat e marra nga organet e drejtësisë për garantimin e të drejtës për t'u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm?	
Cili është niveli i perceptimit të qytetarëve dhe avokatëve për vendimet e marra nga gjykatat për gjykimin e çështjeve me procedurë të përshpejtuar?	
Cili është niveli i perceptimit të qytetarëve dhe avokatëve për zbatimin nga gjykatat të kalendarit për gjykimin e çështjeve sipas radhës së regjistrimit?	

### ***Metoda e matjes***

- Analiza e vendimeve gjyqësore.
- Analiza e raporteve vjetore të gjykatave.
- Paraqitja e kërkesave për informacion.
- Zhvillimi i sondazheve lokale dhe kombëtare.

## Pjesa 5

# MONITORIMI I CILËSISË SË GJYKIMEVE

### **Faktori 5.1 Kontrolli i vendimeve gjyqësore nga gjykatat më të larta**

#### ***Standardet e performancës***

Gjykatat të cilat kontrollojnë vendimet e gjykatave më të ulëta janë gjykatat e apelit dhe GjL. Gjykatat e Apelit të cilat shqyrtojnë në shkallë të dytë ankimet ndaj vendimeve të gjykatave të shkallës së parë dhe gjithashtu gjykojnë si juridiksion fillestar gjykimet për kërkesat për njohjen e vendimeve të gjykatave të huaja apo arbitrazhit, ankimet ndaj vendimeve të Agjencisë së Trajtimit të Pronave dhe mosmarrëveshjet me objekt aktet nënligjore normative. Vendimet e gjykatës së apelit janë të formës së prerë. Gjykata e Apelit në rastet kur shqyrton ankimin mund të vendosë lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë, ndryshimin e vendimit, prishjen e vendimit dhe pushimin e çështjes dhe prishjen e vendimit dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

GjL e cila shqyrton rekurse ndaj vendimeve të gjykatës së apelit me juridiksion të përgjithshëm për mosmarrëveshje tregtare, civile dhe familjare, rekurse ndaj vendimeve të gjykatave administrative të apelit për çështje administrative, rekurse ndaj vendimeve të gjykatave të apelit me juridiksion të përgjithshëm dhe gjykatave të posaçme për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar për çështje penale, çështje të tjera të caktuara në kompetencë me ligj.

Përveç sa më sipër, ligji i ka njohur GjL-së edhe një kompetencë tjetër lidhur me kontrollin nga GjL të vendimmarrjes të gjykatave më të ulëta nëpërmjet njehsimit ose ndryshimit të praktikës gjyqësore. Vendimet për njehsimin ose ndryshimin e praktikës gjyqësore të Kolegjit Civil dhe Kolegjeve të Bashkuara janë të detyrueshme për gjykatat në gjykimin e çështjeve të ngjashme. GjL mund të vendosë mospranimin e rekursit në rastet kur është paraqitur për shkaqe të ndryshme nga ato që lejon ligji ose nuk plotësohen kërkesat procedurale për paraqitjen e tij, prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë, prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në këtë gjykatë me tjetër trup gjykues, prishjen e vendimeve të gjykatës së apelit dhe të gjykatës së shkallës së parë dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në shkallë të parë, prishjen e vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe të gjykatës së apelit dhe pushimin e gjykimin të çështjes, ndryshimin e vendimit të shkallës së parë dhe të vendimit të gjykatës së apelit dhe zgjidhjen përfundimisht të çështjes kur zbatimi i ligjit procedural apo material nuk diktohet nga nevoja për rishqyrtimin dhe rivlerësimin e fakteve apo të provave



të çështjes, ose lënien në fuqi të vendimit të apelit.

Gjithashtu, në bazë të nenin 131/f të Kushtetutës, GjK ka për kompetencë gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e këtyre të drejtave.

<b><i>Treguesit e realizimit</i></b>	<i>Po/Jo</i>
A i ka shkelur gjykata e shkallës së parë dispozitat mbi juridiksionin dhe kompetencën?	
A ka qenë e rregullt përbërja e trupit gjykues?	
A është cenuar parimi i paanësisë dhe i pavarësisë së trupit gjykues?	
A është gjykuar çështja në mungesë të pjesëmarrësve në proces, pa pasur dijeni për gjykimin?	
A është formuar drejt ndërgjyqësia?	
A është pjesë e dosjes gjyqësore padia, procesverbali gjyqësor, ankimi, si dhe çdo dokument tjetër që ka ndikuar në dhënien e vendimit dhe a janë këto dokumente në formën e kërkuar nga ligji?	
A i ka shqyrtuar gjykata e shkallës së parë të gjitha kërkimet e palëve ndërgjyqëse lidhur me objektin e mosmarrëveshjeve dhe është shprehur për çdo gjë që i është kërkuar?	
A ka vendosur gjykata e shkallës së parë pushimin e çështjes në përputhje me rastet e parashikuara në ligj?	
A ka vendosur gjykata e shkallës së parë mospranimin ose kthimin e padisë në përputhje me rastet e parashikuara në ligj?	
A është zbatuar drejt ligji material nga gjykata e shkallës së parë për zgjidhjen e mosmarrëveshjes?	
A jemi përpara rasteve ku gjykatat më të ulëta e kanë zbatuar gabim ligjin material ose procedural, të një rëndësie themelore për njehsimin, sigurinë dhe/ose zhvillimin e praktikës gjyqësore?	
A jemi përpara rasteve kur vendimi i ankimuar i gjykatave më të ulëta është i ndryshëm nga praktika gjyqësore e Kolegjit Civil ose praktika e njehsuar e Kolegjeve të Bashkuara të GjL-së?	
A jemi përpara rasteve ku gjykatat më të ulëta kanë kryer shkelje të rënda të normave procedurale, me pasojë pavlefshmërinë e vendimit ose të procedurës së gjyqimit?	
A jemi përpara rastit kur vendimi gjyqësor cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë?	

## ***Metoda e matjes***

- Analiza e vendimeve të gjykatave më të larta për vendimet e gjykatave më të ulëta për rastet kur është konstatuar zbatimi i gabuar i ligjit procedural ose material.
- Analiza e jurisprudencës të GjK-së për vendimet e ankimeve të paraqitura bazuar në nenin 131/f të Kushtetutës, në kuadër të cenimit të drejtave dhe lirive themelore të garantuara në Kushtetutë.
- Analiza e raporteve vjetore të gjykatave.
- Analiza e statistikave vjetore për veprimtarinë e GjK-së.
- Analiza e vjetarit statistikor të MD-së.

## **Faktori 5.2 Roli i organeve të qeverisjes së sistemit të drejtësisë në monitorimin e cilësisë së vendimeve**

### ***Standardet e performancës***

KLP dhe KLGj kanë rol thelbësor në vlerësimin e performancës së magjistratit dhe zbatimit të masave disiplinore. Në ndër elementet kryesore të vlerësimit të performancës së magjistratit dhe zbatimit të masave disiplinore është edhe cilësia e vendimeve të marra prej tyre.

Të gjithë magjistratët gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre janë subjekt i vlerësimit të tyre etik dhe profesional. Vlerësimi kryhet sipas kriterëve të mëposhtme:

- a) aftësive profesionale të gjyqtarit nëpërmjet të cilave vlerësohet aftësia profesionale e gjyqtarit në drejtim të njohurive ligjore dhe arsyetimit ligjor.
- b) aftësive organizative nëpërmjet të cilave vlerësohet aftësia e magjistratit për të përballuar ngarkesën e punës dhe për të kryer procedurat hetimore ose gjyqësore, si dhe aftësia për të administruar dosjet gjyqësore, duke shmangur rrethanat, të cilat nuk varen nga magjistrati dhe që kanë efekt negativ në rezultatet e vlerësimit.
- c) etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale të gjyqtarit nëpërmjet të cilave vlerësohet aftësia e magjistratit për etikën në punë, integritetin dhe paanësinë.
- ç) aftësive personale dhe angazhimit profesional nëpërmjet të cilave vlerësohen aftësitë e komunikimit, aftësia për të bashkëpunuar me kolegët dhe gatishmëria për t'u angazhuar në veprimtari të tjera<sup>129</sup>.

Gjithashtu, një rast tjetër kur realizohet vlerësimi i ushtrimit të funksionit nga ana e magjistratit është kur ky i fundit pretendohet që mund të ketë kryer një shkelje disiplinore, me dashje ose për shkak të pakujdesisë. Magjistrati mban përgjegjësi disiplinore për mënyrën e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit, për sa kohë që nga rrethanat objektive dhe subjektive, rezulton se veprimet e tij mund të kenë qenë të qëllimshme dhe në kundërshtim të hapur dhe flagrant me ligjin apo me praktikën unifikuese të gjykatave më të larta. Në çdo rast, bindja e brendshme duhet të jetë në përputhje me ligjin, me analizën e fakteve dhe provave në brendësi të çështjes, për ta kualifikuar atë sipas ligjit.<sup>130</sup> Rastet të cilat përbëjnë shkelje disiplinore janë të parashikuara në nenet 101-104 të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarit dhe prokurorit në Republikën e Shqipërisë. KLGj dhe KLP mund të vendosin ndaj magjistratit një ose më shumë masa disiplinore.

ILD mund të fillojë hetimin me iniciativën e tij ose me nismë të ankuesit. Nëse ka dyshime të

129. Nenet 68-76 të ligjit nr. 96/2016.

130. Vendimi nr.1 datë 30.05.2022 Kolegji i Posaçëm i Apelit i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë.

arsyeshme që magjistrati ka kryer shkelje disiplinore, ILD fillon procedimin disiplinor, duke paraqitur pranë KLGj-së ose KLP-së raportin e hetimit së bashku me dosjen hetimore. Pas shqyrtimit të fakteve dhe provave, Këshilli përkatës rrëzon kërkesën për procedim disiplinor, për shkak se faktet e pretenduara nuk kanë ndodhur ose ato nuk përbëjnë shkelje disiplinore, ose pranon kërkesën dhe vendos një ose më shumë masa disiplinore.

<b><i>Treguesit e realizimit</i></b>	<i>Po/Jo</i>
A është vlerësuar magjistrati 1 herë në 3 vite, gjatë 15 viteve të para të përvojës profesionale apo 1 herë në 5 vjet, pas 15 viteve të para të përvojës profesionale si magjistrat?	
A është kryer vlerësimi i magjistratit bazuar në burimet e vlerësimit të parashikuara në ligj?	
A i kanë hartuar dhe publikuar KLGj dhe KLP raportin vjetor për veprimtarinë e vlerësimit të magjistratëve?	
A i kanë hartuar dhe publikuar KLGj dhe KLP raportet periodike në çdo 3 vjet për sistemin e vlerësimit të magjistratëve?	
A është kryer procedura disiplinore ndaj magjistratit bazuar në procedurën dhe kriteret e parashikuara në ligj?	

<b><i>Treguesit e realizimit</i></b>	<i>Përqindje</i>
Cili është raporti ndërmjet rasteve kur vendimet për vlerësimin e magjistratëve janë shfuqizuar/lënë në fuqi nga gjykata për shkak se janë marrë në shkelje të rënda procedurale?	
Cili është raporti ndërmjet rasteve kur vendimet për masat disiplinore magjistratëve janë shfuqizuar/lënë në fuqi nga gjykata në bazë të ankimit të magjistratit?	
Cili është raporti ndërmjet rasteve kur vendimet për masat disiplinore ndaj magjistratëve janë shfuqizuar/lënë në fuqi nga gjykata në bazë të ankimit të ILD-së?	
Cili është niveli i kënaqësisë së magjistratëve për procedurat e vlerësimit dhe procedurat disiplinore të zhvilluara nga KLGj dhe KLP?	
Cili është niveli i perceptimit të korrupsionit në gjyqësor nga përdoruesit e gjykatave?	
Cili është niveli i perceptimit të aftësive profesionale të magjistratëve nga përdoruesit e gjykatave?	
Cili është niveli i perceptimit të pavarësisë dhe paanësisë të magjistratëve nga përdoruesit e gjykatave?	

### ***Metoda e matjes***

- Analiza e raporteve vjetore të KLP-së dhe KLGj-së për veprimtarinë e vlerësimit të magjistratëve.
- Analiza e raporteve periodike të KLP-së dhe KLGj-së në çdo 3 vjet për sistemin e vlerësimit të magjistratëve.
- Analiza e vendimeve të KLP-së dhe KLGj-së për shqyrtimin e ankesave kundër vlerësimit të magjistratëve.
- Analiza e vendimeve të KLP-së dhe KLGj-së për shqyrtimin e ankesave në kuadër të procedimit disiplinor të magjistratëve.
- Analiza e vendimeve të gjykatave për shqyrtimin e ankesave kundër vlerësimit të magjistratëve.
- Analiza e vendimeve të gjykatave për shqyrtimin e ankesave në kuadër të procedimit disiplinor të magjistratëve.
- Analiza e raportit vjetor të KLGj-së mbi gjendjen e sistemit gjyqësor dhe veprimtarinë e KLGj-së.
- Intervista të thelluara dhe anketim me magjistratët.
- Paraqitja e kërkesave për informacion.

### **Faktori 5.3 Roli i Shkollës së Magjistraturës në përmirësimin e cilësisë së vendimeve gjyqësore**

#### ***Standardet e performancës***

ShM është institucioni i cili siguron formimin profesional të magjistratëve. Formimi profesional përfshin:

- Programin e formimit fillestar të kandidatëve për magjistratë;
- Programin e formimit vazhdues të magjistratëve në detyrë;

Formimi fillestar i kandidatëve për magjistratë përfshin një periudhë trevjeçare që përbëhet nga:

- a) një vit program teorik që synon të rrisë njohuritë në lëndë të ndryshme të së drejtës;
- b) një vit program praktik paraprofesional, që synon të rrisë aftësitë praktike të kandidatëve si gjyqtarë dhe prokurorë nën kujdesin e shkollës dhe nën drejtimin e një gjyqtari ose prokurori me kualifikim të lartë;
- c) një vit praktikë profesionale që organizohet sipas mënyrës dhe afateve të parashikuara në ligjin “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”<sup>131</sup>.

Magjistratët i nënshtrohen formimit vazhdues, nëpërmjet programeve të formimit të vazhdueshëm të hartuar dhe organizuar nga ShM, në bashkëpunim me KLGj-në dhe KLP-në. KLGj dhe KLP miratojnë pjesëmarrjen e gjyqtarëve dhe prokurorëve në trajnimin

---

131. Neni 263 i ligjit nr. 115/2016.

vazhdues, sipas programit të përcaktuar të formimit vazhdues dhe ia dërgojnë ShM në fillim të vitit akademik.

KL Gj dhe KLP bashkëpunon me ShM në lidhje me trajnimin vazhdues të magjistratëve duke këshilluar ShM rreth programit të trajnimit vazhdues për magjistratët, vendosur mbi kërkesat e magjistratëve për trajnimin vazhdues në ShM dhe monitorimit në lidhje me efektivitetin e trajnimeve<sup>132</sup>.

Neni 5 i Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, parashikon gjithashtu detyrimin e magjistratëve për të ndjekur kurset e formimit profesional vazhdues që organizon ShM. Pjesëmarrja në kurset e formimit profesional vazhdues që organizon ShM përbën edhe një kriter në kuadër të vlerësimit të aftësive personale dhe angazhimit profesional të magjistratit, duke u bazuar në tregues të tillë si pjesëmarrja e magjistratit në formimin vazhdues të ShM-së, pjesëmarrja në trajnime të tjera profesionale, disponueshmëria e gjyqtarit për të udhëhequr magjistratët e ardhshëm gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e magjistratëve të rinj, pjesëmarrja e magjistratit në veprimtari ndër-institucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë, në veprimtaritë për marrëdhëniet me publikun të gjykatave dhe publikimet ligjore akademike. Pjesëmarrja e magjistratit në formimin vazhdues të ShM-së matet nga KL Gj dhe KLP duke u bazuar në informacionin e dërguar nga ShM<sup>133</sup>.

<b><i>Treguesit e realizimit</i></b>	<i>Po/Jo</i>
A është efektiv programi i formimit fillestar të kandidatëve për magjistratë?	
A është efektiv programi i formimit vazhdues të magjistratëve në detyrë?	
A ka qenë efektiv bashkëpunimi ndërmjet ShM-së dhe KL Gj/KLP lidhur me analizën e nevojave për trajnim dhe zhvillimin e kurrikulave dhe programeve trajnuese?	
A ka qenë i mjaftueshëm buxheti i ShM-së për formimin fillestar të kandidatëve për magjistratë dhe formimin vazhdues të magjistratëve në detyrë?	
A janë marrë masa disiplinore ndaj magjistratëve që nuk kanë përmbushur pa shkaqe të pajustificuara, detyrimet për të marrë pjesë në programet e trajnimit vazhdues?	
A është zhvilluar një sistem i cili realizon bashkëpunimin dhe shkëmbimin e praktikave gjyqësore ndërmjet magjistratëve?	

132. Nenet 88 dhe 186 të ligjit nr. 115/2016.

133. Neni 74.6 i ligjit nr.96/2016.

<b><i>Treguesit e realizimit</i></b>	<b><i>Përqindje</i></b>
Në cilën masë e kanë përmbushur magjistratët detyrimin për të ndjekur kurset e formimit profesional vazhdues që organizon ShM?	
Në cilën masë është zhvilluar vlerësimi i aftësive personale dhe angazhimit profesional të magjistratit ndër të tjera duke u bazuar në pjesëmarrjen e magjistratit në programin e formimit vazhdues?	
Cila është numri i prokurorëve që janë trajnuar brenda kohëzgjatjes së 1 viti në raport me numrin total të prokurorëve?	
Cila është numri i gjyqtarëve që janë trajnuar brenda kohëzgjatjes së 1 viti në raport me numrin total të gjyqtarëve?	

### ***Metoda e matjes***

- Analiza e raportit vjetor të KLGj-së mbi gjendjen e sistemit gjyqësor dhe veprimtarinë e KLGj-së.
- Analiza e raportit vjetor të Këshillit Drejtues të ShM-së të paraqitur përpara KLGj-së dhe KLP-së;
- Paraqitja e kërkesave për informacion.
- Zhvillimi i intervistave të thelluara me magjistratët.
- Zhvillimi i intervistave *focus groups* me magjistratët.

### **Faktori 5.4 Zbatimi i mjeteve alternative për zgjidhjen jashtëgjyqësisht të mosmarrëveshjeve**

#### ***Standardet e performancës***

Ndërmjetësimi është procedura e zgjidhjes jashtëgjyqësore të konflikteve, ku dy ose më shumë palë në mosmarrëveshje, mbi bazë të vullnetit të lirë, përpiqen për të zgjidhur mosmarrëveshjet me anë të një personi të tretë asnjans (ndërmjetësit), për të arritur një zgjidhje të pranueshme të mosmarrëveshjes dhe që nuk bie në kundërshtim me ligjin.

Ndërmjetësimi zbatohet për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, në çdo kohë që palët në konflikt, me vullnetin e tyre të lirë, kërkojnë dhe pranojnë ndërmjetësimin si alternativë për zgjidhjen e mosmarrëveshjes, pavarësisht nëse mosmarrëveshja është paraqitur përpara organit të përcaktuar nga ligji për zgjidhjen e saj.

Gjykata detyrimisht njofton, udhëzon dhe, sipas rastit, informon në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme palët për zgjidhjen me ndërmjetësim.<sup>134</sup> Në çdo fazë të gjykimit, gjykata vë në dijeni palët lidhur me mundësinë e zgjidhjes së mosmarrëveshjes me ndërmjetësim dhe nëse ato pranojnë, e kalon çështjen për ndërmjetësim. Kur palët bien dakord pezullon gjykimin duke u caktuar palëve një afat në përputhje me natyrën e mosmarrëveshjes, por jo më shumë se 30 ditë.

134. Neni 2 i ligjit nr. 10385, datë 24.02.2011 dhe neni 25 i K.Pr.C.

Në rast të paraqitjes së aktmarrëveshjes për zgjidhjen e mosmarrëveshjes me ndërmjetësim, gjykata vendos miratimin e saj, nëse kjo e fundit nuk është në kundërshtim me ligjin.<sup>135</sup>

Nëse palët me kontratë apo marrëveshje me shkrim kanë parashikuar kushtin se ndërmjetësimi do të jetë alternativa e parë e zgjidhjes së konfliktit, para asaj gjyqësore, gjykata nuk e merr në shqyrtim çështjen pa u zbatuar ky kusht.

Në rastin e mosmarrëveshjeve në fushën penale, kur procedimi penal ka nisur, gjykata detyrimisht njofton dhe udhëzon palët për zgjidhjen me ndërmjetësim për mosmarrëveshjet që shqyrtohen nga gjykata me kërkesën e viktimës akuzuese, ose me ankim të të dëmtuarit, sipas neneve 59 dhe 284, të K.Pr.P., si dhe në çdo rast kur ligji i veçantë e lejon atë.<sup>136</sup> Gjukata fton palët për zgjidhjen me ndërmjetësim të mosmarrëveshjes objekt gjykimi duke iu caktuar palëve një afat në përputhje me natyrën e mosmarrëveshjes. Secila nga palët ka të drejtë të kërkojë në çdo kohë rifillimin e gjykimit.<sup>137</sup>

Kur palët bien dakord për zgjidhjen e pranueshme të mosmarrëveshjes ndërmjet tyre, së bashku me ndërmjetësit, nënshkruajnë marrëveshjen përkatëse, në kuptim dhe në zbatim të kushteve, rasteve dhe të procedurave të parashikuara në këtë ligj. Kjo marrëveshje është e detyrueshme dhe e ekzekutueshme.

Në rastin kur është zgjidhur çështja me anë të ndërmjetësit, organet gjyqësore vendosin, sipas rastit, miratimin e zgjidhjes me pajtim të çështjes civile ose pushimin e çështjes penale apo mosfillimin e procedimit penal, përveç rasteve kur arrihet në përfundimin se vërehet pavlefshmëri<sup>138</sup>.

<i><b>Treguesit e realizimit</b></i>	<i><b>Po/Jo</b></i>
A i ka njoftuar gjykata palët për mundësinë e zgjidhjes së mosmarrëveshjes me ndërmjetësim?	
Në rast se po, a i ka informuar gjykata palët në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme?	
A i ka njoftuar ndërmjetësi palët përpara fillimit të procedurës së ndërmjetësit për qëllimet dhe parimet e përgjithshme, rolin e ndërmjetësit dhe të palëve në proces, shpenzimet e procesit të ndërmjetësit dhe efektet e marrëveshjes së ndërmjetësit?	
A ka vepruar ndërmjetësi në zbatimin e procedurave të ndërmjetësit duke siguruar trajtimin e njëjtë, të drejtë dhe të paanshëm të palëve?	
A kanë mbetur konfidenciale të dhënat dhe rrethanat për procedurat e ndërmjetësit, përveçse kur palët kanë rënë dakord ndryshe ose në raste të parashikuara në ligj?	

135. Neni 158/ç i K.Pr.C.

136. Neni 2 i ligjit nr. 10385, datë 24.02.2011.

137. Neni 14 ligjit nr. 10385, datë 24.02.2011.

138. Neni 23 paragrafët 2 të ligjit nr. 10385, datë 24.02.2011.

A ka vendosur gjykata për pezullimin e gjykimit duke u dhënë palëve kohën e mjaftueshme për zgjidhjen e mosmarrëveshjes me ndërmjetësim?	
A ka qenë i lirë dhe i pavesuar vullneti i palëve për të vendosur rregullat dhe mënyrën e zhvillimit të ndërmjetësimit?	
A ka qenë i lirë dhe i pavesuar vullneti i palëve për të zgjedhur ndërmjetësin?	
Në rast se palët kanë arritur një marrëveshje ndërmjet tyre për zgjidhjen e mosmarrëveshjes, a janë përcaktuar qartë detyrimet e kushtet që palët i vënë njëra-tjetrës dhe mënyra e afati i përmbushjes së tyre?	
A jemi përpara rasteve të pavlefshmërisë së marrëveshjes së ndërmjetësimit?	
A është konsideruar titull ekzekutiv marrëveshja e ndërmjetësimit?	
A ka pasur problematika në ekzekutimin e marrëveshjes së ndërmjetësimit nga përmbaruesit?	

<i><b>Treguesit e realizimit</b></i>	<i><b>Përqindja</b></i>
Cili është raporti i rasteve kur gjykata i ka njoftuar palët për mundësinë e zgjidhjes së mosmarrëveshjes me ndërmjetësim?	
Cili është raporti i rasteve në të cilat procedura e ndërmjetësimit është zbatuar në vijim të referimit nga gjykata dhe paraqitjes së ftesës për ndërmjetësim nga njëra nga palët në konflikt palës tjetër?	
Cili është raporti i rasteve kur gjykata e ka konsideruar të detyrueshme dhe të ekzekutueshme marrëveshjen e ndërmjetësimit dhe rasteve kur nuk e ka konsideruar të ekzekutueshme atë?	
Cili është raporti i mosmarrëveshjeve që zgjidhen nga juridiksioni gjyqësor dhe nëpërmjet ndërmjetësimit?	
Në cilën masë janë palët të kënaqura me cilësinë e shërbimit të ofruar nga ndërmjetësit?	
Në cilën masë kanë dijeni qytetarët për ndërmjetësimin si një mjet alternativ për të zgjidhur jashtëgjyqësisht mosmarrëveshjet?	

### ***Metoda e matjes***

- Analiza e vendimeve të gjykatave;
- Analiza e raporteve vjetore të gjykatave.
- Paraqitja e kërkesave për informacion.
- Zhvillimi i sondazheve kombëtare dhe lokale.



## BIBLIOGRAFIA

### Literaturë

International Development Law Organization: Access to Justice: A Conceptual and Practical Analysis with Implications for Justice Reforms, faqe 4.

A2JBC Working Group, School of Criminology, University of the Fraser Valley, & International Centre for Criminal Law Reform and Criminal Justice Policy: Access to Justice Measurement Framework, faqe 1.

Julio C. Teehankee, Ph.D. De La Salle University – Manila: Access to Justice Indicators in the Asia-Pacific Region, faqe 1.

UN Women: A framework for measuring access to justice including specific challenges facing women: Guidance note.

Nicola Picardi, Manuale del processo civile, seconda edizione, Giuffrè Editore, faqe 3.

Froëin–Peukert, EMRK–Komentar, 2.Auflage, Engel Verlag.

### Faqe interneti

<https://www.un.org/en/development/desa/what-we-do/rule-of-law.html>

<https://sourcebooks.fordham.edu/source/magnacarta.asp>

### Vendime të GJEDNJ-së

Vendim Le Compte, Van Leuven dhe De Meyere, datë 23/06/1981, GjEDNj;

Vendim Sporrang dhe Lönnroth, datë 23/09/1982 GjEDNj;

Vendim Axen kundër Republikës Federale të Gjermanisë, datë 08/12/1983, GjEDNj;

Vendim Schenk kundër Zvicrës, datë 12/07/1988, GjEDNj;

Vendim Belilos kundër Zvicrës, datë 29/04/1988, GjEDNj;

Vendim Hausschildt kundër Danimarkës datë 24/05/1989, GjEDNj;

Vendim Langborger kundër Suedisë, datë 22/06/1989, GjEDNj;

Vendim Vindishi kundër Austrisë, datë 27/09/1990, GjEDNj;

Vendim Alimena kundër Italisë, datë 19/02/1991, GjEDNj;

Vendim Haxhianastasiu kundër Greqisë, datë 16/12/1992, GjEDNj;

Vendim Fey kundër Austrisë, datë 24.02.1993, GjEDNj;

Vendim Dombo Behere kundër Holandës, datë 27/10/1993, GjEDNj;

Vendim Ruiz-Mateos, kundër Spanjës datë 23/06/1993, GjEDNj;

Vendim Stratis Andreadhis kundër Greqisë datë 09/12/1994, GjEDNj;

Vendim Balani kundër Spanjës, datë 9/12/1994, GjEDNj;

Vendim G. Kundër Francës, datë 27/09/1995, GjEDNj.

Vendim Allenet de Ribemont kundër Francës, datë 10/02/1995, GjEDNj;

Vendim Vermeulen kundër Belgjikës; datë 20/02/1996, GjEDNj;  
Vendim Nideröst-Huber kundër Zvicrës datë 18/02/1997, GjEDNj;  
Vendim Dehaes dhe Giples kundër Belgjikës, datë 04/02/1997, GjEDNj;  
Vendim Gautrin et al kundër Francës, datë 20.05.1998, GjEDNj;  
Vendim Krombach kundër Francës, datë 13.02.2001, GjEDNj;  
Vendim nr. 45771/99 Veeber kundër Estonisë, datë 21/01/2003, GjEDNj,  
Vendim Surmeli kundër Gjermanisë, datë 08/06/2006, GjEDNj;  
Vendim Bykov kundër Rusisë, datë 10/03/2009, GjEDNj;  
Vendim Hugh Jordan kundër Mbretërisë së Bashkuar, datë 04.05.2001, GjEDNj;  
Vendim Giuliani dhe Gaggio kundër Italisë datë 24.05.2011, GjEDNj.

### **Vendime gjyqësore**

Vendim nr.69/2000 i GjK-së;  
Vendim nr. 61/2001 i GjK-së;  
Vendim nr. 95/2001 i GjK-së;  
Vendim nr. 109/2002 i GjK-së;  
Vendimi nr.5/2003 i GjK-së;  
Vendim nr. 19/2003 i GjK-së;  
Vendim nr.13/2003 i GjK-së;  
Vendim nr. 33/2003 i GjK-së;  
Vendim nr. 9/2004 i GjK-së;  
Vendim nr. 11/2004 i GjK-së;  
Vendim nr.35/2005 i GjK-së;  
Vendim nr.31/2005 i GjK-së;  
Vendim nr. 17/2005 i GjK-së;  
Vendim nr.11/2005 i GjK-së;  
Vendim nr. 7/2005 i GjK-së;  
Vendimi nr. 33/2005 i GjK-së;  
Vendim nr.19/2005 i GjK-së;  
Vendim nr.5/2005 i GjK-së;  
Vendim nr. 29/2006 i GjK-së;  
Vendim nr.16/2006 i GjK-së;  
Vendim nr. 8/2006 i GjK-së;  
Vendim nr. 16/2006 i GjK-së;  
Vendim nr. 9/2007 i GjK-së;  
Vendim nr. 23/2007 i GjK-së;  
Vendim nr. 34/2007 i GjK-së;  
Vendim nr.14/2007 i GjK-së;  
Vendim nr. 18/2007 i GjK-së;  
Vendim nr. 12/2007 i GjK-së;  
Vendim nr. 19/2007 i GjK-së;  
Vendim nr. 11/2008 i GjK-së;  
Vendim nr.15/2008 i GjK-së;

Vendim nr. 19/2008 i GJK-së;  
Vendim nr. 13/2008 i GJK-së;  
Vendim nr. 24/2008 i GJK-së;  
Vendim nr. 7/2009 i GJK-së;  
Vendimi nr. 28/2009 i GJK-së;  
Vendim nr. 30/2009 i GJK-së;  
Vendim nr. 14/2009 i GJK-së;  
Vendim nr. 18/2009 i GJK-së;  
Vendim nr. 23/2009 i GJK-së;  
Vendim nr. 26/2009 i GJK-së;  
Vendim nr. 16/2009 i GJK-së;  
Vendim nr. 4/2009 i GJK-së;  
Vendim nr. 9/2009 i GJK-së;  
Vendim nr. 27/2009 i GJK-së;  
Vendim nr. 38/2010 i GJK-së;  
Vendim nr. 8/2010 i GJK-së;  
Vendim nr. 11/2010 i GJK-së;  
Vendim nr. 14/2010 i GJK-së;  
Vendim nr. 190/2010 i GjL-së;  
Vendim nr. 168/2010 i GjL-së;  
Vendim nr. 293/2010 i GjL-së;  
Vendim nr. 8/2011 i GJK-së;  
Vendim nr. 25/2011 i GJK-së;  
Vendim nr. 34/2011 i GJK-së;  
Vendim nr. 36/2011 i GJK-së;  
Vendim nr. 42/2011 i GJK-së;  
Vendim nr. 50/2011 i GJK-së;  
Vendim nr. 33/2011 i GJK-së;  
Vendim nr. 47/2011 i GJK-së;  
Vendim nr. 50/2011 i GJK-së;  
Vendim nr. 15/2012 i GJK-së;  
Vendim nr. 49/2012 i GJK-së;  
Vendim nr. 12/2012 i GJK-së.  
Vendim nr. 5/2012 i GJK-së;  
Vendim nr. 20/2012 i GJK-së;  
Vendimi nr. 10/2012 i GJK-së;  
Vendim nr. 56/2012 i GJK-së;  
Vendim nr. 549/2012 i GjL-së;  
Vendimi nr. 18/2013 i GJK-së;  
Vendim nr. 51/2013 i GJK-së;  
Vendim nr. 587/2014 i GjL-së;  
Vendim nr. 11/2018 i GJK-së;  
Vendim nr. 3/2021 i GJK-së;  
Vendim nr. 2/2022 i GJK-së;

Ligji nr. 49/2012	Ligji nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar
Ligji nr. 111/2017	Ligji nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”
Ligji nr.115/2016	Ligji nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”
Ligji nr.96/2016	Ligji nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarit dhe prokurorit në Republikën e Shqipërisë”.
Ligji nr. 10385, datë 24.02.2011	Ligji nr. 10385, datë 24.02.2011 “Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve”



**CIP Katalogimi në botim BK Tiranë**

Instituti për Studimet Publike dhe Ligjore

Aksesi në drejtësi dhe gjykimi i drejtë : guidë monitorimi për shoqërinë civile / Instituti për Studimet Publike dhe Ligjore . - Tiranë : Muza, 2023.

... f. ; ... cm.

Bibliogr..

ISBN 9789928361394

1.E drejta dhe legjislacioni 2.Gjykata 3.Gjykimi

4.Shoqëria civile 5.Shqipëri

34(496.5)